



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN VENDORE, 2023-2030

MINISTRIA E BRENDSHME

30 NËNTOR 2022

Tabela e Përmbajtjes

Falenderime	0
1. Përmbledhje ekzekutive.....	1
2. Kuadri Strategjik (Ecuria e procesit të decentralizimit dhe qeverisjes vendore	2
2.1 Progresi strategjik	2
2.2 Konsiderata dhe mësimet të nxjerra.....	22
2.3 Parimet/Metodologjia/Institucionet.....	25
3. Strategjia e re për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore	26
3.1 Vizioni dhe objektivat	26
3.2 Shtyllat kryesore të strategjisë.....	27
3.4 Treguesit e nivelit strategjik.....	66
Objektivi 2: Ofrimi cilësor i shërbimeve vendore sipas standardeve kombëtare, shoqëruar me rritje të performancës së bashkive dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.	68
4. Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese	73
5. Burimet financiare për zbatimin e strategjisë.....	74

Falenderime

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, është një dokument i përgatitur nga Ministria e Brendshme, nën drejtimin e drejtpërdrejtë të Ministrit të Brendshëm, Z. Bledar Çuçi, dhe Zëvendësministres së Brendshme, Znj. Romina Kuko, njëkohësisht dhe drejtuese e Grupit Politik të hartimit të kësaj strategjie.

Grupi Teknik i hartimit të strategjisë u kryesua nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Z. Enea Hoti, sot Sekretar i Përgjithshëm, si edhe dy strukturat teknike të Ministrisë së Brendshme, stafi i Drejtorisë së Politikave për Çështjet Vendore dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Ky dokument nuk do të ishte finalizuar pa kontributin e drejtpërdrejtë të Bashkive, Ministrive të Linjës dhe Agjencive Shtetërore, përmes një procesi të gjerë ndarjesh informacioni, konsultimi dhe validimi të gjetjeve. Falënderime shkojnë edhe për shoqatat e vetëqeverisjes vendore, si Shoqata për Autonomi Vendore dhe Shoqata e Këshillave të Qarqeve.

Hartimi i kësaj strategjie është mbështetur nga një sërë partnerësh zhvillimi. OECD/SIGMA pasuroi strategjinë me orientime dhe komente të vlefshme qofshin në aspektin metodologjik, ashtu edhe përmbajtësor. Ministria e Brendshme dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore u janë falënderuese projektit STAR3 - Qëndrueshmëria dhe avancimi i reformës në qeverisjen vendore, projektit Bashki të Forta dhe Financat Lokale, si edhe përfaqësuesve të ndryshëm të Shoqërisë Civile, të cilët ndanë perspektivën e tyre mbi agjendën e decentralizimit.

1. Përmbledhje ekzekutive

Qeverisja vendore përfaqëson një nga themelet e qeverisjes së mirë, në shërbim të komunitetit dhe afër qytetarëve, duke përfaqësuar më së miri interesat/preferencat e tyre. Konsolidimi territorial shënon reformën më të rëndësishme administrative në vend, me riorganizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore nga 373 njësi (308 komuna dhe 65 bashki) në 61. Reforma Administrative Territoriale (RAT) u shoqërua me decentralizim të një sërë funksionesh tek qeverisja vendore. Sot më shumë se kurdo, bashkitë kanë një numër të konsiderueshëm kompetencash për t'u shërbyer qytetarëve sipas nevojave dhe në mënyrë demokratike. Këto procese të rëndësishme eliminuan fragmentarizimin e panevojshëm, rritën efikasitetin dhe eficientësinë në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësuan dukshëm autonominë fiskale vendore. Kompetencat janë shoqëruar në mënyrë të vazhdueshme me mbështetje financiare nga ana e Qeverisë Qendrore, e cila e konsideron agjendën e decentralizimit shumë të rëndësishme në procesin e mirëqeverisjes dhe të integritimit evropian. Harmonizimi ligjor midis ligjit organik nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjeve sektoriale kanë pasur gjithashtu vëmendje të shtuar gjatë periudhës pas RAT.

Decentralizimi gjithsesi nuk duhet konsideruar si një zgjidhje e menjëhershme e të gjithë sfidave në nivel vendor, por si një proces me zbatim holistik dhe persistent përsa i përket politikave vendore. Vlerësohet se ka ende nevojë për të intensifikuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisë vendore dhe asaj qendrore, për të përputhur bazën ligjore (me akte ligjore dhe nënligjore) me funksionet, implementimin e funksioneve të reja dhe vazhdimin e punës për rritje të kapaciteteve të bashkive, shoqëruar me menaxhim më eficient të financave vendore dhe mirëqeverisje, me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm. E rëndësishme është qasja nga poshtë lart, duke marrë në konsideratë perspektivën e pushtetit vendor në zbatimin e SNDQV në tërësi dhe ushtrimit të funksioneve në veçanti.

Ndaj, në këtë frymë dhe në vijim të strategjisë ekzistuese për decentralizimin dhe qeverisjen kombëtare relevante për aktorët e qeverisjes vendore, strategjia e re *synon konsolidimit e mëtejshëm të procesit të decentralizimit për një zhvillim ekonomik vendor të qëndrueshëm me shërbime cilësore, gjithëpërfshirëse për qytetarët dhe transparente drejt standardeve evropiane*. Ky qëllim kryesor synohet të arrihet duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm vendor me anë të rritjes së kapaciteteve vendore për menaxhim të integruar të aseteve vendore, përmirësuar ofrimin e shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë së ofrimit të tyre dhe me standard tek qytetarët, digjitalizimin e shërbimeve vendore dhe përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit të tyre, rritjes së autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të ardhurave të veta, përmirësimit të demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor si dhe konsolidimit të mëtejshëm të kapaciteteve të strukturave administrative në mbështetje të qeverisjes vendore.

SNDQV është një strategji ndërsektoriale, e cila përveç ministrive të linjës dhe agjencive shtetërore përfshin edhe NJVV-së si institucione përgjegjëse ose/dhe kontribuuese për një sërë masash. Aktorë të tjerë në mbështetje të zbatimit të SNDQV janë edhe qarqet, shoqatat e qeverisjes vendore, partnerët e zhvillimit dhe organizatat joqeveritare. Kjo strategji mbulon periudhën 2023-2030, për t'i dhënë mundësinë agjendës së decentralizimit për ndërhyrje holistike dhe kuptim-plotë, në të njëjtën kohë edhe koordinim me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila është në përputhje me

Agjendën 2030 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ndërsa plani i veprimit do të jetë 3-vjeçar, duke përfshirë aktivitete dhe masa afatshkurtra dhe me produkte të afërta në kohë.

Në frymën e koordinimit ndërinstytucional, procesi i hartimit të draftit të kësaj strategjie dhe planit të saj shoqëruet të veprimit ka pasur një qasje gjithëpërfshirëse me të gjithë aktorët e sipërcituar të përfshirë në zbatimin dhe mbështetje të agjendës së decentralizimit. Inputet janë bazuar në evidenca ku përfshihen inventarizimi i zbatimit të funksioneve të pushtetit vendor nga 61 bashkitë, intervista të thelluara dhe konsultimi gjithëpërfshirës i aktorëve kryesorë me fokus bashkitë.

Në vijim, kjo strategji në kapitullin e dytë, përshkruan kuadrin strategjik, ecurinë e procesit të decentralizimit dhe qeverisjes vendore, parimet dhe metodologjinë e ndjekur së bashku me institucionet përgjegjëse dhe ato kontribuuese. Në vijim të progresit strategjik, kjo strategji analizon paraprakisht të gjitha kompetencat e qeverisjes vendore, për të bërë një hartëzim ligjor të përmirësimeve të mëtejshme në vijim të procesit ekzistues të harmonizimit ligjor. Kapitulli i katërt përshkruan gjerësisht vizionin, objektivat e strategjisë së re për decentralizimin dhe qeverisjen vendore të detajuara në objektiva specifike si edhe treguesit kryesorë. Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese jepen në kapitullin e pestë, ndërsa burimet financiare në kapitullin 6.

2. Kuadri Strategjik (Ecuria e procesit të decentralizimit dhe qeverisjes vendore)

2.1 Progresi strategjik

Konsolidimi territorial nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” shënoi reformën më të rëndësishme administrative në vend që nga viti 1992. Riorganizimi i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) nga 373 (308 komuna dhe 65 bashki) në 61 eliminoi fragmentarizimin e panevojshëm, rriti efikasitetin dhe eficientësinë në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësoi dukshëm autonominë fiskale vendore.

Në vijim të riorganizimit administrativo-territorial, në vitin 2015 u miratua Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV), duke përcaktuar kështu objektivat e procesit të decentralizimit në Shqipëri dhe vizionin e Qeverisë Shqiptare për forcimin e qeverisjes dhe demokracisë vendore. Më konkretisht, me anë të Ligjit organik 139/2015, NJVV iu deleguan një sërë fushash kryesore të përgjegjësisë vendore, duke përcaktuar rreth 41 funksione. Përcaktimi i përgjegjësive historike nuk ndryshoi në mënyrë drastike nga periudha para strategjisë dhe reformës territoriale, por ndër 41 funksionet vendore të përcaktuara me ligj, 7 transferoheshin për herë të parë nën kompetencën vendore në vitin 2015, si në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, shërbimeve sociale, kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese, mbrojtjes së mjedisit, bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimit ekonomik vendor, sigurisë publike, e në 2019 funksionin në fushën e diasporës dhe migracionit. Funksionet përthyhen në një sërë shërbimesh, tashmë përgjegjësi ekskluzive e NJVV, për t’u ofruar qytetarëve dhe komuniteteve vendore më afër dhe në përputhje me nevojat/preferencat e tyre.

Ky proces i thellimit të decentralizimit u bazua tek parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore me qëllim konsolidimin e decentralizimit politik, administrativ dhe fiskal, ashtu edhe tek

agjenda e Integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), të gjitha sipas vizionit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Në të njëjtën frymë, ndryshime të rëndësishme ligjore u pasuan, sikurse mund të përmenden aktet nënligjore për mbledhjen e taksës së pasurisë së paluajtshme/kadastrën fiskale, taksat vendore, udhëzimet për buxhetimin e qeverisjes vendore, kuadri rregullator i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” mbi hartimin dhe detajimin e planeve të përgjithshme vendore të territorit. Sa i përket konfigurimit institucional, ka pasur një sërë zhvillimesh në strukturat e qeverisjes qendrore lidhur me decentralizimin dhe qeverisjen vendore që shoqëruan RAT, si ngritja dhe funksioni i Këshillit Konsultativ ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore dhe struktura të qeverisjes qendrore përgjegjëse për politikën dhe zbatimin e agjendës së decentralizimit në nivel vendor (Drejtoria e Çështjeve Vendore në Ministrinë e Brendshme dhe Agjencia për Zbatimin e Reformës Administrative Territoriale, e cila më vonë u shndërrua në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore).

Si domosdoshmëri e decentralizimit të burimeve të financimit për ushtrimin e funksioneve të sipërcituara, u miratua Ligji i Financave Vendore nr.68/2017, i cili përcaktoi rregullat e menaxhimit të financave publike në nivel vendor si edhe parimet dhe procedurat e qarta mbi financimin e qeverisë vendore nga burimet vendore. Ky kuadër i dedikuar ligjor për financat vendore, shoqëruar edhe me transferta specifike për funksionet e deleguara, solli avancim të dukshëm të decentralizimit fiskal në vend, me synimin për të krijuar një sistem transparent dhe gjithëpërfshirës për alokimin e transfertave të pakushtëzuara ndërqeveritare për qeverisjen vendore.

Nga këndvështrimi ligjor, së bashku me zhvillimet e mësipërme strategjike dhe legjislativë, proceset më sipër u pasuan me një sërë ndryshimesh të aspekteve të ndryshme të ligjeve sektoriale dhe akteve nënligjore për vetëqeverisjen vendore, me synim ndërtimin e një kuadri gjithëpërfshirës për funksionet e decentralizuara, me fokus ato të decentralizuara rishtazi. Rëndësi iu vu procesit të harmonizimit ligjor midis ligjit organik 139/2015 dhe ligjeve sektoriale me qëllim eliminimin e pengesave ligjore dhe institucionale në ekzekutimin e funksioneve nga ana e bashkive. Një analizë e detajuar e bazës ligjore (Matrica e Kompetencave¹) orientoi Ministrinë e Brendshme për priorizimin e rekomandimeve/ndryshimeve ligjore të nevojshme me qëllim menaxhimin efikas të funksioneve të deleguara. Kësisoj, një mori vendimesh, udhëzimesh dhe akte të tjera nënligjore u miratuan, çka rriti dukshëm shkallën e harmonizimit ligjor, si një ndër objektivat kryesorë të strategjisë ekzistuese. Në Këshill Konsultativ që nga viti 2017 janë organizuar 31 mbledhje ku kanë kaluar gjithsej 236 projektakte për mendim, me një intensitet të shtuar veçanërisht pas Urdhrit të Kryeministrit nr.101/2019 mbi harmonizimin ligjor.

Në terma të kuadrit strategjik, si domosdoshmëri e një vlerësimi më të detajuar dhe kumulativ të masave të zbatuara në kuadër të SNDQV 2015-2020, u ndërmor Rishikimi Afatmesëm i Strategjisë, i cili theksoi rëndësinë e objektivave të SNDQV për nevojat e qeverisjes vendore, duke vlerësuar Strategjinë aktuale si të rëndësishme dhe të vlefshme për NJVV, ndërsa vetë procesi i decentralizimit përfitoi nga një përditësim i Planit të Veprimit të strategjisë në 2020-2022. Rishikimi afatmesëm argumenton se “strategjia mbetet e dobishme dhe e vlefshme për nevojat e të gjithë aktorëve të

¹ Matrica e Kompetencave (2019). <https://bpe.al/al/matrica-e-kompetencave-e-vet%C3%ABqeverisjes-vendore-2019>

² Vendimi nr. 783, datë 07.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020”.

përfshirë, dhe ku është bërë një progres i rëndësishëm” në agjendën e decentralizimit. Përtej këtij rishikimi akumulativ afatmesëm, SNDQV është monitoruar në mënyrë të rregullt në vitet 2016, 2017, 2020, 2021.

Katër drejtimet/shtyllat kryesore strategjike të agjendës së decentralizimit ruajnë drejtimet kryesore të kuadrit strategjik deri në vitin 2022 dhe janë si më poshtë:

- A. Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore (i cili përfshin tre objektiva specifike: (i) konsolidimi i kapaciteteve të strukturave administrative; (ii) aplikimi i shërbimeve të integruara administrative me teknologjinë e informacionit për 61 bashki dhe njësi e tyre administrative; (iii) forcimi i dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme).
- B. Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale (i cili përfshin pesë objektiva specifike, siç janë (i) konsolidimi i sistemit të të ardhurave të veta vendore dhe administrimit fiskal vendor; (ii) rritja e ndarjes së të ardhurave nga taksat kombëtare me bashkitë; (iii) përmirësimi i parashikueshmërisë, stabilitetit dhe përshtatshmërisë së sistemit të transfertave qeveritare; (iv) rritja e kapaciteteve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) për të përdorur huamarrjen për financimin e projekteve kapitale, brenda politikave kombëtare të borxhit publik; (v) forcimi i sistemit të menaxhimit të financave publike në nivelin vendor).
- C. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor (i cili përfshin tre objektiva specifike: (i) zbatimin efikas i funksioneve të veta bazuar në një kuadër ligjor të qartë dhe të harmonizuar; (ii) sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik vendor; (iii) ngritja dhe përditësimi i standardeve minimale kombëtare për shërbimet vendore).
- D. Forcimi i qeverisjes së mirë në nivelin vendor, i cili përfshin katër objektiva specifike: (i) sigurimin e qeverisjes së hapur, rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe shtrirje më të madhe të e-qeverisjes në nivel vendor; (ii) Integrimi Evropian dhe qeveria vendore; (iii) forcimi i strukturave komunitare në nivel vendor (Komisionet qytetare, Kryetarët e fshatrave, Ndërlidhësit qytetarë); (iv) adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore).

Si një strategji ndërsektoriale, progresi strategjik është i lidhur me punën e shumë aktorëve, si Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Ministri Linje, Agjenci Qendrore, si dhe shoqatat vendore e partnerë të tjerë vendas e ndërkombëtarë. Bazuar në raportimet e tyre, vërehet se është arritur një progres i rëndësishëm dhe domethënës në rrugën e decentralizimit në funksion të nevojave të qeverive vendore dhe qytetarëve. Progresi strategjik i parë në këndvështrimin administrativ, funksional dhe fiskal është vlerësuar në masën 67%. Gjithsesi, theksohet se ky progres nuk reflekton tërësisht shkallën e zbatueshmërisë për shkak të disa mangësive në procesin e raportimit nga ana e institucioneve përgjegjëse, që jo domosdoshmërisht përputhet me shkallën e realizimit. Ndaj, ky seksion paraqet një vështrim të shkurtër mbi secilin prej shtyllave kryesore strategjike, arritjet dhe problematikat e hasura jo vetëm nëpërmjet raportimeve vjetore, por edhe burimeve të ndryshme dytësore.

Vlerësimet vjetore dhe afatmesme të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen vendore dhe planit të saj të veprimit dëshmojnë një progres të rëndësishëm strategjik, me nivele të ndryshme progresi në 4 shtyllat strategjike. Në mënyrë të detajuar, seksioni më poshtë paraqet zhvillimet kryesore në secilën shtyllë/drejtim.

A. Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore

Sa i përket shtyllës së parë strategjike, progresi vlerësohet të jetë në masën 75%, ku avancim të shpejtë ka pasur konsolidimi i kapaciteteve të strukturave administrative (100% realizueshmëri), në vijim me aplikimin e shërbimeve të integruara administrative me teknologjinë e informacionit për 61 bashki dhe njësi të tyre administrative (50%) dhe forcimin e dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme (75%).

Arritjet kryesore lidhen me ofrimin e shërbimeve administrative në zyra me një ndalesë, ku rezultojnë një aktivitet tërësisht i mbuluar dhe tashmë i orientuar me nismë të Qeverisë Shqiptare në ofrimin e shërbimeve online. Zyrat me Një Ndalesë kanë qenë një prioritet i artikuluar i Qeverisë Shqiptare që pas reformës administrativo-territoriale, i konkretizuar me mbështetjen e donatorëve nëpërmjet projektit STAR (Qeveria Shqiptare, Delegacioni i Bashkimit Evropian, Ambasada Suedeze, Ambasada Zvicerane dhe USAID).

Siç shihet numri i aplikimeve online për shërbime administrative në nivel vendor është rritur në mënyrë progresive nga njëri vit në tjetrin (nga 373 në vitin 2018 në 35,191 në Shtator 2022).³ Që me nismën e Qeverisë Qendrore për shërbime online, vetëm gjatë gjashtë muajve të fundit shënohen 4189 shërbime, me 152 shërbime unike⁴. Qëndrueshmëria e stafit të trajnuar dhe nevoja e stafit për t'u përditësuar me teknologjinë, kjo në frymën e re të nismës së qeverisë për ofrimin e shërbimeve online, janë aspekte për t'u adresuar në mënyrë të vazhdueshme në nivelin vendor.

Së dyti, kapacitetet institucionale të lidhura me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe trajnimin e bashkive mbetet një aspekt i rëndësishëm i nivelit vendor. Profesionalizmi dhe kapacitetet e burimeve njerëzore janë faktorë kyç në ofrimin e qeverisjes së mirë, përgatitjen, miratimin, buxhetimin, zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e politikave zhvilluese, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore vendore për të gjithë dhe në të gjithë territorin. Nëpërmjet platformës së integruar "administrata.al" është synuar të përmirësohet komunikimi dhe ndërveprimi mes institucioneve, njëkohësisht unifikimi dhe standardizimi i procedurave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore. Platforma përmban module të integruara mbi rekrutimin, përshkrimet e punës, vlerësimin e performancës, ligjin për garantimin integritetit, çështjet ligjore, nevojat për trajnim dhe vlerësimin e kostos. Tashmë, platforma regjistron mbi 170 përdorues nga NJVV, të cilat kanë në dispozicion module dhe mbi 300 template për hapat e proceseve të punës në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Të gjitha më sipër lehtësojnë ndjeshëm punën e nëpunësve që menaxhojnë proceset e burimeve njerëzore. Platforma regjistron mbi 170 përdorues nga njësitë e qeverisjes vendore.

Përveç aspektit organizativ, çështje të tjera me rëndësi përse i përket burimeve njerëzore janë edhe strukturat dhe pagat. Lidhur me të parën, AMVV, me mbështetjen e projektit STAR1 dhe STAR2 ka krijuar disa modele strukturash (në vitin 2015 dhe 2018). Disa bashki e kanë përdorur këtë model si

³ Mbështetje e vazhdueshme është dhënë nga partnerët e zhvillimit, më konkretisht projekti STAR1-3.

⁴ Të dhënat raportohen vetëm për 52 bashkitë të cilat operojnë me OSSIS (Sistemin e Zyrës me Një Ndalesë).

referencë. Edhe pse bashkitë kanë autonominë e tyre për t'i ndërtuar strukturat sipas specifikave dhe prioriteteve të tyre, një dakordësi mbi një model bazë orientues do të ishte i vlefshëm lidhur me mirëorganizimin e punës dhe të burimeve njerëzore në dispozicion.

Bashkitë ndeshen me sfidën e përthithjes, zhvillimit dhe mbajtjes së kapaciteteve (burimeve) njerëzore në administratat e tyre, por edhe me sfidën e cilësisë së këtyre burimeve. Për një sërë profesioneve specifike, pushteti vendor has vështirësi të gjejë punonjës me kualifikimet e duhura dhe përballet me raste ku këto pozicione mbeten vakante. Mbetet për t'u përmirësuar, ndryshuar, e rishikuar struktura e pagave për punonjësit e bashkive për të motivuar mbajtjen e stafeve aktuale, tërheqjen e stafeve të reja profesionale, me profilet e punës që mungojnë në disa bashki, si inxhinier, topografë, arkitektë, urbanistë, juristë, punonjës TIK, punonjës socialë etj. Ndërkaq, Departamenti i Administratës Publike po punon për të konsoliduar një propozim konkret për ndryshimet në strukturën e pagave.

Patjetër, edhe procesi i pajisjes së bashkive me instrumentet e nevojshme për qeverisjen e mirë dhe të qëndrueshme të territorit, më konkretisht me Plane të Përgjithshme Vendore, ka qenë një proces i qenësishëm. Pothuaj të gjitha bashkitë kanë një plan të tillë (52 nga 61 bashki⁵), shpesh herë edhe i detajuar apo në pak raste i shtrirë në planë zhvillimi ekonomik. Por diferencat dhe pabarazitë në kapacitetet e bashkive vijojnë të kushtëzojnë rrugën e tyre drejt vizioneve zhvillimore të përcaktuara në dokumentet e tyre të ndryshme strategjike.

Së fundi, pjesë e kësaj shtylle strategjike është edhe forcimi i rolit të Këshillit Konsultativ. Ky Këshill u themelua si një platformë diskutimi /dialogu ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për konsultimin e strategjive të reja, politikave dhe legjislacionit që kanë ndikim tek qeverisja vendore. Siç citohet edhe nga Komisioni Evropian (2022)⁶, Këshilli Konsultativ funksionon si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor. Roli i tij ka ardhur në rritje të vazhdueshme si nga këndvështrimi sasior ashtu edhe cilësor i diskutimeve mbi projektaktet e konsultuara, veçanërisht vitet e fundit ku intensiteti i mbledhjeve është rritur ndjeshëm (nga 3 projektakte në 2017 në 236 në vitin 2022).⁷

Tabela 1 . Ecuria e Këshillit Konsultativ ndër vite

	2017	2018	2019	2020	2021	2022*	Total
<i>Projektvendime</i>	0	19	36	18	42	21	136
<i>Total të konsultuara</i>	3	45	60	33	62	33	236
<i>Numri i mbledhjeve</i>	1	7	6	6	6	5	31

Burimi: AMVV (2022)

*Shënim: *Të dhënat deri në shtator 2022; total të konsultuara përfshin projektligje, projektudhëzime, raporte dhe prezantime.*

⁵ AKPT (2022). Nga 9 bashki të mbetura, 5 bashki i kanë planet në proces zbardhjeje, ndërsa 4 janë ende në proces hartimi.

⁶ European Commission Staff Working Document, Albania 2022 Report https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

⁷ Këshilli Konsultativ ka përfituar asistencë teknike nga USAID dhe më pas nga Delegacioni i Bashkimit Evropian.

Strukturat institucionale dhe burimet njerëzore

Zbatimi i politikave nis nga burimet njerëzore dhe kapacitetet e stafit në dispozicion. Sfida e përthithjes së burimeve njerëzore profesionale ndihet edhe më tepër në nivelin vendor. Trendet e migrimit janë përherë e më shumë drejt kryeqytetit apo qyteteve pranë tij. Sipas të dhënave nga INSTAT (2022), rezulton se ka një ulje të popullsisë në të 11 qarqe të vendit, përveç Tiranës e cila shënon rritje. Sipas projeksioneve të popullsisë (Instat 2019) deri në vitin 2031, vetëm popullsia e qarkut të Tiranës pritet të jetë më e lartë se ajo e vitit 2019, duke arritur në rreth 954 mijë banorë.

Sa i përket njësive të vetëqeverisjes vendore, plotësimi i stafit të bashkisë mbetet një ndër çështjet më delikate. Duket se ka vështirësi për të rekrutuar profesionistë në disa profile si ekonomist, jurist, IT por edhe për profile të tjera si agronom, inxhinier ndërtimi, arkitekt, etj. Këto vështirësi lidhen me mungesën e interesit për të punuar në bashki (posaçërisht ato bashki që ndodhen gjeografikisht larg kryeqytetit); paga e ulëta dhe mungesën në treg për profesione të caktuara.

Në nivelin vendor del qartë nevoja për të patur një model bazë mbi të cilin të ngrihen të gjitha strukturat e bashkisë. Në varësi të karakteristikave të zonës ku këto bashki ofrojnë shërbimet e tyre, njësi/drejtori të caktuara mund të jenë më shumë apo më pak të strukturuar. Në këtë kontekst, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, mbështetur nga projekti STAR ka krijuar disa modele strukturash. Shumë bashki i kanë përdorur këto modele si referencë. Edhe pse bashkitë dhe ndërmarrjet kanë autonominë e tyre për t'i ndërtuar strukturat sipas specifikave dhe prioriteteve të tyre, dakordësia mbi një model bazë orientues do të ishte vlerë e shtuar për mirëorganizimin e punës dhe të burimeve njerëzore në dispozicion.

Zbatimi i një modeli të unifikuar orientues në bashki do të jetë baza mbi të cilën do të mund të ngrihen një sërë nismash që do të ndikonin pozitivisht në ecurinë e punës. Pa struktura të qarta, nuk do të mund të ngrihen as njësitë e përbashkëta ndërmjet bashkive. Për më tepër, ligji nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore', përcakton edhe krijimin e njësive të menaxhimit të performancës në çdo bashki (Neni 33 "njësia vendore do të jetë përgjegjëse për krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor"). Karta Evropiane e Autonomisë Vendore duhet të konsiderohet në të gjitha hapat apo propozimet që do të bëhen sepse është thelbësore që në këtë proces dhe në të gjitha propozimet që do të bëhen, të mos çenohet autonomia vendore.

Vlerësimi i nevojave për trajnim kryhet çdo dy vjet nga ASPA. Procesi më i fundit është kryer në 2019 ndaj dhe është momenti për të përfshirë një aktivitet të dedikuar për një vlerësim të tillë. Mënyrat e vlerësimit të nevojave për trajnim duhet të ri-dimensionohet dhe të shkojnë përtej mbledhjes së kërkesave të nevojave nga punonjësit. Procesi duhet të kryhet në linjë më prioritete strategjike të vendit dhe të reflektojë nevojat për trajnim për procese që njësitë e qeverisjes vendore kryejnë dhe të reja që do të duhet të kryejnë në kuadër të procesit të integritetit. Çdo nëpunës civil është një burim që duhet të vlerësohet, motivohet, zhvillohet dhe t'i vihen në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për të përmbushur objektivat e institucionit që përfaqëson. Gjatë këtij procesi, është shumë e rëndësishme që kompetencat e nëpunësit të përshtaten me nevojat e vendit të punës dhe të kapërcehet çdo boshllëk në aftësitë përkatëse, nëpërmjet trajnimit. DAP dhe ASPA po punojnë për të hedhur disa ide mbi zhvillimin e një sistemi efektiv për vlerësimin e trajnimit, që do të gjenerojë më


shumë të dhëna lidhur me cilësinë e trajnimit, arritjen e objektivave dhe matjen e ndikimit të trajnimit në performancën individuale, të institucionit dhe të sistemit në tërësi. Praktikrat pozitive mund të replikohet edhe tek njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në vijim, hartimi i politikave të trajnimit bazuar në, eksperiencën e vetë institucionit, kërkesat e legjislacionit, prioritetet vjetore, procesin e integritimit në BE dhe rezultatet e nevojave për trajnim, është i një rëndësie të lartë. Shoqatat e bashkive do të duhet të japin kontributin e tyre në përcaktimin e nevojave prioritare për trajnim.

Lidhur me bashkëpunimin ndërvendor për krijimin e njësive të përbashkëta, ligji për Vetëqeverisjen Vendore rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Të drejtat dhe përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore përfshijnë edhe “të drejtën e bashkëpunimit, sipas së cilës: për kryerjen e shërbimeve specifike në emër dhe në dobi të komuniteteve përkatëse, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësisë të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë”. Ky model bashkëpunimi nuk është aplikuar gjerësisht qoftë në formën e bashkëpunimit ndërvendor apo në forma të tjera delegimi drejt bashkive të tjera apo drejt nivelit të qarkut. Megjithatë, disa studime tregojnë qartë potencialin e optimizimit të shërbimeve dhe kostove përkatëse ndëpërmjet delegimit apo bashkëofrimit të shërbimeve.

B. Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale

Ecuria e treguesve kryesorë fiskalë dhe financiarë të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri ka qenë pozitive, me tregues të përmirësuar dukshëm krahasimisht me periudhën para strategjisë. Në veçanti, forcimi i financave vendore është një ndër sukseset e agjendës së decentralizimit pas riorganizimit administrativo-territorial. Rritja e përgjegjësisë të qeverisjes vendore, shoqëruar me një kuadër ligjor të dedikuar, solli si domosdoshmëri edhe një kërkesë për autonomi më të madhe fiskale. RAT ndikoi direkt në performancën financiare të NJVV-ve duke rritur me rreth 2.3 here të ardhurat nga taksat e veta vendore në vitin 2022 krahasuar me vitin 2015. Ndërkohë, shpenzimet vendore në vitin 2022 janë rritur me 60% krahasuar me vitin 2015.


Figura 1: Te ardhurat dhe shpenzimet vendore, 2015-2022



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Pesha e të ardhurave të buxhetit vendor ndaj PBB-së është dyfishuar (1.63% në 2021 krahasuar me 0.82% në 2015). Ndërsa, të ardhurat nga burimet e veta (të ardhura tatimore dhe jotatimore) të njësive të vetëqeverisjes vendore në vitin 2021 kanë arritur në vlerën 29.4 miliard lekë, me një rritje prej 151% krahasuar me vitin 2015 (11.7 miliardë lekë). Kështu, në mënyrë akumulative që nga viti 2015, të ardhurat vendore kanë një rritje të dukshme, ku qeverisja vendore ka më shumë mjete financiare, e cila rezulton nga një rritje e burimeve të veta vendore, taksat e ndara dhe transfertat ndërqeveritare. Mbi 80% e NJVV-ve shënojnë rritje të konsiderueshme të të ardhurave të veta vendore, duke konsoliduar në këtë mënyrë kapacitetin e tyre fiskal për financimin e shërbimeve vendore.

Figura 2: Të ardhurat e veta vendore në raport me të ardhurave publike dhe PBB-në.




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke marrë në analizë burimet e veta vendore të cilat në vite kanë pësuar një rritje të konsiderueshme, të ardhurat nga taksat e pasurisë kanë arritur 6.1 miliardë lekë ose 56% më shumë se në vitin 2015, falë rikonceptimit dhe përmirësimit të theksuar të mbledhjes dhe administrimit të tyre. Fuqizimi i pushtetit vendor për të realizuar politika zhvillimore është reflektuar në rritje të të ardhurave nga “taksa e ndikimit në infrastrukturë” në rreth 9.5 miliardë lekë, ose rreth 8.1 miliardë lekë më shumë se të ardhurat para reformës nga ky burim i pushtetit vendor.

Rritja e cilësisë së shërbimeve direkte që përfitojnë qytetarët është reflektuar në rritjen e të ardhurave nga tarifat vendore ku vetëm “Tarifa e pastrimit” çdo vit pas reformës është rritur me një mesatare 500 milion lekë në të gjithë pushtetin vendor. Megjithatë, duhet theksuar se tarifa e pastrimit mbetet në nivele relativisht të ulta në krahasim me kostot e shërbimit. Po ashtu, taksa e ndikimit në infrastrukturë përbënte rreth 32% të të ardhurave të veta vendore në vitin 2021 dhe është elementi kryesor që ndikon në rritjen e të ardhurave të veta, krahas taksave të pasurisë. Rritja e taksave të pasurisë ndihmon në një rritje të qëndrueshme të burimeve, në ndryshim nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të ardhurat jotatimore.

Edhe pse në shtatë vitet e fundit pushteti vendor ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetin financiar, nivelet e decentralizimit fiskal në Shqipëri diktojnë nevojën e një autonomie më të madhe fiskale si në këndvështrimin e burimeve ashtu edhe në diskrecionin e plotë të normës së taksës vendore; shoqëruar me performancë nënoptimale (e shprehur në nivel relativisht të ulët të mbledhjes së të ardhurave të veta). Rritja e të ardhurave vendore do të duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në rritjen e të ardhurave nga tatimi mbi pronën, nëpërmjet zgjerimit të bazës së tatimit dhe të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve. Të ardhurat e veta të bashkisë plotësohen nga transfertat e pakushtëzuar (transferta e përgjithshme dhe sektoriale), e cila synon mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojës për shpenzime) dhe të ardhurave të bashkive që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal). Transferta alokohet tek bashkitë sipas formulës së përcaktuar në ligjin nr.68/2017 dhe merr në konsideratë elemente inovative, bazuar tek parimi i ekualizimit (fiskal dhe ai i kostove të shërbimit), ku popullsia relative, dendësia e popullsisë dhe numri faktik i fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme janë pjesë e formulës⁸.

Figura 3: Të ardhurat e veta vendore sipas burimit 2010-2021.




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Mbështetja e qeverisë qendrore me transfertën e pakushtëzuar është rritur në mënyrë progresive pas miratimit të Ligjit për Financat Vendore, gjë e cila ka sjellë një parashikueshmëri më të madhe të të ardhurave të veta. Kjo mbështetje ka qenë e qëndrueshme pavarësisht problemeve si pasojë e pandemisë COVID-19, tërmetit, krizës ekonomike dhe asaj energjitike. Në vitin 2015 (viti para reformës administrative territoriale), transfertat e pakushtëzuar ka qenë në vlerën 12.3 miliardë, ndërkohë në vitin 2021 ka qenë në vlerën 18.4 miliardë lekë, pra me një rritje prej 49.5%.

⁸ Mbështetje është dhënë nga projekti plgp i USAID dhe më pas nga projekti Financat Lokale i SECO.

Figura 4: Detyrimet e prapambetura në nivel vendor, 2015-2021




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Lidhur me stokun e detyrimeve të prapambetura, viti 2021 shënoi vlerën e 6.5 miliardë lekëve, krahasuar me vitin 2015 ku shënon një ulje prej 45%. Ndërkohë, detyrimet e prapambetura për qeverisjen vendore në vitin 2016 kanë qenë në vlerën rreth 12.1 miliardë lekë, dhe krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2022 janë ulur me rreth 5 miliardë lekë ose rreth 41%.

Duke iu referuar përdorimit të burimeve, pra decentralizimit të shpenzimeve, matur me shpenzimet e qeverisjes vendore ndaj PBB-së nominale ose shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme, ka një rritje gjatë viteve, që prej 2015. Ulje të vogël (me 0.1 pikë përqindje) ka pasur në vitin 2020 si pasojë e tkurrjes të shpenzimeve kapitale nën tryshninë e pandemisë Covid-19. Pesa e shpenzimeve të qeverisjes vendore në buxhetin e shtetit ka arritur masën 2.97% në 2021 nga 2.38% në 2015 (shih Figura 3). Shpenzimet e qeverisjes vendore janë rritur ndjeshëm që nga viti 2015, konkretisht me 54% (52,6 miliardë në 2021 krahasuar me 34,1 miliardë në 2015), duke ndikuar drejtpërsëdrejti në ekonominë e vendit (nëpërmjet investimeve infrastrukturore), ashtu edhe konsumin (nëpërmjet pagave të punonjësve). Në këndvështrimin financiar vendor, pas RAT, vihet re një përmirësim i strukturës buxhetore, ku bashkitë e orientojnë atë drejt më shumë investimeve dhe shërbimeve publike.

Një tjetër element për t'u marrë në konsideratë është edhe krahasimi i trendit të rritjes së shpenzimeve ndaj të ardhurave vendore. Shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur me 67.6% (sipas shifrave të raportuara më lart dhe në Figurën 3), ndërsa të ardhurat nga taksat vendore janë rritur me rreth 217% ose mbi 2 herë (11.7 miliardë lekë në 2015 në 26.6 miliardë lekë në 2021). Kjo rritje është reflektuar në rritjen e nivelit të shpenzimeve për investime, e cila ka çuar në një përmirësim sasior dhe cilësor të ofrimit të shërbimeve publike të deleguara tek bashkitë si arsimit parashkollor, parauniversitar, administrimi i pyjeve, menaxhimi i rrugëve, mbrojtja dhe shpëtimi ndaj zjarrit, shërbimi i përkujdesjes sociale, ujitja dhe kullimi, etj.

Figura 3: Buxheti Vendor në vite në raport me të shpenzimet e përgjithshme dhe PBB-në.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Përvec aspekteve fiskalë, financat vendore njohin përmirësim edhe përsa i përket aspektit rregullator si prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA (rritja e cilësisë së monitorimit), ulja e numrit të programeve buxhetore (nga 36 programe në 20 programe buxhetore) dhe fillimi i një faze të re pilotimi për PBA-në, monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të Buxhetit në funksion të zbatimit të politikave buxhetore, përgatitja dhe publikimi periodik dhe vjetor i raportit të analizës së financave publike vendore, si edhe ndër të tjera, hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, “Mbi statusin e vështirësive financiare të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”.

C. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor

Në fushën e funksioneve të veta, si ato historike ashtu edhe ato të deleguara në kuadër të thellimit të procesit të decentralizimit, në tërësi, vërehen përmirësime të konsiderueshme. Rikonfigurimi i qeverisjes vendore ka mundësuar hedhjen e hapave cilësorë në sigurimin e shërbimeve, veçanërisht në ofrimin e shërbimeve sociale, menaxhimin e mbetjeve të ngurta; menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë, planifikimit dhe realizimit të investimeve të një shkalle më të gjerë. Në mënyrë të përmbledhur, disa nga arritjet kryesore që evidentohen si në nivel objektiv strategjik, ashtu edhe në nivel funksioni janë si më poshtë vijon:

Arsimi parashkollor

Arsimi parashkollor është një ndër funksionet, i cili vjen me përgjegjësi të ndara midis qeverisjes vendore dhe asaj qendrore ndërsa aspekte të caktuara të shërbimit ofrohen/ushtrohen vetëm nga qeverisja qendrore. Konkretisht, qeverisja vendore është përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin si dhe financimin e këtij shërbimi publik. Nga RAT, numri i kopshteve është rritur me

259 (1897 në 2015 kundrejt 2156 në 2021), e shoqëruar njëkohësisht me rritje të numrit të edukatoreve me rreth 467 (4672 në 2015 në 5141 në 2021). Ky funksion financohet përmes transfertës sektoriale, e cila rezulton në rritje që nga momenti i transferimit të këtij funksioni qeverisjes vendore, dhe mbulon shpenzimet për personel mësimor dhe jomësimor (Figura 4). Lidhur me transfertën sektoriale për këtë funksion, rritja ka qenë me ritme të shpejta në vitin 2018 (12%), e me ritme më të moderuara në vitet pasuese (në 2020 me 2% e 2021). Lidhur me arsimin parauniversitar, transferta sektoriale shkon në përfitim të 57 bashkive. Transferta shënoi një rritje prej rreth 32% në vitin 2018, duke pasuar me rritje të moderuar në vitet pasardhëse (1% në vitin 2020, 3% në vitin 2021).

Shërbimet Sociale

Shërbimet sociale janë funksion i decentralizuar, ku bashkitë kanë autoritet të plotë mbi ngritjen dhe menaxhimin e shërbimeve sociale për personat vulnerabël, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë beqare kryefamiljare, gratë viktime të dhunës në familje, viktimat e trafikimit; prindërit me shumë fëmijë, të moshuarit etj., në përputhje me dispozitat ligjore. Roli i bashkive në planifikim, buxhetim dhe ofrim të shërbimeve sociale, ashtu edhe ri-integrim social të individëve në nevojë, është i qartë nga dispozitat e ndryshme ligjore, por instrumentet për ofrimin mbeten të paqarta dhe jo të mjaftueshme.

Ndër të tjera, një progres i këtyre viteve, sikurse parashtrohet tek SNDQV dhe plani i tij i përditësuar i veprimit është edhe hartimi nga ana e qeverisjes vendore të planeve sociale, si edhe udhëheqja e ofrimit të shërbimeve sociale. Qëllimi kryesor është pikërisht mundësimi dhe shpërndarja e shportës së shërbimeve bazuar në nevojat lokale dhe rajonale. Aktualisht, 60 bashki kanë hartuar plane sociale vendore krahasuar me zero bashki në vitin 2015.

Krijimi i shërbimeve të koordinuara të riintegrit për përfituesit e Ndhmës Ekonomike dhe komunitetet e cënueshme është një objektivi i përfshirë në të gjitha planet sociale vendore, megjithatë kapacitetet për t'u përfshirë në riintegrim variojnë sipas bashkisë. Lidhur me numrin e shërbimeve sociale, raportohet nga MSHMS se ky numër ka pasur progres të vazhdueshëm ndër vite. Aktualisht, ofrohen 493 shërbime sociale nga 339 institucione publike, jo publike dhe të formës së përzier. 46% e shërbimeve sigurohen nga institucione publike, ndërsa pjesa tjetër sigurohen nga institucione jo publike. Në të gjithë vendin, përfitojnë shërbime sociale 42,553 individë ose 1.5% e popullsisë për vitin 2021. Përtej progresit strategjik, bashkitë përballen me sfida në lidhje me shtrirjen e shërbimeve, burimet njerëzore dhe financiare, cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre. Në rang vendi raportohet se janë 244 qendra të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Më konkretisht, gjatë vitit 2021 janë hapur 16 shërbime të reja sociale për të gjithë target grupet në nevojë. Këto shërbime kanë një shtrirje gjeografike në të gjithë vendin⁹.

Ndërsa, lidhur me programet “cash” për reduktimin e varfërisë (skema e Ndhmës Ekonomike (NE), dhe asistencë për personat me aftësi të kufizuara (pagesa për PAK dhe kujdestarët e tyre), bashkitë nuk kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë në menaxhimin e këtyre programeve, por operojnë në emër të qeverisë qendrore për të lehtësuar procesin e aplikimeve dhe për të paguar përfitimet.

⁹ Shërbimi Social (2022) <https://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2022/01/raporti-vjetor-2021-full.pdf>

Kujdesi shëndetësor parësor

Sipas ligjit organik të qeverisjes vendore, kompetencat bashkiake në lidhje me kujdesin shëndetësor parësor kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e mjediseve të kujdesit shëndetësor parësor (në të njëjtën mënyrë si në arsimin parauniversitar) dhe me disa funksione të shëndetit publik. Në praktikë, të gjitha këto funksione mbahen plotësisht nga qeverisja qendrore, ndonëse disa qeverisje vendore kryejnë punime mirëmbajtjeje në shkallë të vogël për qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.

Infrastruktura dhe shërbimet publike

Investimet publike

Investimet në projektet e infrastrukturës dhe shërbimet publike janë natyrshëm funksioni ku ka kërkesa e pritshmëri më të mëdha, por edhe ku shpenzohet pjesa më e madhe e buxhetit nga NJVV-të. Investimet financohen nga buxheti i bashkive (të ardhurat apo transferta e pakushtëzuar e përgjithshme apo sektoriale), ose nga agjenci të specializuara të Qeverisë Qendrore (FSHZH, AKUM, Ministria e Arsimit, Bujqësisë Shëndetësisë, etj). Investimet kapitale vendore veçanërisht nga të ardhurat e veta janë në përgjithësi të ulëta dhe të paqëndrueshme. Një pjesë e konsiderueshme e tyre vjen nga grantet e kushtëzuara, përfshirë Fondin e Zhvillimit të Rajoneve apo investime të drejtpërdrejta nga Ministritë e Linjës.

Roli i NJVV në skemat kombëtare të financimit të investimeve në territoret dhe funksionet e tyre duket se ka ardhur në zbehje. Roli i bashkive në propozimin, vendimmarrjen, përgatitjen e studimeve dhe projekteve, prokurimin dhe zbatimin e projekteve të investimit në skemat kombëtare në shumicën e rasteve është një rol pasiv përfituesi dhe bashkëpunëtori në zbatim.

Ligji për zhvillimin rajonal dhe kohezionin rregullon programin e zhvillimit ekonomik rajonal dhe orienton investimet kapitale vendore e rajonale drejt këtij qëllimi. Aktet nënligjore për bërjen operacionale të Komiteteve Rajonale dhe Programit Kombëtar Operacional nuk kanë hyrë akoma në fuqi. Këto akte, në zbatim të frymës së ligjit, do të rregullojnë edhe nevojën për rritje domethënëse të prezencës vendore në vendimmarrjen dhe zbatimin e investimeve. Këtu duhet qartësuar roli i NJVV si njësi zbatuese për një pjesë të konsiderueshme të këtyre fondeve, ndërkohë që synohet forcimi i kapaciteteve vendore për menaxhimin me sukses të ciklit të projekteve investuese në infrastrukturë.

Uji i pijshëm

Uji i pijshëm është një tjetër funksion i NJVV-ve, përgjegjëse për furnizimin, prodhimin, trajtimin dhe transmetimin e ujit të pijshëm, ujërave të ndotura e atyre të shiut. Veçanërisht sektori i ujit të pijshëm mbetet një ndër sektorët me ndryshime të rëndësishme në kohë si në aspektin e zhvillimit të legjislacionit, decentralizimit e funksionit, mbështetjen financiare nga ana e pushtetit qendror, ashtu edhe nga partnerët për zhvillim, me investime të mëdha infrastrukturore dhe fuqizim të strukturave qeveritare menaxhuese dhe ndërmarrjeve për shërbimin e Ujësjellës-Kanalizime (UK).

Në tërësi, ky sektor njih përmirësime të vazhdueshme në aspektin e cilësisë së ujit, edhe pse shoqërohet me probleme, si për shembull informalitet, amortizim të sistemit të furnizimit, apo edhe efektshmëri të ulët operacionale. NJVV veprojnë si aksionerë të vetëm të ndërmarrjeve të ujësjellësve (58 Shoqëri të UK dhe 151 sisteme të ujësjellësve rurale). Si pasojë e RAT, mbulimi i territorit, e

veçanërisht të zonave rurale, u rrit. Gjithsesi, në referencë të reformës në këtë sektor në vitin 2016 (riorganizimi i shoqërive UK sipas parimit 1 shoqëri = 1 bashki), raportohet se zbatimi nuk është përfunduar nga të gjitha shoqëritë UK/bashkitë. Riorganizimi i sektorit rezultoi një sfidë mjaft e madhe për shoqëritë dhe bashkitë për t'u realizuar në formën e kërkuar brenda afateve të përcaktuara (procesi i inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të aseteve). Aktualisht, 58 shoqëritë UK, me 100% të aksioneve në zotërim nga NJVV, përballen me një performancë të dobët financiare, nga ku 46 shoqëri subvencionohen nga qeveria qendrore për mbulimin e kostove operacione të mirëmbajtjes.

Kësisoj, me qëllim përmirësimin e ofrimit të këtij shërbimi, qeveria qendrore planifikoi zbatimin e një reforme thelbësore në sektor me qasje kryesore rajonalizimin përmes agregimit të shoqërive të UK. Në vijim, kuadri i përditësuar ligjor (VKM nr.302, datë 11.05.2022), udhëzoi agregimin e Shoqërive të UK në 15 subjekte me kompetenca të përbashkëta, proces i cili përfundoi për shumicën e bashkive. Qëllimi i reformës është të përmirësojë sigurimin e furnizimit me ujë dhe të shërbimeve të kanalizimeve në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, duke mbrojtur mjedisin, shëndetin e sigurinë e qytetarëve, furnizimi i cili duhet të jetë i qëndrueshëm si ekologjikisht, ashtu edhe nga ana teknike dhe financiare përmes mbulimit të plotë të kostos. Reforma parashikon që bashkitë të zotërojnë jo më shumë se 49% të aksioneve, e pjesa tjetër të zotërohet nga MIE. Praktikisht, ky sektor përbën një shembull të një funksioni të decentralizuar në 2015, dhe të strukturuar rishtazi për shkak të problematikave të sipërcituara dhe me qëllim krijimin e ekonomisë së shkallës dhe sigurimin e standardit në ofrimin e shërbimit dhe investimeve të mëdha infrastrukturore.

Transporti publik

Një tjetër funksion i deleguar tek qeverisja vendore është edhe transporti publik, që tashmë, bashkitë nuk e ofrojnë më vetë, por e nënkontraktojnë tek operatorët privatë. Roli i bashkisë është të administrojë dhe monitorojë shërbimet, ku shumica e tyre janë administrative. Bazuar në kuadrin rregullator dhe specifikën e këtij funksioni, bashkitë duhet të kryejnë shërbimet që lidhen me administrimin e transportit ndërqytetas, miratimin e linjave, stacionet dhe skedulit të transportit, si edhe të përcaktojnë dhe monitorojnë tarifën lidhur me këtë shërbim.

Lidhur me funksionin tjetër të bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore, përgjithësisht bashkitë e zotërojnë këtë funksion përsa i përket ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve. Sinjalizimi rrugor mbetet një shërbim që kërkon më shumë vëmendje nga ana e qeverisjes vendore, me qëllim mbulimin e territorit me sinjalistikën përkatëse rrugore.

Të tjera

Duke kaluar tek funksionet e tjera mbi ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit, shërbimin e dekorit publik dhe atë të parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike, përgjithësisht bashkitë ofrojnë në mënyrë të plotë këto shërbime, por respektimi i standardeve (p.sh. të ndërtimit), veçanërisht për shërbimin e parë, mbetet një aspekt për t'u përmirësuar.

Mjedisi

Në fushën e mjedisit, ligji 139/2015 u jep përgjegjësi bashkive për marrjen e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, masat kundër ndotjes akustike dhe aktivitete promovuese mbi mbrojtjen e mjedisit. Gjithsesi, zbatimi i këtij funksioni mbetet i kufizuar nga ana e bashkive, ashtu edhe me nevojë për financim me qëllim ofrimin sa më efikas të shërbimeve të lidhura. Nga ana tjetër, duket se zbatimi i këtij funksioni ka ende paqartësi për sa i përket ndarjes së pushteteve mes niveleve të ndryshme të qeverisjes. Madhësia, aftësia, vullneti i NJVV dhe transferimi i drejtë i fondeve nga qeveria qendrore në atë vendore për të kompensuar kostot shtesë, janë faktorë përcaktues në nivelin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga njësitë e qeverisjes vendore. Shumë prej bashkive kanë kryer investime në ngritjen dhe/ose përmirësimin e rrjetit të kanalizimeve, me fokus në zonat bregdetare, apo edhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane, mbjelljen e pemëve dhe fushata ndërgjegjësuere për mbrojtjen mjedisit¹⁰ si masa për përmirësimin e mjedisit. Ndërsa, AKM ka një rol më proaktiv në fushatat ndërgjegjësuere të monitorimit të cilësisë së mjedisit, roli i bashkive mbetet për t'u forcuar më tutje. Sikurse dhe shërbimet e tjera, përcaktimi i standardeve minimale të aprovuara të shërbimeve mbetet për t'u adresuar në vijim, çka do të ndihmojë edhe në programim më të saktë të shpenzimeve nga ana e NJVV-ve.

Mbetjet

Administrimi i mbetjeve konsiderohet një funksion me ecuri pozitive lidhur me efikasitetin e shërbimit. Mbulimi i popullsisë me shërbimin bazë është përmirësuar dukshëm (60% në 2015 në 89% në 2021)¹¹. Shërbimi i mbledhjes, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve drejt impianteve të trajtimit, si një përgjegjësi e qartë e NJVV, është përmirësuar dukshëm.

Shqipëria ka një normë të ulët riciklimi dhe një varësi të lartë nga landfillet, ku zhvillohet procesi/shërbimi i grumbullimit të mbetjeve, me kosto të lartë mjedisore. Riciklimi dhe kompostimi mbeten objektiva të rëndësishëm në kuadër të integritetit në BE, por janë ende në fazat e parë të rregullimit. Gjithashtu, sfida mbetet financimi i këtij shërbimi me tarifatat që të mbulojnë koston e shërbimit apo edhe arritjen e standardit dhe zbatimin e direktivave të BE-së.

Zhvillimi Ekonomik Vendor

Lidhur me zhvillimin ekonomik vendor, SNDQV dhe Ligji organik nr.139/2015 e konsiderojnë qeverisjen vendore aktor kryesor të zhvillimit ekonomik vendor, përmes funksioneve dhe kompetencave në fushën e zhvillimit bujqësor, përgjegjësi që lidhen me nxitjen dhe mbështetjen e biznesit, instrumenteve financiare mbështetëse për biznesin dhe fermerët, etj. Megjithëse konstatohen vlera pozitive të rritjes ekonomike, punësimit dhe kornizave strukturore për sipërmarrjen, vlerësohet se nuk është arritur optimumi i përdorimit të kapitaleve natyrore si dhe kapaciteteve njerëzore.

¹⁰ Agjencia Kombëtare e Mjedisit (2022). <https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/>

¹¹ INSTAT (2022).

http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_EN_MU/MU02/table/tableViewLayout1/

Gjatë viteve të fundit, ky funksion nga ana e bashkive është fokusuar më së shumti tek administrimi i territorit dhe zhvillimi bujqësor. Lidhur me të parën, toka konsiderohet aset themelor, që lidhet me urbanizimin dhe infrastrukturën, të cilat përbëjnë elementë të zhvillimit në tërësi. Ndaj, Planet e Përgjithshme Vendore konsiderohen si një gur themeli në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe si të tillë ato ndikojnë drejtpërdrejt mbi të ardhurat vendore. Aktualisht, rreth 90% e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore kanë hartuar dhe janë duke zbatuar Planet e Përgjithshme Vendore (pjesa tjetër në proces përfundimi)¹².

Në vijim, mbetet që bashkitë të përpunojnë planet e detajuara vendore, planet e zhvillimit apo mbarështimit të pyjeve, etj.), si elementë të rëndësishëm të qasjes gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të zhvillimit vendor. Ka Bashki si Tirana, Shkodra apo Korça të cilat kanë mundur të konkretizojnë vizionin e tyre zhvillimor në plane konkrete strategjike, të cilat orientojnë punën e bashkive. Për shembull, bashkia Tiranë (Tirana 2030) ka hartuar një master-plan, me prioritete të qarta strategjike, duke e planifikuar kryeqytetin jo vetëm në aspektin urbanistik, por edhe atë ekonomik.

Përveç planeve të territorit, në periudhën pas RAT, bashkitë janë fokusuar në vijimin dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe infrastrukturës bazë social-ekonomike dhe shtrirjes së tyre në territor duke rritur mbulimin territorial. Ndërsa funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor janë komplekse dhe shumë aktoriale (bashkia, qarku, qeveria qendrore dhe aktorë të tjerë si biznes, shoqata, donatorë), instrumentet/nxitësit e marrëveshjeve ndërbashkiake mbeten ende të paeksploruara. Ndonëse ka disa raste të marrëveshjeve përgjithësisht ndërbashkiake (rasti i mbetjeve në qarkun Korçë), sërish shfrytëzimi i këtij instrumenti është në nivele të ulta. Në të njëjtën linjë, roli i qarkut mbetet i paqartë lidhur me përdorimin e ekonomisë së shkallës si një argument për bashkëpunimin ndërvendor. Nga ana tjetër, Grupi Vendor i Veprimit (LAG/GVV), një instrument i zhvillimit bujqësor/rural nëpërmjet sipërmarrjes dhe punësimit lokal, është prezantuar në funksionin e zhvillimit bujqësor, por ende nevojë të konsolidohet.

Ekonomia e çdo NJVV-je ka evidenca të sektorëve ekonomikë që kontribuojnë me punësim, të ardhura të gjeneruara (taksa), investime kapitale dhe fitime të aksionerëve. Gjithashtu, NJVV kanë të evidentuara të gjitha burimet natyrore në rajonin e tyre. Në këto kushte hartimi i planit strategjik nënkupton thjesht angazhimin e aktorëve dhe vendosjen e prioriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm.

Në këtë kontekst, Bashkia Tiranë ka një Plan Strategjik të ndërtuar në vitin 2021 në referencë të ligjit 139/2015. Ky plan ka dhënë efekte pozitive duke e fokusuar punën e kësaj bashkie në prioritete strategjike me vlerë të shtuar për ekonominë e rajonit. Gjithsesi, rezulton se ky plan është i njëanshëm pasi është ndërtuar vetëm në këndvështrim dhe me aktor të vetëm institucionin e bashkisë. Megjithë punën voluminoze për hartimin e tij si edhe një sërë detyrash të përcaktuara për procesin e monitorimit, përfshirja e aktorëve ekonomik në juridiksionin e kësaj bashkie do e kishte bërë edhe më të qëndrueshëm si plan.

¹² AKPT (2022). <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732>. Bashkitë Tepelenë, Dropull, Memaliaj, Selenicë, dhe Shijak ende nuk i kanë hartuar planet e tyre.

Ndërsa, zhvillimi ekonomik vendor kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse, që fillon me krijimin e një mjedisi miqësor me biznesin dhe organizatat joqeveritare, shfrytëzimin e kapitalit natyror dhe asetëve vendore për qëllim të gjenerimit të të ardhurave, thithjen e fondeve dhe shfrytëzimin e ekonomive të shkallës për të ulur kostot etj. Në këtë kontekst, investimet e huaja, menaxhimi dhe regjistrimi i pronës, zhvillimi rural, projektet e BE-së duhet të jenë prioritete për zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Lidhur me kapitalin natyror, ka pasur iniciativa konkrete për inventarizimin e asetëve/kapitalit natyror të bashkive. Me mbështetjen e prezencës së OSCE në Shqipëri, është hartuar një metodologji për vlerësimin e kapitalit natyror (tërësia e asetëve natyrore si minerale, naftë, pyje, etj.) dhe proceseve të tjera që kanë të bëjnë me natyrën (agronomi, energji, etj.), të cilat sjellin përfitime dhe/ose shërbime të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta.

Vlerësimi i kapitalit natyror u vjen në ndihmë bashkive, duke marrë në konsideratë se burimet natyrore në Shqipëri në pjesën më të madhe të tyre janë në pronësi dhe administrim shtetëror (pyje, ujërat, mineralet, naftë/gaz, etj.), ndërsa një pjesë e vogël e tyre janë edhe në pronësi dhe përdorim privat (tokat bujqësore, tokat urbane, sipërfaqe pyjore, etj.).

Ligji i vetëqeverisjes vendore parashikon që NJVV-të kanë të drejtë të gjenerojnë të ardhura nga përdorimi, shitja ose dhënia me qira e asetëve të bashkisë. Megjithatë, procesi i transferimit të pronësisë ligjore mbi pronat e bashkive l shoqëruar me procesin e regjistrimit kontabël të tyre është larg të qenit i përfunduar, duke penguar kështu qoftë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e objekteve, qoftë edhe shfrytëzimin e këtij burimi të rëndësishëm të të ardhurave në bashki.


Kësaj i shtohet sfida e sigurimit të titujve të pronësisë, pamundësia financiare e një pjese të madhe të NJVV-ve për të përballuar kostot e transferimit dhe regjistrimit, si dhe bashkëpunimi institucional jo në nivelin e duhur me institucionin qendror të regjistrimit të pasurive. Kostoja e përgatitjes së materialeve të regjistrimit të pronës (prodhimi i materialeve hartografike si plane rilevimi dhe plane të cilat kërkohen si pjesë e dokumentacionit të regjistrimit), rezulton në një shumë të konsiderueshme në varësi të numrit të pronave për t'u regjistruar. Tarifa e regjistrimit, e pagueshme pranë ZRPP-së në momentin e aplikimit për regjistrim i shtohet koston totale të regjistrimit të pronave vendore.

Rëndësia e këtyre planeve është e madhe, duke qenë se këto akte orientojnë NJVV-të, si në aspektin zhvillimor duke zbatuar politika, ashtu edhe në atë të përdorimit të burimeve si njerëzore dhe ekonomike. Ekonomia e çdo bashkie ka evidenca të sektorëve ekonomikë që kontribuojnë me punësim, të ardhura tatimore, investime kapitale dhe fitime të aksionerëve, bazuar kjo edhe në inputet vendore si asete/burime, kapital njerëzor, etj. Në këtë kontekst, hartimi i planeve strategjike i jep bashkive rol menaxhues për angazhimin e aktorëve vendorë dhe vendosjen e prioriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm.

Sikurse edhe vetë zhvillimi ekonomik në nivel vendor mbetet i vështirë të deduktohet pa funksionet e qeverisjes vendore, me fokus në turizëm, trashëgimia kulturore, mjedisi, energjia dhe patjetër menaxhimi i asetëve, sikurse aspekte e reja si për shembull inovacioni. E ndërsa politikat e zhvillimit vendor të bashkive apo qoftë edhe ato të atij rajonal dhe qendror janë ende jo të konsoliduara, veçanërisht në shfrytëzimin e funksioneve të sipërpërmendura për qëllime ekonomike, rol të rëndësishëm luan FSHZH, veçanërisht në kontekstin e ri ku ky i fundit shndërrohet në autoritet menaxhues; roli i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, sipas ligjit 102/2020 "Për zhvillimin rajonal dhe

kohezionin” është mbështetja e bashkëpunimit ndërvendor, ndërrajonal dhe ndërkufitar të njësive të vetëqeverisjes vendore për zhvillimin social dhe ekonomik të rajoneve të zhvillimit.

364558.02 777144.4




Created with Datavrapper

Në fakt, kur flasim për zhvillimin ekonomik vendor, përvec aspekteve të sipërcituara, e rëndësishme është të jepet edhe një pamje e zhvillimit ekonomik në nivel të disagreguar, pavarësisht burimit të këtij zhvillimi. Një vështrim në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) për frymë, në lekë, në nivel qarku, si të dhënat më të disagreguara, paraqiten si në Figurën nr. dhe në hartën vetëm për vitin 2020.

Për të gjithë qarqet, vihet re një rritje e të PBB për frymë që nga viti 2015 (si vit referencë). Gjithsesi, harta tregon qe pavarësisht rritjes, qarqet nuk kanë përfitur njëlloj. PBB për frymë më e lartë vihet re në Tiranë (90,610.65 lekë), Durrës (56,3169.8 lekë), Fier (61,8812.3 lekë) dhe Gjirokastra (61,4012.7 lekë). Ndërsa, kjo PBB pasohet nga Berati dhe Vlora.

Nga ana tjetër, Kukësi (46,803.89 lekë) shënon vlerën më të ulët të PBB-së për frymë. Pavarësisht kësaj, të gjithë rajonet kanë vlera pozitive të rritjes krahasuar me 2015 (normat e rritjes variojnë nga 12% deri në 23%).

Figura 5. PBB për frymë në lekë, në nivel qarku



Burimi: INSTAT

Trashëgimia kulturore

Evidentohet nevoja për qartësimin e funksioneve dhe përgjegjësi në fushën e Trashëgimisë Kulturore në lidhje me rishikimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e një sistemi të integruar të zhvillimit të

zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor e përdorimi i tyre për qëllime të zhvillimit ekonomik. Kjo për shkak të mostransferimit të kompetencave nga Qeveria Qendrore në rastin e kalave dhe objekteve të tjera muzeale si dhe mungesës së inventarëve për të gjitha asetet e tjera të cilat vijnë të jenë të pa shfrytëzuara apo të nënshfrytëzuara. Gjithashtu konsiderohen si të nevojshme skemat vendore për mbështetjen e bizneseve me grante apo shërbime të tjera (FSHZH dhe donatorët).

Në këtë kuadër, ende mbetet një sfidë inventarizimi dhe kontabilizimi i asetëve vendore, procesi i transferimit të pronave publike tek NJVV për qëllime zhvillimi publik (transferimi i asetëve nuk ka përparuar sipas parashikimeve dhe ende mbetet problematike, edhe për shkak të problemeve të akumuluar ndër vite). Si konkluzion, *Zhvillimi Ekonomik Vendor gjën zbatim dhe bëhet eficient pas konsolidimit të terrenit të përshtatshëm të zhvillimit të politikave dhe menaxhimit eficient të asetëve.*

Siguria Publike

Funksionet e bashkive në fushën e Sigurisë Publike përfshijnë administrimin e strukturave të mbrojtjes civile, sipas specifikimeve ligjore, garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, mbarëvajtjen, parandalimin dhe ndërmjetësimin në komunitet në rast të konflikteve, si dhe parandalimin e kundërvajtjeve administrative, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve në këtë fushë. Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (MZSH) përben një aspekt të rëndësishëm të Sigurisë Publike, që edhe pse përgjegjësi direkte e bashkive, në rast të kalimit në një emergjencë civile përfshin edhe institucione të tjera në nivel qendror. Transferimi tek bashkitë konsiderohet një arritje e procesit të decentralizimit, ku në 2021 krahasimisht me 2015 ka më shumë stacione të MZSH për bashkitë, si dhe burime njerëzore dhe pajisje e mjete për ofrimin e këtij shërbimi (38 stacione në 2015 kundrejt 70 stacione në 2020) dhe më shumë mbulim në territor me punonjës për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri dhe shpëtimin (738 punonjës në 2015 kundrejt 1250 punonjës në 2021).

Lidhur me Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike, ngritja e KVSP në 54 bashki të vendit konsiderohet si një hap pozitiv për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional në fushën e rendit dhe sigurisë. Edhe pse procesi i ngritjes së këtyre këshillave nuk është shoqëruar me akte shteruese ligjore dhe nënligjore, bashkitë e konsiderojnë këtë forum dialogu ndërinstytucional në nivel bashkie si të rëndësishëm për adresimin e problemeve të komunitetit. Kështu, në 2021 janë ngritur dhe funksionojnë e gjithsej 54 KVSP në nivel bashkie.

Së fundmi, ligji i ri i mbrojtjes civile nr.45/2019 përcakton përgjegjësi direkte të autoriteteve vendore në fushën e mbrojtjes civile me qëllim parandalimin, përballimin, vlerësimin e dëmeve dhe rindërtimin. Pa dyshim situatat e jashtëzakonshme të tërmetit dhe pandemisë evidentuan rëndësinë e funksionalitetit të strukturave të emergjencave civile dhe rëndësinë e pushtetit vendor.

D. Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor

Shtylla e katërt dhe e fundit e strategjisë fokusohet te forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të punonjësve të administratës vendore për të dhënë shërbime më të mira, transparenca dhe llogaridhënia në rritje e strukturave të qeverisjes vendore, ashtu edhe

ndjekja e agjendës së integritetit evropian në nivel vendor. Në këndvështrimin e progresit strategjik, ky objektivi është ndër objektivat me realizueshmëri të lartë (84% në nivel objektivi me nënobjektivat D1 dhe D4 me 100%, D2 me 85% dhe D3 me 50%).

Zbatimi i RAT ka shënuar hapa të rëndësishme përpara në drejtim të rritjes së transparencës dhe aksesit në informacion për qytetarët. Të gjithë bashkitë kanë faqe interneti dhe publikojnë vendimet e këshillave të tyre bashkiake. Gjykohet se ka vend për përmirësim në hapjen ndaj qytetarëve dhe angazhimin e tyre, veçanërisht në proceset demokratike (përfaqësimi nga këshillat vendorë dhe praktikatat e konsultimit).

Lidhur me këshillat bashkiakë, pas RAT është plotësuar i gjithë kuadrin procedural dhe rregullator (rregullorja mbi organizimin dhe funksionimin e këshillit, kodi i etikës, rregullorja e konsultimit publik, etj.) dhe asistencë ndaj sekretarëve/sekretariateve të këshillave. Gjithashtu, janë bërë hapa konkrete drejt transparencës së mbledhjeve të këshillit bashkiak duke i transmetuar drejtpërsëdrejti, duke përmirësuar ndërfaqet e Këshillave Bashkiakë sipas standardeve vendore, sikurse edhe funksionimin e regjistrave elektronikë të konsultimit dhe të trajtimit të kërkesave (fizikisht dhe online).

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij objektivi është lufta kundër korrupsionit, e cila mbetet një ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare si në nivel qendror, ashtu edhe vendor. Kjo përfshin forcimin e imazhit të zyrtarit publik në nivel vendor, bazuar tek transparenca dhe përgjegjësia, rritjen e përfshirjes së shoqërisë civile në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e iniciativave të ndryshme me interes dhe ndjeshmëri lokale dhe rritjen e adoptimit të sistemeve që dekurajojnë praktikatat korruptive dhe promovojnë transparencën (lehtësimi i procedurave të ofrimit të shërbimeve dhe krijimin e Zyrave me Një Ndalesë, bërja publike e dokumenteve, konsultimi i politikave dhe përparësitë e zhvillimit, përmirësimi financiar, dhe krijimi i ofrimit të shërbimeve dhe mekanizmave të monitorimit).

Në këtë kontekst, raportohet ecuri e suksesshme lidhur me ndërgjegjësimin e bashkive mbi transparencën dhe integritetin. 21 bashki kanë hartuar dhe janë duke zbatuar plane e tyre të integritetit, ndërkohë që asnjë bashki nuk ka pasur më parë një plan të tillë. Progresi i planeve të integritetit sipas bashkive është sic paraqitet në tabelë:

Tabela 2 Planet e Integritetit sipas bashkive

Viti	2019	2020	2021	2022
Bashkitë me plane integritetit	Patos, Elbasan, Mallakastër, Mat	Gjirokastrë	Durrës	Belsh, Berat, Bulqizë, Lezhë, Përmet, Pogradec, Tiranë, Lezhë, Shijak, Maliq, Has, Kukës, Pukë, Kavajë, Himarë, Roskovec

Burimi: AMVV

Bashkitë kanë tashmë metodologjinë për hartimin e Planit të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes. Kjo përfshin (a) përgatitjen e metodologjisë së Planit të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes, si dhe (b) hartimin, proceset e konsultimit, shqyrtimin dhe finalizimin e dokumenteve të sipërpërmendura. Zbatueshmëria varion nga 50-80% që vitin e parë të hartimit të planit në disa prej

bashkive. Ndërsa procesi i hartimit të këtyre planeve ka ndjekur një qasje vullnetare nga ana e bashkive, tashmë është e nevojshme plotësimi i të gjithë bashkive me plane të personalizuara të integritetit.

Aspekti i fundit i kësaj shtylle ka të bëjë me zbatimin e agjendës së integritetit evropian në nivel vendor nëpërmjet zbatimit të standardeve dhe praktikave të mira të BE-së në nivel vendor, rritjes së kapaciteteve të aplikimit për projekte të financuara nga BE, forcimit të bashkëpunimit ndërbashkiak dhe bashkëpunimit rajonal me NJQV-të në vendet fqinje nëpërmjet programeve ndërkufitare dhe ndërkombëtare. Progresi i rëndësishëm është vënë re në aplikimet për projekte. Në 5 vitet e fundit (2017-2021) bashkitë janë përfituese të 148 projekte, ku pjesa më e madhe e tyre financohen nga programet IPA. Vetëm në 2021, bashkitë janë përfituese të 74 projekteve nga BE. Përtej progresit, duke qenë se rreth 70% e legjislacionit të BE do të duhet të zbatohet në nivel vendor, agjendës së decentralizimit i lipset të adresojë këtë çështje me një vëmendje të shtuar. Gjithashtu, kjo kërkon edhe përmirësim të bashkërendimit midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore drejt agjendës së përbashkët të integritetit evropian dhe forcimit të kapaciteteve të tyre në përthithjen e sa më shumë fondeve të BE-së.

Patjetër, përpjekjet për një qeverisje të mirë vendore në shërbim të komunitetit dhe për institucione vendore të konsoliduara janë dhe duhet të përbëjnë një proces të vazhdueshëm, që konsolidohet dhe synon progres në arritjen e objektivave afatgjata.

2.2 Konsiderata dhe mësimet të nxjerra

Një konsideratë e rëndësishme transversale që ka shoqëruar gjithë procesin e hartimit të SNDQV dhe planit të saj të veprimit është qartësimi se agjenda e decentralizimit ka nevojë të konsolidohet në funksionet ekzistuese. Përvetësimi dhe forcimi i rolit të bashkive në ushtrimin e funksioneve tashmë të deleguara është një qasje e mirëmbështetur si nga aspekti ligjor, ashtu edhe ai administrativ dhe financiar. Ndaj, një qartësim dhe rikalibrim (ku është e nevojshme) i aspekteve të sipërcituara do të shërbente në mënyrë të drejtpërdrejtë cilësisë së ofrimit të shërbimit tek qytetarët.

Decentralizimi simetrik kundrejt decentralizimit asimetrik mbetet një çështje për diskutim, analizë dhe vendimmarrje. Nëse decentralizimi asimetrik është një opsion i realizueshëm në të ardhmen, kjo kërkon analiza të thelluara paraprake mbi zbatimin e të gjitha funksioneve. Asimetria mund të jetë në bazë të disa kriterëve të mirëpërcaktuara (si p.sh. statusi ekonomik i një bashkie, statusi metropol, statusi gjeografik, etj.) Nga ana tjetër, vazhdimi me decentralizimin simetrik sërish kërkon hulumtime mbi shfrytëzimin e marrëveshjeve ndërvendore për të rritur ekonomitë e shkallës në ofrimin e një/disa shërbimeve. Të tilla marrëveshje janë praktikuar nga bashkitë me njëra-tjetrën, shpesh here në forma modeste e në disa raste edhe të formalizuara (rasti i mbetjeve apo ujësjellësit). Është e qartë se mund të ketë çështje të rëndësishme për t'u analizuar dhe eventualisht përmirësuar në kuadrin ligjor, administrativ dhe fiskal për të lehtësuar përdorimin e këtyre marrëveshjeve. Përfitimet e marrëveshjeve ndërvendore janë gjerësisht të njohura dhe lidhen me ekonominë e shkallës (ulje të kostove për njësi), ndarjen e roleve dhe përgjegjësisive, ndarjen e risqeve dhe përfitimeve dhe

produkte/shërbime më cilësore dhe në sasi më të madhe¹³. Në lidhje me përcaktimin dhe/ose përditësimin e standardeve të shërbimeve të ofruara nga NJVV-të, këto të fundit janë përgjegjëse për administrimin dhe organizimin e ofrimit të shërbimeve publike, si edhe për ngritjen e një njësie të veçantë për vendosjen e standardeve të ofrimit të shërbimeve publike dhe monitorimit të performancës së tyre.

Me qëllim rritjen e ofrimit të shërbimeve tek qytetarët është e rëndësishme që shërbimi të ofrohet në mënyrë të njëjtë tek qytetarët, pavarësisht diferencave në madhësi të bashkive . Priorizimi i një liste të shërbimeve vendore për qytetarët është kyç në këtë proces. Në këtë fushë lipset përpjekje të shumta nga institucionet kombëtare dhe koordinim të vazhdueshëm, shoqëruar me burime të konsiderueshme. Deri më tani, një ndër fushat e pakta ku duket se janë përcaktuar standardet e shërbimeve është ujësjellësi, menaxhimi i mbetjeve dhe shërbimi për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri. Gjithashtu, ka edhe standarde të ofrimit të shërbimeve administrative (Zyra me Një Ndalesë), por janë të një karakteri të ndryshëm nga standardi i ofrimit të shërbimeve utilitare.

Një aspekt vizionar dhe sërish transversal i strategjisë është nisma e Qeverisë mbi digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre online. Nevoja për digjitalizim u bë imperative gjatë pandemisë, si një proces i cili diktoi ndryshime të rëndësishme në mënyrën e ofrimit të shërbimit si në nivel qendror ashtu edhe atë vendor. Ky proces synon të rrisë transparencën e shërbimeve publike, efikasitetin në terma kohorë, monetarë dhe cilësorë, eventualisht uljen e shpenzimeve të qytetarëve dhe bizneseve në marrjen e këtyre shërbimeve.

Përtej arritjeve të decentralizimit të lidhura përgjithësisht me procesin e harmonizimit ligjor midis ligjit organik të pushtetit vendor 139/2015 dhe ligjeve sektoriale, rritjes së të ardhurave vendore dhe menaxhimit të tyre efikas, ushtrimin të funksioneve të deleguara, procesi i decentralizimit rendit edhe disa mësimet të nxjerra gjatë zbatimit të SNDQV ekzistuese.

Në të gjitha konsideratat e mësipërme, angazhimi i qeverisë qendrore dhe bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërqeveritar mbetet kyç në realizimin e objektivave të SNDQV së re. Rivitalizimi i agjendës së decentralizimit me fokus zhvillimin ekonomik vendor, ku bashkitë bëhen faktor i rëndësishëm i zhvillimit, kërkon një bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm. Matja e performancës së NJVV-të gjithashtu përbën një aspekt të rëndësishëm të agjendës së decentralizimit, e cila u shërben vetë bashkive për të monitoruar institucionet e tyre apo për të bërë krahasimin me bashki të tjera, por edhe si një instrument i qeverisë qendrore për të kuptuar në mënyrë empirike progresin e agjendës së decentralizimit, sikurse edhe për ta lidhur këtë informacion me transfertat ndërqeveritare.

Duke iu referuar Komisionit të Posacëm të Reformës Administrative Territoriale (2022), Komisioni shprehet se

Arritjet e deritanishme dhe përvoja e fituar janë garanci për konsolidimin e mëtejshëm të 61 Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe garantimin e shërbimeve më të mira, me efektivitet dhe efikasitet më të lartë në të gjithë territorin e vendit.

¹³ <https://rm.coe.int/imc-intermunicipal-co-operation/1680746ec3>

...Komisioni Rekomandon:

Përmirësime të mundshme ligjore dhe mundësia e krijimit të mekanizmave dhe instrumenteve efektive për të garantuar një mbështetje më të madhe për NJVQV, sipas rekomandimeve të paraqitura në këtë raport, t'i propozohen Ministrisë së Brendshme si mundësi për përfshirje të tyre në Strategjinë për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Vendore 2023-2030 që është në proces hartimi, me qëllim konsolidimin e vetëqeverisjes vendore drejt një Vetëqeverisje Vendore të Hapur, që ofron shërbime cilësore për komunitetin.

Konkretisht:

- ✓ *Përfaqësimi i banorëve të NJA dhe zonave rurale në Këshillat Bashkiake mund të përmirësohet nëpërmjet rishikimit të mënyrës së zgjedhjes së Këshillave Bashkiake dhe strukturave komunitare.*
- ✓ *Forcimi i rolit të Këshillave Bashkiake në mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së ekzekutivit duhet sanksionuar në ligjin organik nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".*
- ✓ *Vijimi i decentralizimit dhe veçanërisht decentralizimit asimetrik duhet të sigurojë decentralizim funksionesh dhe kompetencash të reja për bashkitë që zotërojnë kapacitetet e nevojshme për administrimin e tyre.*
- ✓ *Shtimi i mbështetjes financiare për bashkitë nëpërmjet shtimit të taksave të ndara si dhe rritjes së përqindjes së taksave të ndara në favor të bashkive, veçanërisht rentës minerare dhe tatimit për të ardhurat personale të parashikuara në Ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" si dhe sigurimi i mbështetjes për krijimin e kadastrës fiskale.*
- ✓ *Rritja e kompetencave të administratorëve dhe e rolit të NjA si dhe e strukturave komunitare në ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet delegimit të më shumë kompetencave nga ana e kryetarëve dhe këshillave bashkiake.*
- ✓ *Rishikimi/Liberalizimi i nivelit të pagave të administratës së bashkive me qëllim sigurimin e një administrate të aftë dhe të mirëpaguar, veçanërisht në bashkitë me numër të vogël banorësh.*
- ✓ *Qartësimi i kompetencave të NJVQV me qëllim shmangien e mbivendosjeve me strukturat e dekoncentruara vendore.*
- ✓ *Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit sektorial në fushat e funksioneve të bashkive.*
- ✓ *Rishikimi i rolit dhe kompetencave të qarkut në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Rajonal si dhe me perspektivën eventuale të afrimit me BE-në*
- ✓ *Të tjera përmirësime që diktohen nga nevoja për një e-qeverisje vendore të hapur dhe transparente.*

2.3 Parimet/Metodologjia/Institucionet

Procesi i hartimit të SNDQV së re ka pasur një qasje të bazuar në evidenca për formulimin e politikave, shoqëruar nga konsultimi gjithëpërfshirës me aktorët kryesorë, sipas objektivave të mëposhtme:

- Inpute për politika të bazuara në evidenca nëpërmjet inventarizimit të zbatimit të funksioneve të qeverisjes vendore nga 61 bashkitë. Ky ushtrim ka evidentuar se çfarë ka funksionuar mirë dhe nevojën për të përmirësuar/ndërhurë në funksionet e qeverisjes vendore.
- Proces vendimmarrjeje konsultues dhe gjithëpërfshirës, ku përfshirja e palëve të interesuara është një dimension i rëndësishëm i procesit të planifikimit. Inputet nga NJVV, përfshirë edhe shoqatat respektive, kanë priorizuar drejtimet strategjike dhe masat specifike të agjendës së decentralizimit. Paralelisht, Ministrinë e Linjës dhe Agjencitë Shtetërore si aktorë kryesorë të zbatimit të SNDQV, japin perspektivën e tyre lidhur me objektivat strategjik dhe masat konkrete.
- Së treti, partnerët kanë një kontribut të rëndësishëm në mbështetje të kësaj strategjie aktuale. Ekziston një hapësirë e veçantë për kontributin e donatorëve në procesin e hartimit të strategjisë së re, qoftë nëpërmjet ekspertizës së tyre gjatë viteve të fundit ose ekspertëve në mbështetje të procesit të hartimit të SNDQV së re. Organizata e Shoqërisë Civile gjithashtu kanë pasur vëmendjen e duhur në të gjithë hallkat e procesit të hartimit.

SNDQV mbulon periudhën 2023-2030, për t'i dhënë mundësinë agjendës së decentralizimit për ndërhurje holistike dhe kuptim-plotë, në të njëjtën kohë edhe koordinim me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila është në përputhje me Agjendën 2030 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Ndërsa plani i veprimit do të jetë 3-vjeçar, duke përfshirë aktivitete dhe masa afatshkurtra dhe me produkte të afërta në kohë.

Në frymën e koordinimit ndërinstitucional, procesi i hartimit të draftit të kësaj strategjie dhe planit të saj shoqëruar të veprimit ka pasur një qasje gjithëpërfshirëse me të gjithë aktorët e sipërcituar të përfshirë në zbatimin dhe mbështetje të agjendës së decentralizimit. Inputet janë bazuar në evidenca ku përfshihen inventarizimi i zbatimit të funksioneve të pushtetit vendor nga 61 bashkitë, intervista të thelluara dhe konsultimi gjithëpërfshirës i aktorëve kryesorë me fokus bashkitë.

3. Strategjia e re për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

3.1 Vizioni dhe objektivat

Në kuadër të përmirësimit të mbarëvajtjes së këtij procesi, vlerësohet se momentalisht ka ende nevojë për të intensifikuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisë vendore dhe asaj qendrore, për të përputhur bazën ligjore (me akte ligjore dhe nënligjore) me funksionet, implementimin e funksioneve të reja dhe vazhdimin e punës për rritje të kapaciteteve të bashkive, shoqëruar me menaxhim më eficient të financave vendore dhe mirëqeverisje, me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm. E rëndësishme është qasja nga poshtë lart, duke marrë në konsideratë perspektivën e pushtetit vendor në zbatimin e SNDQV në tërësi dhe ushtrimin të funksioneve në veçanti.







Objektivat e përcaktuara në këtë dokument strategjik janë në harmoni të plotë me standardet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian mbi avancimin e mëtejshëm të agjendës së decentralizimit dhe konsolidimit të arritjeve ekzistuese, ashtu edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo strategji mbështetet në fushat të njëjta me strategjinë ekzistuese, por duke përmirësuar dhe avancuar masat e secilit objektiv sikurse ushtrimi i funksioneve në mënyrë autonome nga këndvështrimi financiar dhe demokracia vendore e perspektiva evropiane me qëllim arritjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm.

Fuqizim i njësive vendore për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm drejt standardeve evropiane.

Në këtë frymë, strategjia synon fuqizimin e njësive vendore për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm drejt standardeve evropiane. Thene ndryshe, konsolidimin e procesit të decentralizimit, krijimin e një mjedisi nxitës për zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm, forcimin e të ardhurave vendore të bashkive, digjitalizimin e shërbimeve dhe ofrimin e tyre online, sigurimin e i një qeverisjeje të hapur, rritje të transparencës, llogaridhënies dhe shtrirje më të madhe të e-qeverisjes në nivel vendor dhe avancimin e agjendës së BE-së në nivel vendor.

Objektivat strategjikë të këtij dokumenti janë si më poshtë:

- ✓ Objektivi strategjik 1: Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor.
- ✓ Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit të tyre për qytetarët.
- ✓ Objektivi strategjik 3: Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre.
- ✓ Objektivi strategjik 4: Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta.
- ✓ Objektivi strategjik 5: Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor.
- ✓ Objektivi strategjik 6: Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturave qendrore dhe të dekoncentruara në mbështetje të qeverisjes vendore.

 <p>Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor</p>	 <p>Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta.</p>
 <p>✓ Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit të tyre për qytetarët.</p>	 <p>Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritit evropian në nivel vendor.</p>
 <p>Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre.</p>	 <p>Konsolidimi i kapaciteteve të strukturave qendrore administrative në mbështetje të qeverisjes vendore</p>

3.2 Shtyllat kryesore të strategjisë


1 Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

Promovuar si një mjet për të rritur eficientë e sektorit publik dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik¹⁴, decentralizimi konsiderohet si një shtyllë thelbësore për reformat ekonomike dhe institucionale të një vendi. Në fakt, studimet të ndryshme lidhin qëllimin kryesor të decentralizimit me rritjen ekonomike vendore dhe eventualisht atë kombëtare.¹⁵ Patjetër, decentralizimi arrin të përçojë efektin e tij maksimal në një mjedis favorizues, i cili mundëson ushtrimin eficient të funksioneve, ndjekjen e politikave pro-bizneseve dhe shfrytëzimin e burimeve të ndryshme.

Kjo nënkupton jo vetëm krijimin e një mjedisi të favorshëm biznesi, por edhe shfrytëzimin e potencialeve në nivel vendor me qëllim krijimin e një mjedisi socio-ekonomik të qëndrueshëm vendor. Figura më poshtë paraqet 3 aktorët kryesor ndërveprues për krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm për një zhvillim ekonomik vendor. Së pari, është vetëqeverisja vendore si një aktor i veçantë, por edhe komponentja e bashkëpunimit të saj me qeverisjen qendrore. Bashkëpunim i dy qeverisjeve është i një rëndësie jetike për krijimin dhe më pas konsolidimin e pozitave të NJVV-ve në rrugën e zhvillimit vendor. Bizneset dhe shoqëria civile/qytetarët janë aktorët ndërveprues në këtë mjedis, sikurse edhe përfitues të lehtësirave në nivel vendor për të realizuar aktivitetin e tyre.

¹⁴ Bird (1993).

¹⁵ Oates (1993, 1995).



Kjo strategji synon të nxjerrë në pah funksionin e zhvillimit ekonomik vendor të NJVV-ve duke u fokusuar tek rivitalizimi i instrumenteve ndërvendore të bashkëpunimit si *incentivimi i marrëveshjeve ndërbashkiake* për të rritur ekonominë e shkallës, përfshirë këtu edhe qartësimin apo harmonizimin e kuadrit ligjor me qëllim ushtrimin e plotë të kompetencave ekzistuese lidhur me zhvillimin ekonomik vendor, *shfrytëzimin eficient të burimeve/aseteve/kapitalit natyror në nivel vendor, përdorimin e kompetencave ekzistuese në funksion të zhvillimit ekonomik, lehtësimin e procesit të transferimit të pronave publike të NJVV-ve dhe vlerësimin e prerogativave vendore, rajonale dhe qendrore në fushën e zhvillimit vendor.*

Sot është domosdoshmëri që adaptimi i strategjisë së decentralizimit të përfshijë të gjitha nivelet e qeverisjes:

- Vendore, ku aktorët kryesorë janë vetë bashkitë të cilat duhet të jenë ekonomikisht të qëndrueshme
- Rajonale, ku rolin kryesor në këtë drejtim e luan Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Me VKM nr. 438, datë 18.7.2018, të gjitha funksionet e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe Agjencive të Zhvillimit Rajonal (AZHR) i kaluan Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH). Sipas pikës 2 të VKM: “Të drejtat, detyrimet, arkivat dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar, që disponohet nga Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal (AKZHR), Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Rajonal (AZHER) dhe agjencitë e zhvillimit rajonal (AZHR) transferohen te Fondi Shqiptar i Zhvillimit”. Në vijim, Ligji 102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe kohezionin” e përcakton FSHZH-në, si Autoritet Menaxhues dhe Sekretariat të Komitetit Kombëtar dhe të Bordeve të Monitorimit. Nga ana tjetër FSHZH, qëndron si urë lidhëse dhe koordinuese mes nivelit qendror dhe atij rajonal/vendor përmes hartimit të 4 strategjive rajonale dhe zbatimit të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare.
- Kombëtare, ku Qeveria Shqiptare përmes prioriteteve të saj, orienton masat, nevojat dhe modelet e zhvillimit që duhet të adoptojnë bashkitë në vend. Ndaj, strategjia e decentralizimit duhet të përçojë vizionin dhe misionin e Qeverisë Shqiptare për vitet në vazhdim, sipas edhe orientimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2021-2030).

- Evropiane, Shqipëria në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian duhet të harmonizojë ligjet dhe politikat në përputhje me kërkesat e integritit evropian. Sot, Politika Evropiane e Kohezionit ka për qëllim të korrektojë pabarazitë mes vendeve dhe rajoneve. Prioritetet kryesore të qyteteve evropiane lidhen me ekonominë e gjelbër dhe qarkulluese (ulja e nivelit të karbonit deri në arritjen e një ekonomie me zero karbon), orientimi nga “*smart cities*” (qytete të zgjuara), mbrojtja e trashëgimisë kulturore, bërja e qyteteve sociale dhe më afër qytetarëve me qëllim krijimin e një zhvillimi të integruar urban, rural dhe bregdetar përmes nxitjes së iniciativave lokale si *incentivat territoriale, investimet e integruara territoriale dhe zhvillimi vendor i drejtuar nga komuniteti* -CLLD përmes zbatimit të programeve LEADER). Duke marrë në konsideratë që rreth 70% e legjislacionit të BE-së zbatohet në nivel vendor dhe rajonal, agjenda e BE-së në nivel vendor bëhet edhe më e rëndësishme dhe e prekshme për bashkitë, jo vetëm për mundësitë që ofron, por edhe për detyrimet/përafrimet që kërkohen.
- Ndërkombëtare, përmes zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Agjenda 2030, të cilat duhet të konsiderohen si një mundësi e artë jo vetëm për të fuqizuar procesin e decentralizimit, por edhe për të inkurajuar forma të reja bashkëpunimi mes bashkive. Këto objektiva ndërkombëtare që janë adoptuar në nivel kombëtar nga Qeveria Shqiptare duhet të përshtaten dhe adoptohen nga të gjitha bashkitë. Ndaj, përqaftimi i këtyre objektivave do t'i bëjë bashkitë më të ndjeshme në drejtim të mbrojtjes së mjedisit si dhe kalimit drejt një ekonomie të gjelbër apo qarkulluese. Bashkitë duhet të konsiderohen njëkohësisht si instrument për zgjidhjen dhe adresimin e sfidave që lidhen me aspektet ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Më qartësisht, objektivat specifik të kësaj shtylle janë si më poshtë vijon:

- ✓ **Objektivi specifik 1.1:** Përmirësimi i planifikimit ekonomik strategjik dhe përdorimi i skemave dhe incentivave vendore për zhvillim ekonomik ndaj bizneseve dhe organizatave joqeveritare, duke përfshirë rishikim të kuadrit ligjor;
- ✓ **Objektivi specifik 1.2:** Menaxhimi i integruar i aseteve dhe burimeve natyrore vendore;
- ✓ **Objektivi specifik 1.3:** Vlerësim dhe përcaktimi i prerogativave vendore, rajonale dhe qendrorë në zhvillimin vendor e rajonal
- ✓ **Objektivi specifik 1.4:** Forcimi i zhvillimit bujqësor dhe agro-përpunues
- ✓ **Objektivi specifik 1.5:** Mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i planifikimit ekonomik strategjik dhe përdorimi i skemave dhe incentivave vendore për zhvillim ekonomik ndaj bizneseve dhe organizatave joqeveritare

1.1.1 *Përfundimi i gjithë procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore, si edhe hartimi e planeve strategjike zhvillimore.*

Kjo masë synon përfundimin e procesit të hartimit të planeve të përgjithshme vendore me qëllimin krijimin e një plani strategjik të sinkronizuar ndërmjet bashkive si edhe nxitjen e nevojshme të sektorëve dhe aktorëve për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Planet strategjike janë aktet që orientojnë këtë zhvillim, duke bërë bashkë të gjithë aktorët dhe faktorët për zhvillimin.

Së fundmi, planet strategjike të zhvillimit do të orientohen drejt parimeve të ekonomisë së gjelbër, përfshirë ndërgjegjësimin e strukturave vendore dhe komuniteteve për mjedisin si aset i rëndësishëm; përfshirjen e komunitetit dhe biznesve; zhvillimin urban me impakt sa më të ulët në mjedis; përdorimin eficient të burimeve; eficientia energjetike dhe inkurajimin e shërbimeve publike miqësore për mjedisin.

1.1.2 Rivitalizimi dhe prezantimi i incentivave/skemave të reja për marrëveshjet ndërbashkiake/ndërvendore dhe atyre me sektorin privat dhe organizatat joqeveritare.

Kjo masë nënkupton rivitalizimin dhe/ose përditësimin e skemave dhe hapësirave ligjore ekzistuese, duke i bërë shteruese përsa i përket mekanizmave të përdorur, si edhe prezantimin e incentivave apo skemave të reja për marrëveshjet ndërmjet bashkive me njëra tjetrën, ndërmjet bashkive dhe qarqeve, qarqeve me njëri tjetrin, bashkive/qarqeve me biznesin dhe/ose organizatat joqeveritare. Në këtë kontekst, kërkohet një analizë e detajuar e incentivave ekzistuese, arsyet e mospërdorimit të tyre, mundësitë e rivitalizimit dhe së fundi skemat/incentivat e reja që mund të prezantohen në qeverisjen vendore.

Gjithashtu, institucionet do të nxisin dhe krijojnë modele pozitive për bashkëpunimin ndërvendor të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet delegimit tek Këshillat e Qarqeve e zbatimit të një pjese të funksioneve të veta të bashkive. Një pjesë e funksioneve të bashkive (ose pjesë të një funksioni) thjesht nuk mund të zbatohen pa bashkëpunuar me bashki të tjera ose pa deleguar një pjesë tek Këshilli i Qarkut. Në funksione të tjera, përfitimi nga ekonomia e shkallës e krijuar nga një formë apo një tjetër bashkëpunimi, është evident. Strategjia ka propozuar studime për mënyrën më të mirë të ofrimit të këtij shërbimi (p.sh nëpërmjet bashkëpunimit ndërvendor apo delegimit te Këshillat e Qarqeve) dhe do të sugjerojë mënyrat për ti bërë këto forma bashkëpunimi praktike dhe të zbatueshme.

1.1.3 Skema vendore për mbështetjen e bizneseve me grante apo shërbime të tjera.

Njësite e vetëqeverisjes vendore megjithëse me avantazhe të ndryshme për sa i përket burimeve natyrore, mund të inkurajohen ti shfrytëzojnë avantazhet që kanë lidhur me kapitalin natyror në territorin e tyre, etj. Burimi i financimit për investimet fillestare mundësohet sipas kornizës ligjore “Për Pushtetin Vendor” nga të ardhurat e veta apo nëpërmjet huamarrjes për projekte ekonomike dhe financiare fitim prurëse. Në këtë kontekst NJVV duhet të aktivizojnë shoqëritë tregëtare si e drejtë ligjore në ligjin organik të saj. Ky organizim do të gjenerojë të ardhura në formën e fitimit të cilat do të shkojnë si të ardhura për NJQV. Përfitimet nga kjo mënyrë funksionimi do të jenë të kufizuara vetëm për shërbime që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të zonës duke shmangur konfliktin me operatorët ekonomikë me pronësi private. Shërbime të tilla mund të jenë organizimi i panairove të produkteve të zonës në zona publike dhe të aksesueshme nga palët e interesuara.

Objektivi specifik 1.2: Menaxhimi i integruar i asetëve dhe burimeve natyrore vendore;

1.2.1 Vënia në shfrytëzim e asetëve vendore , si instrument i rritjes ekonomike vendore dhe burim për gjenerimin e të ardhurave

Në kuadër të përforsimit të rolit vendor në zhvillimin ekonomik, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të nxiten të identifikojnë, vlerësojnë, transferojnë dhe vënë në përdorim asetet vendore në funksion të përmbushjes së funksioneve të tyre dhe rritjes së mirëqenies dhe nivelit të ofrimit të shërbimeve në territoret përkatëse. Për këtë, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të nxiten dhe mbështeten për procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pronave/asetëve; për ndërtimin e një vizioni të përbashkët dhe inventari të asetëve; përcaktimi i e objektivave të zhvillimit dhe treguesve për matjen e rentabilitetit; përcaktimin i burimeve financiare dhe i politikave fiskale që mbështesin zbatimin e strategjisë. Kapacitetet e njësitë të vetëqeverisjes vendore do të zhvillohen për të vënë në funksionim forma të shfrytëzimit të pasurive vendore për qëllime ekonomike apo sociale; nëpërmjet qiradhënies, bashkë-investimit nëpërmjet formave të partneritetit public privat; koncesioneve apo tjetërsimit. Mes të tjerash, kjo do të përfshijë edhe një bashkëpunim të zgjeruar ndërinstitucional në lehtësimin e procesit të transferimit të pronave publike tek NJVV për qëllim zhvillimin publik dhe vlerësimin e mundësisë së lehtësimit të formave të pagesës për regjistrimin e titujve të pronësisë në favor të NJVV-ve; një kuadër ligjor të unifikuar dhe të kombinuar me përgjegjësi të qarta të gjithë aktorëve që marrin pjesë në procesin e menaxhimit të asetëve si edhe asistencë e vazhdueshme për ngritjen e njësitë koordinuese dhe udhëheqëse të procesit të menaxhimit të aktiveve, përmirësimin e kapaciteteve profesionale të stafit si dhe të audituesve të brendshëm të NJVV.

1.2.2 Menaxhimi i kapitalit natyror

Bashkitë do të forcojnë rolin e tyre në menaxhimin e kapitalit natyror, duke ruajtur, zhvilluar dhe rivitalizuar asetet në pronësi apo përdorim, përfshirë në veçanti asete natyrore si pyjet dhe kullotat apo fondi i tokës bujqësore. Bashkitë do të koordinojnë punën e tyre në drejtim të planeve të përbashkëta të mbarështimit të pyjeve me qëllim mbrojtjen e territorit, ruajtjen e hapësirës së përbashkët ndërbashkiake dhe uljen e kostove të bashkive si dhe do të parashikojnë instrumente e plane për shfrytëzimin e kullotave dhe tokës bujqësore në funksion të zhvillimit ekonomik vendor.

Së fundmi, kapitali natyror në përdorim të bashkive nuk kufizohet vetëm në pyjet, kullotat dhe tokën bujqësore - matja e kapitalit natyror është një fushë në zhvillim e sipër. Në këto kushte, bashkitë do të mbështeten për të ndërmarrë procesin e vlerësimit dhe monitorimit të asetëve natyrore që ato zotërojnë.; përfshirë a) vlerësimi i kapitalit natyror nga çdo bashki në vend; b) zyrtarizimin e tij dhe c) planin e menaxhimit.

1.2.3 Sistemi informativ për menaxhimin e asetëve vendore

Një sistem informativ për të menaxhuar asetet vendore do të rrisë eficiencën e njohjes dhe vlerësimit e eventualisht rritjen e të ardhurave të gjeneruara direkt apo indirekt nga asetet vendore. Rishikimi i kuadri rregullator për menaxhimin e asetëve duhet t'i paraprijë ose të koordinohet me zhvillimin e një sistemi bashkëkohor për menaxhimin e aktiveve, i cili duhet të jetë kryesisht i nivelit menaxherial, komplementar dhe të sinkronizohet me informacione të prodhuara nga sisteme të tjera informative ekzistuese financiare të planifikimit dhe zbatimit, si SIFQ (sistemi informatik financiar i qeverisë) dhe

SIMF-vendor. Në fushën e menaxhimit të aseteve të NJVV-ve, synohet të vlerësohet mundësia e ndërtimit të një sistemi të menaxhimit të aseteve vendore, i cili mund të përdoret nga të gjitha NJQVV, i integruar me sisteme të tjera që janë në administrim të institucioneve qendrore.

Objektivi specifik 1.3: Vlerësim dhe përcaktimi i prerogativave vendore, rajonale dhe qendrore në zhvillimin vendor e rajonal

Si pjesë e vlerësimit të rolit të njësisë të vetëqeverisjes vendore, do të synohet përmirësimi dhe forcimi i marrëdhënies së bashkëpunimit midis nivelit të parë dhe të dytë të pushtetit vendor; marrëdhënia midis decentralizimit dhe politikës rajonale e politikës së zhvillimit rajonal e vendor; identifikimi i fushave me potencial për ekonomi shkalle dhe vlerësimi i gatishmërisë për decentralizim të mëtejshëm sipas funksioneve specifike dhe tipareve të veçanta bashkiake.

Roli i qarqeve do të ridimensionohet për të maksimizuar potencialin e tyre në funksion të përmirësimit të shërbimeve vendore; përfshirë angazhimin e tyre në formulimin e programeve rajonale të zhvillimit dhe lehtësimin e tyre; programeve të bashkëpunimit ndërvendor e ndërkufitar; përthithja e fondeve të kohezionit rajonal dhe social dhe bashkërendimi i për politikat afatgjata zhvillimore rajonale në zbatim të politikave kombëtare, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, shoqëror e kulturor rajonal; në përputhje me rolin e qarkut sipas ligjit të zhvillimit rajonal.

Objektivi specifik 1.4: Forcimi i zhvillimit bujqësor dhe agro-përpunues

1.4.1 Rritja e eficiencës së shërbimeve vendore në bujqësi dhe zhvillim rural,

Kjo përfshin studim për zgjerimin e funksioneve dhe kompetencave të NJQV-ve në fushën e zhvillimit rural dhe bujqësisë. Kompetencat e NJQV-ve në fushën e zhvillimit rural dhe bujqësisë sipas ligjit 13/2015 janë administrimi i tokave bujqësore në të gjitha kategoritë, fondi publik pyjor e kullosor, infrastruktura e ujitjes dhe kullimit në pronësi të saj si dhe mbrojtja e natyrës dhe e biodiversitetit.

Zhvillimi Ekonomik Vendor është suksesi i krijimit të një mjedisi miqësor për bizneset dhe kapaciteteve të qeverisjes vendore për planifikimin në efikasitet të plotë të të gjitha burimeve njerëzore e natyrore në funksion të rritjes pozitive të treguesve ekonomikë strategjikë dhe zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik vendor. Bashkitë do të duhet të shoqërojnë përgjegjësitë e tyre për zhvillimin ekonomik vendor me rritjen e aftësive, kapaciteteve dhe financimeve dhe ofrimin e mbështetjes për sipërmarrjen vendore dhe produktet ekonomike lokale.

Në këtë kuadër, do të nxitet roli i bashkisë për mbështetjen nëpërmjet financimit me grante dhe lehtësimi për aplikimin në skemat e AZHBR për të orientuar çdo investim në përputhje me Planet e Përgjithshme Vendore që në fazën fillestare. Në këtë mënyrë aplikimet do të kenë mundësi më të lartë për të qenë të suksesshme dhe impakti i investimeve të tilla do të përmirësojë gjithashtu edhe ekonominë e rajonit. Po ashtu, në kuadrin e masës LEADER të programeve IPARD do të mbështetet krijimi i grupeve vendore të veprimit (GVV), një nismë e suksesshme në modelin evropian. Në përputhje me ligjin nr. 36/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit" bashkitë duhet të luajnë rolin e katalizatorit për nxitjen e bashkëpunimit vendor në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjithashtu, roli i bashkive në administrimin e rrjetit të ujitjes dhe kullimit do të mbështetet më tej edhe nëpërmjet financimeve nga qeveria qendrore dhe fuqizimit të bashkërendimit të politikave për zhvillimin e rrjeteve parësore nën administrimin e MBZHR-së dhe atyre dytësore dhe tretësore nën kompetencën bashkiake.

Objektivi specifik 1.5: Mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

a) Mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit në nivelin vendor. Fuqizimi i strukturave të turizmit vendor është një veprim i cili duhet të rrjedhë nga një vlerësim i kujdesshëm i kushteve dhe përputhshmërisë me Planin e Përgjithshëm Vendor. Në këto kushte nevojitet organizimi i strukturës kordinuese përtej territorit të NJQV.

b) Qartësimi i funksioneve e përgjegjësive në fushën e Trashëgimisë Kulturore. Rishikimi i kuadrit ligjor, si edhe ngritja e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor janë masa të parashikuara në kuadër të fuqizimit të strukturave të turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

Bashkitë do të rrisin vëmendjen e tyre për të krijuar mjedise urbane miqësore; zhvillim hapësinor të qëndrueshëm, akses të përshtatshëm për objektet e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe planifikimin e shërbimeve publike dinjitoze. Për këtë, aplikimi i instrumenteve inovative si zonat e përmirësimit të biznesit dhe turizmit do të zgjerohet në një numër më të madh bashkish për të rritur potencialin e kontributit të përbashkët nga sektori privat dhe ai publik në funksion të turizmit, zhvillimit ekonomik përfshirë ekonominë blu dhe punësimin; do të intesifikohet bashkëpunimi i bashkive me operatorët turistikë për të mudnësuar planifikim të përshtatshëm të burimeve; do të orientohet zhvillimi i destinacioneve kulturore dhe instrumeneteve të informimit për vizitorët, përfshirë nëpërmjet sistemeve digjitale dhe pikave të informacionit.

2

Ofrimi cilësor i shërbimeve vendore sipas standardeve kombëtare, shoqëruar me rritje të performancës së bashkive dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Shtylla e dytë e strategjisë ka si qëllim që *Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ofrojnë shërbime efçente për qytetarët duke konsoliduar rolin e tyre të pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve të veta bazuar në standarde të mirëpërcaktuara dhe duke rritur ndjeshëm performancën e tyre. Ky qëllim synohet të arrihet nëpërmjet objektivave specifik:*

- ✓ **Objektiv specifik 2.1:** Konsolidim i rolit të NJVV në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mangësitë dhe mbivendosjet ligjore, institucionale dhe mekanizmat e financimit në marrëdhëniet ndërqeveritare.
- ✓ **Objektivi specifik 2.2:** Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, shoqëruar me rritje të kapaciteteve administrative vendore me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike;
- ✓ **Objektiv specifik 2.3:** Përmirësim i efçencës së shërbimeve, në përputhje me standardet kombëtare e vendore.
- ✓ **Objektiv specifik 2.4:** Përmirësimi i performancës së qeverisjes vendore bazuar mbi një sistem nxitës të performancës, që shërben si një mekanizëm dialogu dhe llogaridhënieje ndaj komuniteteve vendore.

Objektivi specifik 2.1 Konsolidim i rolit të NJVV në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mangësitë dhe mbivendosjet ligjore, institucionale dhe mekanizmat e financimit në marrëdhëniet ndërqeveritare.

2.1.1 Harmonizim i ligjeve dhe akteve nënligjore që saktësojnë marrëdhëniet ndërqeveritare për forcimin e rolit të NJVV në zbatimin e funksioneve.

Nga analiza e funksioneve të NJVQV, është e evidente se një pjesë e funksioneve, pavarësisht se ligjërisht janë funksione të veta të NJVV, në realitet kanë mbivendosje domethënëse kompetencash gjatë zbatimit të tyre. Disa prej mbivendosjeve janë të identifikuar përgjatë viteve dhe janë akoma të pazgjidhura, disa të tjera janë bërë evidente gjatë kësaj periudhe të zbatimit në praktikë të funksioneve të transferuara. Synimi i strategjisë është të propozojë masa konkrete sipas funksioneve, për zgjidhjen e këtyre problematikave që rezultojnë të jenë pengesa serioze për zbatimin e funksioneve të veta.

2.1.2 Nxitja e përgatitjes së udhëzuesve, rregulloreve, modeleve, planeve të përmirësimit të shërbimit që i shërbejnë organizimit të brendshëm të NJVV për një ofrim sa më efçent shërbimi.

Në disa funksione edhe kur nuk ka problematikë të evidentuar të marrëdhënieve ndërqeveritare, janë të nevojshme akte të vetë bashkive për të rregulluar administrimin dhe menaxhimin e funksionit. Kudo ku është e mundur, strategjia do të propozojë masa që nxisin përdorimin e modeleve, rregulloreve të shërbimit, planeve të përmirësimit të shërbimit, analiza të proceseve dhe çdo masë tjetër të identifikuar si mjet për përmirësimin e ofrimit të shërbimit, për t'u hartuar dhe, aty ku ekzistojnë, për

t'u shpërndarë dhe promovuar si mënyra për të forcuar menaxhimin e shërbimeve brenda vetë NJVV-ve.

Objektiv specifik 2.2: Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, shoqëruar me rritje të kapaciteteve administrative vendore me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.

Strategjia parashikon ofrimin e mbështetjes për njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet hartimit të modeleve tip të strukturave dhe organizimit të shërbimeve, të cialt do të kenë karakter orientues dhe jo detyrues për bashkië. Gjithashtu, këto modele tip, me mbështetjen e AMVV-së, mund të shtrihen edhe për organizimin e funksioneve apo njërive të veçanta të bashkive.

Në këtë kontekst propozohet edhe kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim si dhe krijimi i një strukture të dedikuar trajnimit, krahas apo brenda ASPA-s e cila mund të mbulojë njohuritë bazë që i nevojiten një nëpunësi civil në nivelin vendor. Nëpërmjet kësaj strukture të dedikuar, profesionistë të fushës, prakticienë apo edhe ish- drejtues të lartë të pushtetit vendor mund të ofrojnë trajnime/leksione apo edhe 'on the job training/trajnim në vendin e punës për pushtetin vendor. Kjo mund të jetë një strukturë 'lëvizëse' në qark, e cila shkon pranë të trajnuarit dhe jo e kundërta. Struktura do të mbulonte trajnimin e dedikuar të punonjësve vendorë, përfshirë të zgjedhurit. Një zgjidhje e tillë do t'i jepte përgjigje edhe përgjegjësisë për edukimin e vazhduar të të zgjedhurve vendorë që nuk janë pjesë e sistemit të administratës (Ndërkohë, roli i shoqatave në këtë strukturë do të ishte thithja e ekspertëve më të mirë vendorë dhe ofrimi i 'know-how' të tyre në trajnimet që do të ofrohen. Ndër të tjera, strategjia e re propozon promovimin e kurrikulave online të cilat mund të ndiqen nga punonjësit në varësi të ngarkesës së tyre në punë dhe në një orar të përshtatshëm për ta, dedikuar trajnimit.

Objektiv specifik 2.3: Përmirësim i efikasitetit të shërbimeve, në përputhje me standardet kombëtare e vendore.

Kjo strategji jep në mënyrë të përmbledhur aktivitetet dhe masat e parashikuara për secilin nga funksionet që ushtrohen nga qeverisja vendore. Kjo përfshin jo vetëm aspekte që lidhen me (mirë)zbatimin e tyre, por edhe aspekte ligjore për ta bërë ushtrimin e funksionit sa më eficient.

2.3.2 Vendosija e standardeve kombëtare

Strategjia propozon një hartëzim kombëtar të të gjitha standardeve minimale ekzistuese, identifikimin e boshllëqeve dhe propozimin e standardeve ku ato mungojnë si dhe vendosjen në kuadrin ligjor të referencave të qarta për përdorimin e standardeve në kontekstin e politikave vendore. Ky aktivitet bazohet në gjetjet e ushtrimit të Ministrisë së Brendshme mbi hartëzimin e standardeve.

Strategjia gjithashtu propozon edhe studimin më në thellësi të një grupi funksionesh të rëndësishme, ku t'u jepet përgjigje të gjitha çështjeve të diskutueshme, të identifikohet hendeku financiar, të

pilotohen zgjidhje dhe të përfitohen mësimet me vlerë për t'u shtrirë në vijim në fusha të tjera.¹⁶ Brenda tre viteve të para të strategjisë objektivi parashikon dakordësimin dhe formësimin ligjor të të paktën 30 (tridhjetë) standardeve minimale kombëtare të lidhura me funksionet e bashkive.

Në kuadër të këtij objektivi parashikohet edhe kostimi i standardeve minimale kombëtare dhe atyre vendore, si një aktivitet i cili bazohet në një metodologji të qartë të përcaktimit të standardeve minimale, duke bërë të mundur edhe krahasimin midis bashkive. Kudo ku të jetë e mundur, studimet e propozuara do të marrin parasysh mundësinë e parashikimeve financiare për arritjen e këtyre standardeve. Në funksionet që do të studiohen më në detaj, përveç standardeve minimale kombëtare mund të përfshihen edhe metodologji ndihmëse për bashkitë për të vendosur standarde vendore për ato bashki të cilat kanë ambicie për të vendosur standarde më të larta se minimali, ose për shërbime ku nuk është e mundur të ketë një standard minimal kombëtar.

Objektiv specifik 2.4: Zbatimi efikas i funksioneve të NJVV-ve

Mbrojtja sociale

Në kushtet e mungesës së një tradite të konsoliduar veçanërisht në nivel vendor, funksionet e lidhura me ofrimin e shërbimeve/funksioneve vendore, kanë përjetuar disa zhvillime të rëndësishme gjatë kuadrit kohor të strategjisë së decentralizimit e të qeverisjes vendore. Ndër çështjet kryesore që kanë shënuar progres mund të përmendim:

- ndërgjegjësimin në rritje të zyrtarëve përgjegjës dhe drejtuesve vendorë ndikuar edhe nga krizat e tërmetit dhe pandemisë;
- hartimin e planeve lokale sociale në thuajse të gjitha bashkitë e vendit çka krijon mundësinë për një qasje më të integruar dhe afatgjatë në ofrimin e shërbimeve;
- krijimin e traditës së bashkëpunimit dhe partneritetit në ofrimin e shërbimeve me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë;
- përpjekjet drejt krijimit e konsolidimit (pavarësisht sfidave) të trupave menaxheriale të ofrimit të shërbimeve sociale;
- ngritja e fondit social konkurrues në nivel qendror dhe aftësimi i bashkive e nxitja e partneriteteve vendore për përgatitjen e projekteve për ngritjen e shërbimeve sociale;
- hartimi i një kuadri politik sektorial në përgjithësi të harmonizuar me ligjin organik të qeverisjes vendore.

Një sërë çështjesh të pazgjidhura përbëjnë sfida të rëndësishme për kontekstin kohor të kësaj strategjie:

¹⁶ Në këto funksione do të studiohet me në detaj ekzistenca e standardeve, propozimi për vendosjen e tyre në politikën kombëtare dhe/ose udhëzimi për standardet vendore të ofrimit të këtyre shërbimeve si dhe skenaret e kostimit në varesi të nivelit të vete standardeve.

- tipologjia dhe shpërndarja e pabarabartë e shërbimeve sociale në të gjitha bashkitë e vendit¹⁷si dhe cilësia e shërbimeve të ofruara ;
- standardet e shërbimeve duhen plotësuar aty ku mungojnë e rishikuar ato ekzistueset, duke përcaktuar gjithashtu dhe kostot për njësi;
- roli i Këshillave të Qarqeve në bashkërendimin dhe ofrimin e këtyre shërbimeve në nivel rajonal mbetet i paqartë në praktikë;
- Njësitë për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave dhe (NJVRN) të parashikuara në ligj nuk janë ngritur ende në të gjitha NJVQV;
- operacionalizimi i prokurimit dhe kontraktimit të shërbimeve mbetet për t'u detajuar;
- modeli i financimit të shërbimeve nuk është i qartësuar me linja financimi që nganjëherë anashkalojnë NJVQV;
- fondi social vendor nuk është ngritur ende në pjesën më të madhe të NJQVdhe sistemi vuan mungesën e qëndrueshmërisë dhe profesionalizmit të stafit.

Roli i Bashkive mbetet thelbësor në planifikimin, buxhetimin e ofrimin e shërbimeve sociale. Strategjia parashikon masa që synojnë të përmirësojnë e qartësojnë marrëdhëniet mes niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe të nxisë Njësitë e Qeverisjes Vendore për të rritur performancën në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Mbrojtja Sociale, programet e ndihmës ekonomike dhe personave me aftësi të kufizuar

Njësitë e Vetëqeverisjes vendore nuk kanë autoritet të drejtpërdrejtë në menaxhimin e programeve të mbrojtjes sociale të bazuara në para (NE dhe aftësi të kufizuar). Bashkitë veprojnë në emër të qeverisë qendrore për të pranuar aplikimet dhe paguar përfitimet, megjithatë nuk kanë mbikëqyrje të programit të NE, apo liri në vendimmarrje mbi përshtatshmërinë ose madhësinë e përfitimeve. NJVV kanë sfidë kapacitetet dhe burimet e kufizuara në nivelin vendor për të mirëadministruar skemën e NE, ndërsa administratorët socialë në disa njësi janë të mbingarkuar.

Nga ana tjetër mungesa e informacionit mbi përfitimet dhe sfidat e aksesueshmërisë janë disa nga shqetësimet që lidhen me këtë program. Bashkitë kanë për detyrë të ofrojnë informacion të plotë për aplikimin dhe kriteret e pranimit, duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi.

Plani kombëtar i veprimit për PAK (PKVPAK) thekson se qeverisja vendore ka rolin dhe përgjegjësinë kryesore në realizimin e aksesueshmërisë fizike. NJQV-të kanë detyrim të raportojnë çdo 6 muaj pranë MSHMS-së mbi realizimin e aksesueshmërisë, por për këtë detyrim nuk raportohet.

Bashkitë duhet të zhvillojnë përgjegjësitë e tyre duke filluar që nga vlerësimi i nevojave, planifikimi i buxheteve dhe kryerja e investimeve për të siguruar mjedise e transport të aksesueshëm, rritjen e kapaciteteve për dhënie të shërbimeve bazë për personat me aftësi të kufizuara. Strategjia e Mbrojtjes Sociale ka propozuar disa masa për të forcuar lidhjet ndërmjet shërbimeve sociale, programeve mbështetëse në para, si ndihma ekonomike dhe përfitimi i aftësisë së kufizuar, me reintegrimin social dhe punësimin. Zbatimi i këtyre masave thekson nevojën për koordinim më të mirë ndërsektorial.

¹⁷ Rreth 60% e bashkive ofrojnë deri në tre tipologji shërbimesh, dmth më pak se 40% të tipologjive të përcaktuara në ligj. Vetëm rreth 20% e bashkive ofron mbi 6 tipologji shërbimesh, ndërsa vetëm 3% e bashkive ose 2 bashki, përkatësisht Tirana dhe Elbasani, ofrojnë të gjitha tipologjitë e shërbimeve. ("Hartëzimi i shërbimeve sociale në Shqipëri, SHSSH, 2021)

Strehimi social

Strategjia e Strehimit Social 2016-2025¹⁸ është dokumenti kryesor i politikave që trajton çështjen e strehimit social dhe asistencës për të pastrehët në Shqipëri. Bashkitë janë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave për strehim, hartimin e projekteve afatmesme dhe afatgjata të strehimit, ofrimin e tokës për ndërtim dhe paraqitjen e kërkesave në MFE për financim, si edhe për një gamë të gjerë funksionesh administrative (p.sh., menaxhimi i stokut të njësive të strehimit social, mbajtja e inventarëve, raportimi periodik, etj.).

Kapacitetet e nivelit qendror dhe veçanërisht atij vendor për të adresuar nevojat e mëdha të strehimit social mbeten shumë të kufizuara. Vlerësimi afatmesëm i strategjisë¹⁹ evidentoi një sërë kufizimesh . 70% e bashkive konfirmuan kufizimet në burime njerëzore për zbatimin e 6 programeve të parashikuara në ligj, ndërsa 50% theksuan mungesën e aftësive dhe kualifikimeve për zbatimin e plotë të funksioneve lidhur me strehimin social (PNUD 2020). Forcimi i kapaciteteve vendore të mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave për strehimin social është një nga objektivat e strategjisë së strehimit. Konkretisht, dokumenti politik i strehimit social nënvizon një sërë sfidash që lidhen me detyrat e pushtetit vendor si njohja e mirë e nevojave dhe ofertës për strehim, ngritja dhe përdorimi i sistemit të mbledhjes sistematike të të dhënave dhe analizimi i tyre në çdo bashki, duke evidentuar situatën specifike e nevojat e grupeve të marginalizuara, si dhe kapacitetet monitoruese e raportuese të zyrtarëve vendorë.

Në nivel bashkie, jo të gjitha njësitet kanë një strukturë apo staf të dedikuar që merret me strehimin social, ndërkohë që ka kapacitete të kufizuara për të planifikuar, ofruar dhe monitoruar shërbimet e strehimit social dhe jo të gjitha bashkitë kanë hartuar një program strehimi²⁰. Me mbështetjen e donatorëve (PNUD) po hartohen strategjitë vendore për strehimin social. Angazhimi për monitorimin dhe zbatimin e tyre është i rëndësishëm.

Menaxhimi i arsimit parashkollor

Lidhur me arsimin parashkollor, si një funksion të një rëndësie të lartë, kjo strategji synon të adresojë sfidat dhe paqartësitë në zbatimin e këtij funksioni, sfida të karakterit ligjor, financiar, administrativ dhe shoqëror. Strategjia propozon masa konkrete për qartësimin e mëtejshëm të rolit të bashkive në ushtrimin e funksionit, përmirësimin e kapaciteteve vendore, përmirësimin e transfertave financiare dhe forcimin e pjesëmarrjes qytetare (nëpërmjet bordeve të prindërve) me synim final përmirësimin e cilësisë së shërbimit ofruar nga bashkitë.

Më konkretisht lidhur me sfidat që synon të adresojë janë si më poshtë vijon:

- Ligjore dhe rregullative duke qenë se një pjesë e rëndësishme e arsimit parashkollor përfshin në realitet përgjegjësi të ndara mes nivelit qendror dhe vendor të qeverisjes ose përgjegjësi direkte

¹⁸ VKM Nr. 405, datë 08.06.2022 "Për aprovimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025", i aksesueshëm përmes linkut: <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2016/06/01/405>

¹⁹ PNUD (2020) Vlerësimi Afatmesëm i zbatimit të Strategjisë Sociale të Strehimit 2016-2025. Hartuar me mbështetjen e PNUD dhe angazhimin e MetroPOLIS shpk e Co-PLAN. <https://www.undp.org/albania/publications/mid-term-evaluation-social-housing-strategy-2020>

²⁰ Jorgoni, Elira (2019). ESPN Thematic Report on National strategies to fight homelessness and housing exclusion – Albania, European Social Policy Network (ESPN), Brussels: European Commission.

të qeverisë qendrore dhe strukturave të dekoncentuara të saj në nivel vendor e rajonal, pa përfshirjen e bashkive.

- Financiare; Llogaritja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale kryhet e bazuar në një formulë që mbështetet vetëm tek numri i nxënësve dhe mësuesve. Strategjia e re synon të adresojë çështjen e transfertës së pakushtëzuar lidhur me formulën.
- Administrative, ku nënkupton rritje të kapaciteteve të administratës për të forcuar teknikat e menaxhimit.
- Shoqërore; Pavarësisht ekzistencës së këshillave të prindërve dhe bordeve të kopshteve, pjesëmarrja e prindërve dhe aktorëve të tjerë mbetet e kufizuar.

2.1.3 Investimet kapitale

Strategjia propozon një pjesëmarrje më aktive dhe thelbësore të NJVV-ve në aplikimin për fonde për të gjitha skemat e transfertave të investimeve në përgjithësi, si dhe një rol në rritje në vendimmarrjen për alokimin e fondeve sipas prioriteteve reale vendore. Strategjia propozon gjithashtu që gjithnjë e më tepër të synohet në menaxhimin e drejtpërdrejtë të tyre nga vetë Njësitë Vendore.

Spektori i Ujësjellës Kanalizimeve

Spektori i Ujësjellës Kanalizimeve (UK) është i organizuar si një sistem me dy nivele, ku Qeveria Qendrore (QQ) është përgjegjëse për strategjitë sektoriale dhe zhvillimin e mbështetjen e politikave kombëtare, dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NjVQV) për ofrimin e shërbimit të UK. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NjVQV) kanë funksion të vetin dhe janë përgjegjëse për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm si dhe mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura,²¹ dhe i rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e këtyre funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi, si dhe i ofrojnë ato duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale dhe sipas standardeve dhe norma specifike të përgjithshme të vendosura nga qeveria qendrore me qëllim ruajtjen e interesave kombëtarë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore në të gjithë territorin.²²

Ndërkohë përgjegjësitë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në fushën e UK hartimi, zbatimi dhe ndjekja e politikave të zhvillimit të infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimet; drejtimi, menaxhimi, mbikëqyrja dhe vendosja e standardeve teknike të infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve; si dhe monitorimi i realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e punimeve në aspektin financiar e teknik,²³ kanë mundësuar hartimin e dhe zbatimin e politikave kombëtare dhe alokimin direkt apo përmes institucioneve financiare dhe të

²¹ Pika 1 dhe 2 e neni 23 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"

²² Neni 22 i Ligjit Nr.139/2015.

²³ VKM Nr. 111 date 02.03.2022 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë".

asistencës teknike ndërkombëtare, të investimeve dhe zhvillimin e kapaciteteve insitucionale dhe njerëzore për rritjen cilësisë së shërbimit dhe performancën e UK sh.a.

AKUM, si organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura dhe mbetjeve, shërben si koordinues, asistues dhe këshillues i NjVQV-ve për të hartimin te projekteve dhe për nismat për investime në fushën e UK²⁴, dhe mbështet zbatimin e reformës së riorganizimit dhe ecurinë e performancës së UK sh.a të reja.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është një institucion publik i pavarur që rregullon sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të siguruar mbrojtjen e interesit publik dhe për të krijuar një kuadër transparent rregullator. ERRU licencon të gjithë personat fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbimet UK, siguron që ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime cilësore dhe efikase me një çmim të arsyeshëm, si dhe rregullojnë tarifën e shërbimeve në një mënyrë që siguron qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve si dhe përballueshmërinë për konsumatorët.

Ndërkohë, shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe trajtimit të ujërave të ndotura (UK), pavarësisht nga rritja në vazhdimësi e cilësisë dhe mbulimit me shërbimi të popullatës, janë shoqëruar me informalitet të lartë të përdorimit të ujit nga konsumatorët, efektshmëri të ulët operacionale, si dhe varësi të lartë nga buxheti i shtetit për mbulimin e kostove të operimit, mirëmbajtjes dhe kryesisht për investime të reja, dhe janë larg kapaciteteve për të qënë efikas dhe ofruar performancë në cilësinë e shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane.

Në vitin 2016, sipas VKM nr. 63/2016²⁵, për riorganizimin e operatorëve UK, bashkive iu është dashur të riorganizojnë shërbimet e UK në vijim të Reformës Administrative Territoriale dhe kërkesës në rritje për cilësinë dhe mbulimin e territorit me shërbimet e UK. Ky riorganizim krijoi 58 SHUK me një aksioner të vetëm, pra bashkinë përkatëse (në thuajse të gjitha rastet).

Ndërkohë, reforma më e fundit e sektorit UK, që ka të bëjë me riorganizimin dhe agregimin e shoqërive aksionere të UK (UK sh.a), u rregullua me VKM nr. 302, datë 11.5.2022²⁶, i cili parashikon se në total do të krijohen 15 Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP), nga 58 shoqëri UK sh.a që janë aktualisht. Sipas kësaj VKM, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e përfaqësuar nga AKUM, do të zotërojë jo më pak se 51% të aksioneve të SKP të krijuara mbas lidhjes së marrëveshjeve për bashkimin e shoqërive mes MIE dhe bashkive, ndërsa bashkitë do të zotërojnë jo më shumë se 49% të aksioneve. VKM sanksionon se bashkitë nuk kanë të drejtë të tërhiqen si pjesë e SKP për një periudhë 10 vjeçare. Mbas kësaj periudhe ato mund të tërhiqen, por nuk kanë të drejtë të marrin subvencione nga qeveria qendrore për të mbuluar kostot e operative dhe të mirëmbajtjes (O&M) të U.K sh.a.

Menaxhimi i mbetjeve

Reforma territoriale ishte një hap i madh dhe pozitiv në lidhje me eficientësinë e shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Mbulimi i popullsisë me shërbimin kyç, një nga treguesit më të rëndësishëm

²⁴ VKM Nr. 431, datë 11.7.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e AKUM", pika 3 dhe 13/g.

²⁵ VKM Nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

²⁶ VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit UK"

për këtë kuadër kohor është rritur nga rreth 60 % në rreth 87 % aktualisht. Kënaqësia e njerëzve me shërbimin ndërkohë është rreth 45 % , afërsisht në të njëjtin nivel me shërbimet e tjera. Ky tregues është domethënës për problemet e vështirësitë e mëdha që ka menaxhimi i mbetjeve, si një ndër sfidat më komplekse për Shqipërinë e më specifiku për qeverisjen vendore.

Shërbimi i mbledhjes, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve drejt impianteve të trajtimit është një përgjegjësi e qartë e NJVV. Ndërsa këto shërbime janë përmirësuar, sfida mbetet financimi i tyre me tarifën që mbulojnë vetëm një pjesë të kostos së shërbimeve. Mungesa e përvojës dhe e burimeve njerëzore të dedikuara, e nganjëherë edhe e vullnetit të lidhshëm politik vendor, e bën të komplikuar arritjen e standardeve të mira të shërbimit, si kur ofrohet nga operatorë publikë ashtu edhe nga ata privatë.

Impiantet e trajtimit të mbetjeve thuajse po përfundojnë ose janë parashikuar të investohen në të gjithë rajonet/zonat e mbetjeve duke arritur që pjesa më e madhe e vendit të trajtojë mbetjet në impiante të licencuar e modernë. Kostot e rritura operacionale dhe të mirëmbajtjes së këtyre impianteve në disa raste tashmë kanë vënë, (ose shpejt do të vënë) një presion të madh financiar mbi shpatullat e bashkive. Në të ardhmen ato duhet të financojnë një kosto të konsiderueshme për trajtimin e mbetjeve. Nga ana tjetër, nuk kemi akoma një model të konsoliduar të mirëfunksionimit të menaxhimit të landfillëve dhe rolit të NJVV-ve në administrimin e tyre. Venddepozitimet e përdorura më përpara kanë nevojë për një përpjekje serioze financiare, investimi në projektet e mbylljes të së cilave, mund të jetë përtej mundësive të bashkive. Një projekt i madh investimi dhe asistence teknike i Qeverisë Shqiptare me mbështetjen e kFw dhe aktorëve të tjerë, synon që përveç pjesës së përmirësimit të infrastrukturës, të finalizojë edhe një model qeverisjeje për secilën nga 10 zonat e përcaktuara të mbetjeve në të gjithë vendin.

Riciklimi, përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit dhe kompostimi mbeten objektiva të rëndësishëm në kuadër të integritimit në BE, por janë ende në fazat e parë të rregullimit në një fushë të dominuar nga sfida më parësore dhe “të rënda”.

Ky kuadër kohor strategjik, mesa duket do të dominohet nga një vullnet i fortë politik në nivel qendror, për përmirësimin e situatës dhe një sërë investimesh të rëndësishme publike për kompletimin e ciklit të trajtimit në të gjithë territorin. Objektivat kryesore në këtë periudhë janë:

- Pozicionimi i NJVV në administrimin e trajtimit të mbetjeve në mënyrë që ky të mbetet një funksion qartazi vendor;
- Menaxhimi i mbetjeve në zona specifike si ato turistike;
- Qartësimi i mekanizmave financiare për mbështetjen e bashkive nga qeveria shqiptare për investimet, por edhe mbulimin tranzitor të kostove të larta të trajtimit të mbetjeve;
- Fuqizimi i financave të veta vendore për mbulimin e kostove të shërbimit nëpërmjet tarifave;
- Kontrolli më i rreptë e profesional i shërbimit;
- Ngritja e burimeve njerëzore në nivel teknik e menaxherial;
- Komunikimi transparent me qytetarët për të përmirësuar jo vetëm cilësinë e shërbimit dhe financimin e tij, por edhe forcimin e demokracisë vendore dhe rritjen e besimit në institucionet vendore.

Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri

Drejtimit strategjike për funksionin e garantimit të shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor kanë qenë të lidhura me decentralizimin e funksionit të shërbimit të mbrojtjes kundra zjarrit në nivel vendor, ndryshimet ligjore për ristrukturimin e PMZNSH-s, transferimin tek bashkitë të organikave dhe strukturave të PMZNSH-së, si dhe transferimin e burimeve financiare dhe ngritjen e kapaciteteve.

Gjendja aktuale pas përfundimit të periudhës së ndërhyrjes, rezulton me arritje të lidhura me decentralizimin e funksionit të shërbimit zjarrfikës nga niveli rajonal (në varësi të prefekturave) në atë plotësisht pranë bashkive, si dhe me rishikimin e legjisllacionit dhe plotësimin me akte nënligjore të nevojshme për pozicionimin e bashkive në ushtrimin e funksionit.

Në kuadër të funksionit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, kjo strategji adreson çështjet që kanë të bëjnë kryesisht me konsolidimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor, pamjaftueshmërinë e burimeve financiare, pajisjet e amortizuara, nevojën për ngritje të kapaciteteve tekniko profesionale, hartimin e një modeli për kostimin e shërbimit, si dhe ngritjen e bazave të të dhënave për rrezikun nga zjarret dhe hartimin e dokumenteve të vlerësimit të rrezikut nga zjarret si dhe planeve të menaxhimit të zjarreve.

Rendi dhe Siguria Publike

Drejtimit strategjike për funksionin e garantimit të rendit dhe sigurisë, në nivel vendor kanë qenë të lidhura me harmonizimin e legjisllacionit, për të eliminuar mbivendosjen e funksioneve ndërmjet policisë së shtetit dhe policisë bashkiake; optimizimit të numrit të stafit në bazë të kriterëve të përcaktuara si dhe forcimin e kapaciteteve të NJQV përmes trajnimit të ofruar për inspektorët e policisë vendore për fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me kompetencat e tyre. Gjendja aktuale pas përfundimit të periudhës së ndërhyrjes, rezulton me arritje të lidhura me nxjerrjen për konsultim të projekt ligjit “Për Policinë Bashkiake” si dhe ngritjen e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP).

Në strategjinë e re adresohen çështje që kanë lidhje me plotësimin e bazës ligjore të funksionit të rendit dhe sigurisë publike, më konkretisht miratimi i ligjit të ri për Policinë Bashkiake, hartimin e kuadrit nënligjor, hartimin e një standardi minimal dhe modeli kostimi për ofrimin e shërbimit të rendit dhe sigurisë nga forcat e policisë bashkiake, ngritjen e kapaciteteve, shtimin e financimit për të mbështetur blerjen e pajisjeve dhe mjeteve moderne të nevojshme për ofrimin e shërbimit si dhe nxjerrjen e kuadrit rregullator për organizimin dhe funksionim e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike.

Mbrojtja Civile

Drejtimit strategjike për funksionin e mbrojtjes civile në nivel vendor kanë qenë të lidhura me përmirësimin e kompetencave dhe rolit të autoriteteve vendore në fushën e mbrojtjes civile me qëllim rritjen e efikasitetit të strukturave në mbrojtje të jetës dhe pronës së qytetarëve. Situatat e jashtëzakonshme të tërmetit dhe të pandemisë kanë nxjerrë në pah rëndësinë e funksionalitetit të strukturave të emergjencave civile, duke ngritur ndërgjegjësimin në të gjitha nivelet vendim-marrëse përfshirë nivelin vendor.

Gjendja aktuale pas përfundimit të periudhës së ndërhyrjes, rezulton me arritje të lidhura me miratimin e ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe paketës së akteve nënligjore të cilat kanë qartësuar kompetencat dhe rolin e autoriteteve vendore në fushën e mbrojtjes civile duke i dhënë rol të qartë strukturave vendore në parandalimi, përballimi, vlerësimin e dëmeve dhe rindërtimi. Rishikimi i ligjit të Prefektit, ka mundësuar eliminimin e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet strukturave të dekoncentruar në nivel vendor dhe strukturave të qeverisjes vendore. Gjithashtu në vitin 2022 ka pasur rritje të transfertës së kushtëzuar për “Emergjencat Civile”.

Sfidat kryesore me të cilat përballen ende strukturat vendore në kuadër të funksionit të mbrojtjes civile kanë të bëjnë kryesisht me konsolidimin e mëtejshëm dhe zbatimin sa më të mirë të kadrin ligjor e nënligjor, ngritjen në nivel vendor të bazave të të dhënave për mbrojtjen civile; hartimin e vlerësimit vendor të rrishtit, hartimin e strategjive vendore për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive, si dhe të planeve vendore të emergjencave civile; forcimin e strukturave vendore me rritje të numrit të punonjësve; ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale, si dhe mbështetje me investime për zhvillimin, modernizimin e aseteve si dhe rehabilitimin e infrastrukturës së emergjencës civile.

Transporti publik vendor

NJVV-të janë përgjegjëse për transportin publik vendor dhe e ofrojnë shërbimin duke u bazuar në kërkesat dhe standardet e ligjeve specifike, si dhe në objektivat e dokumenteve strategjike kombëtare, rajonale dhe vendore.²⁷ Ato miratojnë tarifat e transportit publik, të parkimit, miratojnë linjat dhe licencojnë operatorët e shërbimit.

Bashkitë sigurojnë transport publik duke angazhuar shoqëri private ose shoqëritë e tyre, japin edhe licencë për shoqëritë e transportit publik dhe taksitë dhe vendosin tarifat përkatëse. NJVV-të vendosin gjithashtu për parkingjet dhe tarifat përkatëse.

Nga 61 bashki, 22 prej tyre nuk e ofrojnë fare shërbimin e transportit publik, ndërsa vetëm 4 e kanë atë publik urban. Transporti publik është pothuajse i pafinancuar nga bashkitë e vendit²⁸. Bashkitë më së shumti merren me dhënieve e lejeve/ose miratimet paraprake për transport urban dhe interurban. Shpenzimet për transportin publik zënë rreth 1 % të totalit të buxhetit të bashkive²⁹. Kjo ka dëmtuar interesat e qytetarëve, bizneseve dhe zhvillimin në përgjithësi të ekonomisë lokale, pasi transporti publik mes të tjerash rrit aksesin e qytetarëve në tregjet e punës.

Sfida kryesore gjatë kësaj periudhe të strategjisë është të përmirësohet ndjeshëm shërbimi i transportit publik vendor duke rritur financimin dhe standardet e shërbimit. Nga ana tjetër është e domosdoshme që bashkitë të kenë një qasje më gjithëpërfshirëse e të integruar ndaj mobilitetit në raport me atë tradicionale të transportit me automjete.

Strategjia propozon një sërë masash për nivele të ndryshme të qeverisjes që do të nxisin bashkitë jo vetëm për rritjen e performancës por edhe synimin e ecurisë drejt një sistemi mobiliteti të qëndrueshëm në përputhje me praktika të mira evropiane.

²⁷ Neni 23/6 i ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

²⁸ Vetëm disa bashki të mëdha financojnë në mënyrë aktive shërbimin.

²⁹ “Raport Studimor Performanca e Shërbimeve Publike të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 2021”, Gusht 2022.

Mirëmbajtja e Rrugëve Vendore

Funksioni i mirëmbajtjes dhe zhvillimit të rrugëve vendore është qartësisht i vetë bashkive. Rrugët vendore përgjithësisht ndahen në rrugë urbane dhe rrugë rurale. Ndërsa rrugët urbane kanë qenë prej shumë kohësh nën administrimin e bashkive, rrugët rurale³⁰ janë një ndër funksionet e decentralizuara tek bashkitë pas vitit 2015. Bashkive iu transferua rrjeti rural nga inventarët e Këshillave të Qarqeve dhe ish-komunave. Nga viti 2016 deri në vitin 2021, pavarësisht luhatjeve, bashkitë raportojnë se është rritur përqindja e rrjetit rrugor të mirëmbajtur³¹. Bashkitë gjithashtu raportojnë se shpenzojnë rreth 13 % të buxhetit të tyre për këtë funksion, duke e bërë një ndër funksionet për të cilat bashkitë shpenzojnë më shumë. Financimi për mirëmbajtjen e rrjetit bëhet me anë të transfertës së kushtëzuar për këtë qëllim dhe burimeve të tjera financiare të NJVV-ve. Financimi për investimet mund të bëhet nga vetë bashkitë ose nga Qeveria Qendrore/donatorët nëpërmjet FSHZH.

Megjithëse një pjesë e standardeve teknike të investimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve janë të qartësuara në legjislacionin sektorial, rrugët rurale me trafik të ulët kanë specifikat e veta dhe duhen trajtuar si të tilla. Është e nevojshme që të ketë një inventar të rishikuar e të saktë të rrjetit rrugor, një klasifikim të rishikuar funksional të rrugëve, një mekanizëm alokimi të buxhetit në nivel kombëtar dhe bashkiak dhe qartësi mes llojeve të ndërhyrjeve nëse janë mirëmbajtje rutinë apo periodike dhe investimeve. Strategjia propozon një sërë masash për të forcuar ofrimin e këtij shërbimi kyç për kohezonin urban-rural në territorin e ri të zgjeruar të bashkive pas reformës territoriale.

2.5 Përmirësimi i performancës së qeverisjes vendore bazuar mbi një sistem nxitës të performancës, që shërben si një mekanizëm dialogu dhe llogaridhënieje ndaj komuniteteve vendore

Ndërtimi i një sistemi bazuar mbi performancë mbështetur në tregues të matshëm e të verifikueshëm.

Ky sistem duhet të jetë i ngritur mbi disa parime bazë që të bëhet funksional:

- Të jetë i thjeshtë, funksional dhe i bazuar në të dhëna objektivist të verifikueshme dhe relativisht të lehta për tu mbledhur³².
- Të mbështetet mbi përvojat aktuale ekzistuese të matjes dhe raportimit të performancës, duke maksimizuar njohurinë ekzistuese në sistem³³.
- Të mbështetet në një sistem vendor burimesh njerëzore me përgjegjësi të plotë³⁴ dhe të trajnuara për këtë proces.
- Të mbështetet nga një skemë financimi grantesh bazuar në performancë që shërben si shtysë pozitive për përmirësimin e performancës vendore. Skema e financimit duhet të ketë një masë

³⁰ Termit rrugë vendore, rurale, lokale e rajonale janë përdorur në mënyrë të ndërkëmbyeshme ndër vite. Ligji organik përcakton termin rrugë vendore.

³¹ "Raport Studimor i performancës së shërbimeve publike të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore 2021", Gusht 2022, Shoqata për Autonominë Vendore, mbështetur nga projekti Bashki të Forta.

³² Kjo është një nga masat e paplotësuara të strategjisë ekzistuese, cdo përpjekje për një sistem të komplikuar do të rrezikonte testimin e tij edhe në këtë kuadër kohor strategjik. Një sistem kompleks në të njëjtën kohë do të rrezikonte që madhësia dhe kompleksiteti i kësaj nisme të tejkalonte përfitimet e saj.

³³ Një numër projektesh të mbështetur nga partnerët kanë mbështetur aktorët e e sistemit në nivel vendor e qendror duke mbuluar aspekte të qënësishme të funksionimit të një sistemi performancë.

³⁴ Në këtë kontekst ndërtimi dhe trajnimi i njësive të performancës është i domosdoshëm në cdo bashki,

të caktuar që të ketë efekt dhe të ngjallë interesin e NJVV³⁵ për pjesëmarrje dhe reagim proaktiv.

Strategjia në zbatim të këtij objekti ka renditur një sërë masash të propozuara për ta bërë operacionale sistemin e performancës në vitet e para të periudhës kohore që mbulon strategjia.

Çelja e një granti bazuar mbi performancë mbi parimin e mbështetjes me grant të pakushtëzuar të NJVV-ve që performojnë mirë.

Granti bazuar në performancë është parashikuar si një instrument i rëndësishëm dhe thelbësor në strategjinë e decentralizimit Qëllimi i tij final është të ndikojë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga ana e bashkive. Objekti më konkret është që duke u nisur nga përvoja aktuale e pa konsoliduar në matjen e performancës, të ndërtohet një skemë granti që të jetë operacionale (të disbursojë) në periudhën afatmesme fonde të qeverisë qendrore dhe donatorëve. Gjatë rishikimit të strategjisë mund të vlerësohet efektiviteti i grantit dhe shtrirja e tij në fusha të tjera nëse realisht skema rezulton e suksesshme.

3 Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre.

E-qeverisja është menduar si një mënyrë për të rritur efektivitetin administrativ, sikurse edhe sjell përfitime si promovimi i vlerave demokratike dhe përfshirja e qytetarëve (Bannister dhe Connolly, 2014; Bernhard, 2015). Digjitalizimi i lejon qeveritë të veprojnë me transparencë dhe efikasitet më të madh. Në epokën digjitale, përdorimi i teknologjisë së informacionit ka potencial për të përmirësuar cilësinë e shërbimit publik, si në nivel qendror, ashtu edhe atë vendor.

Në dekadën e fundit, Shqipëria ka investuar gjithnjë e më shumë në krijimin e një strukture dhe kulture solide të qeverisjes elektronike, me implikime të drejtpërdrejta në transformimin e kanaleve të ofrimit të shërbimeve publike. Qeveritë kanë treguar një angazhim të palëkundur për të avancuar drejt shërbimeve online. Si rezultat, e-Qeverisja është sot një realitet i prekshëm në Shqipëri. Portali i qeverisë online (e-Albania) tani ofron deri në 1,225 shërbime publike online, ose rreth 95% e tyre nga vetëm 14 shërbime të ofruara me fillimin e ndryshimit digjital rreth një dekadë më parë.

Pas shërbimeve elektronike të ofruara qëndron një arkitekturë komplekse, Platforma Qeveritare e Ndërveprueshmërisë, e cila është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale. Deri më sot janë 55 regjistra elektronikë, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin në kohë reale, duke bërë që 66% e formularëve për aplikime të ndryshme të plotësohen automatikisht në e-Albania, duke shkurtuar kohën e dhënies së dokumentacionit dhe duke thjeshtuar më tej procedurat.

Një ndryshim i rëndësishëm i prezantuar në 1 janar 2020 ishte se të gjitha dokumentet shtetërore që kërkoheshin më parë për t'u mbledhur nga qytetarët, nuk u nevojiten më atyre. Në vend të kësaj, administrata është përgjegjëse për gjenerimin e tyre brenda vendit. Gjithashtu, është krijuar një

³⁵ Studimet ndërkombëtare dhe praktikant në rajon tregojnë se granti duhet të ketë një madhësi të caktuar (zakonisht matur si raport me investimet kapitale të NJVQV që të jetë atraktiv).

sistem i veçantë i brendshëm i IT-së për të ndërvepruar me të gjitha institucionet (Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE)) për të shkëmbyer elektronikisht të gjitha dokumentet shoqëruese që lidhen me kërkesën për shërbim të një qytetari apo biznesi me nënshkrim elektronik. Nëpërmjet këtij sistemi, punonjësit kërkojnë dokumentet e nevojshme nga institucionet që i gjenerojnë ato dhe mund të gjurmojnë procesin e kërkesës për shërbim gjatë gjithë ciklit.

Me rritjen e numrit dhe vëllimit të shërbimeve online, qeveria njoftoi në fund të prillit 2022 mbylljen e zyrave të ofrimit të shërbimeve të qeverisë qendrore nga 1 maji 2022 dhe kalimin në modalitetin ekskluziv të ofrimit të shërbimeve online, me vetëm disa përjashtime. Ndërsa ky ndryshim po ndodh aktualisht nëpërmjet e-Albania si porta e centralizuar e qeverisë për ofrimin e shërbimeve publike të qeverisë qendrore për qytetarët dhe bizneset me akses 24/7, situata është e ndryshme për shërbimet publike të ofruara nga pushteti vendor. Sot bashkitë operojnë me sisteme të ndryshme gjysmë të automatizuara për ofrimin e shërbimeve, të paktën katër lloje zyrash me një ndalesë (me modelin STAR2/3 që mbizotëron) që aksesohen fizikisht nga qytetarët dhe bizneset. Këto sisteme nuk kanë zëvendësuar plotësisht ofrimin e shërbimit manual konvencional dhe në përgjithësi janë pak ose aspak të integruar ose të lidhur me sistemet qeveritare dhe janë të cenueshëm për sa i përket sigurisë së infrastrukturës së fortë/të butë. Ekzistojnë vetëm disa praktika të mira në këtë nivel, siç është rasti i lejeve elektronike për ndërtime, të cilat janë funksionale që nga viti 2015 në të 61 bashkitë.

Bashkitë nuk kanë progres të madh për sa i përket evolucionit digjital në krahasim me institucionet qendrore; megjithatë, avancimi i nivelit qendror mund të jetë një levë dhe mundësi thelbësore për të filluar integrimin e nivelit të dytë të qeverisjes në reformat e përgjithshme të transformimit digjital. Zvogëlimi i diferencave digjitale midis dy niveleve të qeverisjes kërkon një qasje graduale që bazohet në kapacitetet ekzistuese njerëzore dhe infrastrukturore dhe përparon në mënyrë graduale dhe të qëndrueshme në një fazë më të lartë të sistemeve, infrastrukturës dhe kapaciteteve për të shfrytëzuar inovacionet e mundshme.

Projekti në vazhdim STAR3 është një mjet ideal për mbështetjen e këtyre proceseve të ndryshimit pasi projekti tashmë mbështet një rrjet prej 52 Z1NJ me një ndalesë bashkiake, me një njohuri të thellë të kontekstit përkatës në këtë fushë. Si masë fillestare për këtë parashikohet *vlerësimi i praktikave, nevojave dhe gatishmërisë digjitale të bashkive dhe publikut.*

4

Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta

4.1 Objektivi specifik 1: Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe me standarde;

Rritja kapaciteteve të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve, si edhe e autonomisë fiskale vendore është objektivi 4 i SNDQV. Synimi kryesor është rritja e nivelit të autonomisë financiare të pushtetit vendor, veçanërisht duke rritur nivelet e financimit të funksioneve vendore. Rritja e autonomisë fiskale është parashikuar të arrihet nëpërmjet (i) rritjes së të ardhurave vendore nga tatimi mbi pasurinë e paluajtshme, (ii) rritjes së pjesës së taksave të ndara, dhe (iii) gjenerimit të të


ardhurave nga aktiviteti ekonomik i njësive te veteqeverisjes vendore nëpërmjet përdorimit më eficient te asetëve vendore.

Ky objektivi mund të synojë në një periudhë afatmesme që të arrihet niveli i të të ardhurave totale vendore në përqindje të PBB-së i barabartë me mesataren e të ardhurave të vendeve të rajonit (rreth 5.2%). Ndërsa në afatgjatë, mund të synohet të arrihet mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian prej 10.6% e PBB-së. Realizimi i plotë i objektivave të strategjisë si ndërthurje e decentralizimit fiskal dhe funksional do të bëhet e shtrirë në kohë dhe duke përcaktuar qartë se çfarë mund dhe duhet të arrihet nga rritja e të ardhurave të veta dhe çfarë do të plotësohet nga rritja e transfertës për qeverisjen vendore. Si pjesë e kësaj analize, duhet të ndërmerret një studim i kostove për zbatimin e funksioneve të vetëqeverisjes vendore, për të bërë të mundur që burimet e disponueshme të përkohjë me përgjegjësitë e transferuara në pushtetin vendor.

Rritja e të ardhurave vendore nga tatimi mbi pasurinë e paluajtshme

Tradicionalisht, theksi i decentralizimit fiskal dhe rritjes së të ardhurave është tatimi mbi pronën, për shkak të potencialit për financat e pushtetit vendor duke mbetur relativisht një taksim më i drejtë në krahasim me taksimet e tjera.

Figura 6: Të ardhura nga taksat e pasurisë në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Të ardhurat nga taksat mbi pronën për Shqipërinë zënë rreth 20% të të ardhurave të veta të vetëqeverisjes vendore dhe mbeten të ulëta krahasuar me vendet e rajonit. Për Shqipërinë të ardhurat janë rreth 0.3% e PBB, mesataren prej 0.7% për rajonin, nga rreth 0.4% të PBB për Bosnja Hercegovina dhe Kosovën, në 0.5% të PBB për Maqedoninë, në 1.0% të PBB për Serbinë dhe në 1.3% të PBB-së për Malin e Zi. Mali i Zi dhe Serbia janë më afër me mesataren e BE-së prej 1.6% të PBB-së. Krahasuar me vendet anëtare të OECD-së, kjo mesatare luhet nga 0.9% të PBB, nga 2-3% në vendet e Evropës kontinentale dhe 1 – 7% të PBB-së në vendet e industrializuara.

Modeli evropian sugjeron që në një perspektivë afatgjatë ka shumë hapësirë për rritjen e te ardhurave nga taksim i pronës. Reforma mund të përcaktojë një objektiv afatmesëm dhe një objektiv afatgjatë, si:

- **Objektiv afatmesëm** duhet të jetë: rritja e te ardhurave për të gjithë kategoritë e tatimit mbi pronën, si për tatimin e ndërtesave, truallit apo tokës bujqësore. Si objektiv afatshkurtër mund të jetë rritja e te ardhurave nga taksimi mbi pronën në 0.7% të PBB-së, nga 0.3% e PBB-së që është aktualisht, nëpërmjet zgjerimit të bazës së tatueshme falë administrimit më të mirë fiskal. Eksperiencat ndërkombëtare rekomandojnë si objektiv realist rritjen nga 0,5-1% të PBB për periudhën 5-10 vite të reformës në vendet në zhvillim.³⁶
- **Objektivi afatgjatë** duhet të synojë rishikimin e taksimit mbi pronën dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së nivelit aktual të tatimit, i cili mbetet i ulët krahasuar edhe me vendet e rajonit, si edhe i ulët në krahasim me koston administrative të mbledhjes së tij (shih më poshtë). Ndërsa aktualisht po punohet për taksimin e ndërtesave mbi bazën e vlerës së tregut, në planet e reformës është dhe taksimi i truallit mbi bazën e vlerës së tregut (kjo përkon me periudhën që mbulon kjo strategji) Po ashtu, rritja e sipërfaqes së ndërtuar aktualisht, e reflektuar në rritjen e te ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, pritet të rezultojë në një rritje të bazës së taksueshme për tatimin e pronës në vitet në vijim.
- Si pjesë e **rritjes së eficientës** së mbledhjes së taksës së pasurisë, përveç normës së mbledhjes, duhet konsideruar edhe ulja e kostove administrative të mbledhjes së kësaj takse. Referencat tregojnë se norma vjetore e koston administrative kundrejt totalit të te ardhurave luhetet nga 2% deri 5 % në vendet e zhvilluara dhe rreth 6% në vendet në zhvillim. Normat mbi 10 % (siç është rasti i Shqipërisë), tregojnë për problematika serioze në administrim.
- **Zhvillimi i një sistemi monitorimi të mbledhjes së te ardhurave** mbështetur në indikatorë sasiorë performance, mund të japë te dhëna të besueshme për eficientën në mbledhje. Performancat pozitive, mund të lidhen me një skemë incentivuese granti (i dedikuar ose si kriter në formulën e transfertës së pakushtëzuar, apo skemave të tjera të granteve). Një mundësi për nxitjen e përmirësimit të administrimit të taksës së pasurisë është përlllogaritja e ekualizimit fiskal për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar si funksion i kapacitetit fiskal nga taksat e pasurisë (në vend të te ardhurave të mbledhura).

Taksat e ndara

Taksat e ndara në Shqipëri aplikohen për të ardhurat mbi qarkullimin e makinave, nga kalimi i të drejtës së pronësisë, nga renta e shfrytëzimit të burimeve minerale, dhe në një përqindje të caktuar nga të ardhurat mbi taksimin e te ardhurave personale. Të ardhurat nga ndarja e taksave mbeten të ulta krahasuar me vendet e rajonit. Të ardhurat nga takse e ndara në Shqipëri vlerësohen në 0.1 përqind e PBB, në 0,5 përqind në Maqedoni, në 1.0 përqind e PBB në Bosnje, në 1,3 përqind në Malin e Zi, dhe në 2,3 përqind e PBB në Serbi. Shqipëria transferon rreth 10 milion Euro, Maqedonia në rreth

³⁶ Norregaard, J. (2013). "Taxing Immovable Property Revenue Potential and Implementation Challenges," *IMF Working Papers* 2013/129, International Monetary Fund.

42 milion Euro, Mali i Zi ne rreth 63 milion Euro, Bosnja ne rreth 99 milion Euro dhe Serbia ne rreth 1.087 milion euro³⁷.

Po te analizojmë struktura e transfertes se qeverise qendrore (pa transfertat e kushtëzuara), ndërmjet ndarjes së taksave dhe granteve, ne vendet e rajonit transfertat ne formen e ndarjes së taksave eshte shume me e larte se transfertat e granteve nga qeveria qendrore krahasuar me Shqiperine. Ne rastin e Serbise kjo ze mbi 76 perqind te transfertes, ne Malin e Zi ze 65 perqind, ne Bosnje ze 42 perqind dhe ne Maqedoni ze rreth 19 perqind. Ndersa ne Shqiperi transfertat e taksave te ndara eshte vetem 6.8 perqind e transfertes totale.

Qeveria qendrore mund t'u ofrojë njësitë të vetëqeverisjes vendore nje mundesi per te rritur nivelin e te ardhurave nga ndarja e taksave sipas eksperiencave te vendeve te tjera si te rajonit dhe europiane. Objektivi duhet te synoje te arrihet nje mesatare e vendeve te rajonit ne rreth 0.9 perqind e PBB, pa përfshire Serbinë qe ka një nivel te larte te takse sharing. Për këtë duhet qe:

- Te konsolidohet metodologjia e ndarjes se taksës nga tatimi i te ardhurave personale.
- Mund te shqyrtohet mundësia qe te përfshihet ne taksa te ndara përveç te ardhurave nga tatimi i te ardhurave personale, por edhe te ardhurat nga tatim fitimi dhe tatimi mbi vlerën e shtuar sipas eksperiencave e vendeve te tjera.
- Të rritet përqindja qe shkon për pushtetin vendor nga renta e shfrytëzimit të burimeve natyrore, në veçanti mineralet duke konsideruar faktin se njësitë e vete qeverisjes vendore ofrojnë shërbime dhe investime te nevojshme për shfrytëzimin e këtyre burimeve .

Te ardhura nga aktiviteti ekonomik i njësitë te veteqeverisjes vendore nëpërmjet përdorimit me efijencë te asetëve vendore

Njesite e vete qeverisjes vendore kanë funksione të qarta në fushën e zhvillimit ekonomik vendor që përfshijnë: a) Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor; b) Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë; c) Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike; d) Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e asetëve publike etj; e) Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj; f) Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjisllacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

Pavarësisht nga kjo, njësitë e vete qeverisjes vendore aplikojnë shume pak ne politikat e tyre zhvillimin e aktiviteteve ekonomike te drejtpërdrejta ne përgjegjësinë e tyre. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kane kompetenca të plota për te ushtruar aktivitet biznesi fitimprurës me karakter ekonomik apo social (argetimi apo rekracioni), te shfrytëzojnë burimet natyrore ne territorin e tyre si dhe te drejtën te marrin licenca apo leje për këtë qellim.


³⁷ NALAS 2020, Local Government Finance Indicators in South East Europe, Statistical Brief 2020.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund dhe duhet te inkurajohen te shfrytëzojnë avantazhet qe rrjedhin nga burimet natyrore ne territorin e tyre, nga pozicioni gjeografik, nga kerkesa per produkte apo sherbime, etj. Financimi i këtyre aktiviteteve mund te behet nga te ardhurat e veta apo duke mundësuar huamarjen per projekte ekonomike dhe financiare fitim pruresë. Këto politika duhet të shkojnë përtej krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për biznesin dhe politikave fiskale vendore, duke u shtrirë edhe në bashkëpunimin financiar mes njësive të vetëqeverisjes vendore dhe financimin e projekteve të përbashkëta të zhvillimit.

4.2 Objektivi Specifik 2: Nivel i përmirësuar i parashikueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së transfertës ndërqeveritare dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për financimin me transferata për funksionet vendore apo projektet kapitale në sektorë strategjikë për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

Transferata nga qeveria qendrore përfshin ndarjen apo transferatën e te ardhurave te mbledhura nga taksat kombetare (takse sharing) si dhe transferata ne formën e granteve. Grantet janë te kushtëzuara, te pakushtëzuar si dhe transferata specifike, që është një grant i kushtëzuar për sektorin.

Figura 6: Transferata e pakushtëzuar në vite



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ne krahasim me te dhënat për vendet e rajonit, Shqipëria ka nivelin me te ulet te transfertes së pakushtëzuar dhe granteve sektoriale. Totali i transfertes nga qeveria qendrore ne Shqipëri është 1.6 përqind te PBB, ne Malin e Zi është 2.0 përqind e PBB, ne Bosnje është 2.5 përqind e PBB, ne Maqedoni është 2.8 përqind e PBB, ne Serbi është 2.9 përqind e PBB, dhe ne Kosove është 5.9 përqind e PBB.

Ekualizimi si instrument për barazinë vendore

Reforma administrativo-territoriale krijoi njësi të vetëqeverisjes vendore me potencial të ndryshëm ekonomik, social dhe zhvillimor. Këto njësi duke u mbështetur mbi kapacitetet natyrore, pozicioni gjeografik, popullsia etj., kanë në dispozicion burime të ndryshme financiare madhësia e të cilave lidhet ngushtësisht me nivelin e këtyre treguesve. Në Shqipëri përdorimi i mekanizmave të ekualizimit

fiskal është pjesë e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar që në hapat e para të nisjes së procesit të decentralizimit dhe u vendos përfundimisht si mekanizëm ligjor në nenin 24 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ekualizimi fiskal i referohet transferimit të burimeve financiare nga qeveria qendrore tek ajo vendore ose ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore me synimin për të zbutur diferencat rajonale në kapacitetin fiskal dhe nevojat për shpenzime. Ekualizimi fiskal konsiderohet një instrument i rëndësishëm mbështetës i decentralizimit fiskal, përdorimi i të cilit i mundëson pushtetit vendor t'i ofrojë banorëve nivele të ngjashme të shërbimeve publike në të gjithë territorin. Ai ka për qëllim rishpërndarjen e fondeve nga njësitet e vetëqeverisjes vendore më të pasura tek ato që përballen me kosto më të larta për frymë ose me kapacitete më të ulëta të të ardhurave për frymë.

Ekzistojnë dy metodologji kryesore të ekualizimit³⁸, ai vertikal përmes transfertave që qeveria qendrore jep për njësitet e vetëqeverisjes vendore, ose horizontal ndërmjet të ardhurave të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Pas reformës administrative - territoriale 11 bashki me mbi 100 mijë banorë ose 18% njësive të vetëqeverisjes vendore mbledhin rreth 80.8% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor dhe vetëm 2 prej njësive të vetëqeverisjes vendore më të mëdha sipas popullsisë (Tirana dhe Durrësi) mbledhin 61.8% të të ardhurave totale të pushtetit vendor. Kjo disbalancë e krijuar pas reformës konstatohet edhe në nivelin e shpenzimeve të pushtetit vendor, ku 11 bashkitë me mbi 100 mijë banorë realizojnë rreth 60.6% të totalit të shpenzimeve të buxhetit vendor dhe vetëm 2 NJVQV-të më të mëdha realizojnë 35.5%. Këto bashki të cilat mbledhin 80% të të ardhurave vendore dhe realizojnë 60.6% të shpenzimeve të pushtetit vendor administrojnë vetëm 57% ose rreth gjysmën e popullsisë së Shqipërisë, ndërkohë që gjysma tjetër e popullsisë mbledh vetëm 20% të të ardhurave dhe realizon 40% të shpenzimeve vendore.

Aktualisht, ekualizimi vertikal rregullohet nëpërmjet kufirit të poshtëm të caktuar me ligj për transfertën e pakushtëzuar, në të paktën 1% të PBB-së të vitit paraardhës fiskal. Kufiri vertikal i ekualizimit plotësohet me të ardhurat nga taksat e ndara, të cilat në Shqipëri janë modeste.

Në thelb, ekualizimi vertikal synon të sigurojë që njësitet e qeverisjes vendore kanë burimet e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të tyre dhe përpiqet të shmangë krijimin e mandateve të pafinancuara, apo krijimin e detyrimeve të prapambetura. Kufiri vertikal i ndarjes së të ardhurave me qeverisjen qendrore duhet të përcaktohet në funksion të nevojave ligjore për shpenzime që kryejnë njësitet e qeverisjes vendore. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të kryhet një studim i hollësishëm i kostos për kryerjen e funksioneve vendore dhe mekanizmave ligjorë për financimin e tyre. Ky studim, mund t'i hapë rrugën rishikimit të mekanizmave të ekualizimit fiskal vertikal - nëpërmjet rritjes së transfertës së pakushtëzuar dhe/ose taksave të ndara; dhe atij horizontal për të siguruar drejtësi në ndarjen e të ardhurave kombëtare.

Si **objektiv** i strategjisë së re të decentralizimit, këshillohet të synohet vlerësimi i impaktit periodik i mekanizmave e efektivitetit të mekanizmave të ekualizimit fiskal vertikal dhe horizontal. Rishikimi i kriterëve ekualizues me faktorë të tjerë natyrorë, demografikë, ekonomikë duhet të synojë të rrisë

³⁸ <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/55fbb497-en/index.html?itemId=/content/component/55fbb497-en>

kapacitetin financiar të njësive të vetëqeverisjes vendore me disavantazhe objektive për mobilizimin e të ardhurave të veta.

Transferta e granteve te përgjithshme dhe granteve sektoriale

Ne rastin e Shqipërisë, funksionet e përbashkëta janë transferuar në qeveritë vendore. Ato u japin qeverive lokale autoritet të konsiderueshëm për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve, duke ua bërë të qartë edhe politikebërësve kombëtarë dhe lokale se sa mbështetje financiare për shërbimet e sektorit social ofron qeveria kombëtare.

Ne stadin aktual, për shkak të shqetësimit që mund të ketë qeveria qendrore mbi rezultatin social si dhe të administrimit të dobët financiar, forma më efektive e transferimit duhet të vazhdojë të jetë nëpërmjet granteve të dedikuara sektoriale (specifike). E rëndësishme është që njësitet e vetëqeverisjes lokale të financohen gjithmonë me grante, minimalisht të barabarta me atë që qeveria qendrore kombëtare ka shpenzuar për to në kohën kur ky funksion menaxhohej nga qeveria qendrore.

Po të analizojmë vendet e rajonit përveç Kosovës, transferimi i granteve (pa tax sharing / taksat e naa) nga qeveria qendrore në Shqipëri është 1.6 për qind e PBB, në Kosovë është 6.0 për qind e PBB, në Maqedoni është 2,2 për qind e PBB, në Bosnje është 1.4 për qind e PBB dhe në Serbi dhe Malin e Zi është 0.7 për qind e PBB. Në krahasim me vendet e rajonit Shqipëria ka një nivel relativisht më të lartë se mesatarja e vendeve. Pavarësisht nga kjo është një shqetësim i përgjithshëm që decentralizimi i funksioneve nuk është shoqëruar plotësisht me nivelin e financimit të këtyre funksioneve përpara transferimit. Rritja e transferimit të qeverisë qendrore në formën e granteve duhet të synojë :

- Një objektivi afat mesëm mund të jetë të arrihet një transferim nga qeveria qendrore në një nivel 2.5% e PBB, në përafërsi me mesataren e vendeve të rajonit;
- Rivalësimin e kostove të funksioneve të përbashkëta, të cilat kanë kaluar plotësisht në përgjegjësinë e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe plotësimi i financimit të këtyre shërbimeve;
- Rritja e granteve sektoriale në veçanti për shërbimet në sektorin social, të arsimit dhe të shëndetësisë;

Si objektivi afatgjatë, krahas përcaktimit të standardeve kombëtare minimale të shëndetit dhe sigurisë për ofrimin e shërbimit dhe përlogaritjes së kostos përkatëse të ofrimit të tyre në varësi të karakteristikave rajonale dhe ekonomike, duhet të synohet rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet rritjes proporcionale të nivelit të transferimit të pakushtëzuar dhe uljes graduale të pjesës së transferimit të kushtëzuar për sektor. Kjo do të përmirësonte parashikueshmërinë e të ardhurave vendore si dhe efikasitetin në akordimin e burimeve midis sektorëve.

4.3 Objektivi Specifik 3: Rritja e kapacitetit të burimeve financiare vendore me qëllim financimin e projekteve kapitale lokale

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të rrisin kapacitet e financimit të investimeve nëpërmjet dy mënyrave: (i) financimit nga grantet e investimeve dhe (ii) financimit nëpërmjet huamarrjes

Financimi nga grantet e investimeve

Ne raport me treguesit e vendeve të rajonit, Shqipëria tregon relativisht një nivel të barabartë ose më të lartë të financimit të investimeve nga grantet e qeverisë qendrore krahasuar me vendet e tjera. Në vitin 2019, transfertat e qeverisë qendrore në formën e grantit për investime në Shqipëri është 0.5 përqind e PBB, në Kosovë është 0.6 përqind e PBB, në Serbi është 0.5 përqind e PBB, në Bosnje dhe Maqedoni është 0.4 përqind e PBB dhe në Malin e Zi është 0.2 përqind e PBB. Megjithatë financimi i investimeve nga grantet e qeverisë qendrore mbetet në vendimmarrjen e qeverisë qendrore, dhe mbart një risk që mos të reflektojë realisht nevojën e njësive të vetë qeverisjes vendore për të financuar investimet të cilat janë më prioritare.

Në thelb, transfertat e kushtëzuara për investime vendore duhet të jenë përjashtimi nga rregulli, për rastet të veçanta që kërkojnë nivele të larta investimi, apo ku qeverisja qendrore ka interesa të veçanta. Instrumente si FZHR duhet të vazhdojnë të përdoren në të mirë të realizimit të përparësive vendore, por vendimmarrja vendore në realizimin e këtyre investimeve të jete me gjithëpëfshirëse. Po ashtu, mund të eksplorohej edhe skema të tjera financimi vendor, përfshirë fondet ripërtëritëse të investimit të (bashkë)menaxhuara nga bashkitë.

Financimi nëpërmjet huamarrjes të njësive të vetë qeverisjes vendore

Në pjesën më të madhe të rajonit, huamarrja e pushtetit vendor është një fenomen i ri. Dhe në nivelin e huamarrjes së qeverisjes lokale perseri Shqipëria tregon një nivel të paperfillshëm të huamarrjes, kur ndërkohe huamarrja vendore në Bosnje, në Serbi dhe në Malin e Zi është më shumë me të lartë. Në Bosnje huamarrja është rreth 1.0% e PBB, në Serbi është 1.2% e PBB dhe në Malin e Zi është 2.4% e PBB. Maqedonia ka një nivel të huamarrjes në 0.1% e PBB dhe Kosova në 0.3% e PBB.

Një nga kufizimet kryesore për këtë burim të rëndësishëm financiar, veçanërisht për kapitalin afatgjatë investimet, përveç faktorëve të kuadrit rregullator, janë nivelet e larta të borxhit të qeverisë qendrore. Duke pasur parasysh mungesën e infrastrukturës me të cilat përballen qeveritë duhet bërë përpjekje që njësitet e vetë qeverisjes vendore të kenë akses më të zgjeruar të huamarrjes.

Duke qenë në varësi të qeverisjes vendore nga transfertat, rregullat që rregullojnë financat ndërqeveritare dhe huamarrjen duhet të jenë të qarta dhe të inkurajojnë qëndrueshmëri në huamarrjen lokale. Rritja e aksesit të njësive të vetëqeverisjes vendore ndaj huamarrjes do të kërkojë vendosjen e një kufiri të nivelit të borxhit që mund të përdoret nga qeverisja vendore, brenda kufirit të lejuar të borxhit publik. Megjithatë, ky objektivi mund të jetë i vështirë të arrihet në periudhën afatmesme për shkak të niveleve relativisht të larta aktuale të borxhit publik.

Si konkluzion, Shqipëria ka mundësi të rritjes së kapacitetit të të adhurave vendore si dhe nivelit të transfertës për financimin e funksioneve vendore. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe forcimi i kapaciteteve të mbledhjes së të ardhurave vendore të njësive të vetëqeverisjes vendore,

mund të gjenerojë të ardhura shtese në një vlerësim minimal në rreth 1.5 % të PPB dhe në një vlerësim relativisht më të lartë në 2.1 përqind të PBB. Vec rritjes së të ardhurave të veta, transferes së qeverisë qendrore, një burim tjetër i rritjes së të ardhurave mbetet gjenerimi i tyre nga aktiviteti ekonomik i drejtpërdrejtë i njesive të veteqeverisjes vendore. Ndërsa rritja e burimeve financiare për projekte investimesh përveç granteve të qeverisë qendrore ngelet i qenësishëm, një burim i konsiderueshëm dhe i cili është pothuajse i paperfillshëm mbetet rritja e huamarrjes për njesitë e vete qeverisjes vendore.

4.4 Objektivi specifik 4: Forcimi i sistemeve në nivel vendor të menaxhimit të financave publike dhe të informacionit financiar.

Sistemi Informacionit për Menaxhimin Financiar Vendor (SIMF V)


Në vitin 2022, Qeveria Shqiptare vendosi të ndërmarrë konceptimin dhe ndërtimin e një Sistemi Informacionit për Menaxhimin e Financiar për qeverisjen vendore (SIMF), më synim konsolidimin e menaxhimit financiar dhe të ofrimit të shërbimeve në qeverisjen vendore. Në ngjashmëri me AFMIS-in e zbatueshëm në nivelin qendror, synimi kryesor i AFMIS-it vendor do të jetë të mbështesë, automatizojë dhe integrojë:

- Procesin e PBA-së të qeverisjes vendore .
- Planifikimin dhe menaxhimin e projekteve vendore
- Monitorimin e performancës së NJQV-ve
- Raportimin e detyrimeve të NJVQV-ve.

AFMIS-i vendor do të duhet të jetë i lidhur me Sistemin e Infomacionit Financiar të Qeverisë së Shqipërisë (SIFQ) për të mundësuar vijueshëmrinë për planifikimin dhe zbatimin dhe për të siguruar që infomacioni për zbatimin e buxhetit nga SIFQ të përfshihet dhe të mbështesë planifikimet pasardhëse nëpërmjet AFMIS-it vendor. Lidhje duhet të vendosen edhe me Sistemin e Infomacionit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPSIS), Sistemin e Infomacionit të Asistencës së Jashtme (EAMIS) dhe Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS).

AFMIS-i vendor do të konceptohet dhe ndërtohet në tre faza, siç ilustron figura 7.

Figura 7 – Fazat e planifikimit, konceptimit dhe ndërtimit të AFMIS-it vendor



Faza 1 synon të vendosë një vizion për zgjidhjen e AFMIS-it vendor, të specifikojë kërkesat funksionale dhe të përcaktojë proceset kryesore të biznesit që duhet të mbështeten nga zgjidhjet informatike. Gjithashtu, ajo do të ofrojë një strukturë të specifikimeve për veprimtaritë dhe produktet e fazës së dytë, një vlerësim të kostos për fazën e dytë dhe një vlerësim të strukturës së kostove për veprimtaritë dhe produktet e fazës së tretë.

Faza e dytë do të përqendrohet në hartimin e një koncepti të detajuar për AFMIS-in vendor, për t’u siguruar që funksionalitetet e specifikuar gjatë fazës së parë të përfshihen qartë dhe në mënyrë të hollësishme për të udhëzuar ndërtimin e sistemit IT gjatë fazës së tretë.

Faza e parë do të përfundojë gjatë vitit 2022 dhe do të prodhojë termat e referencës për fazën e dytë. Prokurimi për fazë e dytë do të kryhet gjatë vitit 2023 dhe kjo fazë pritet të përmbyllet gjatë vitit 2024. Prokurimi për fazën e tretë do të parashikohet për fundin e vitit 2024/vitin 2025. Pritet që ndërtimi i sistemit IT për AFMIS-in vendor të fillojë gjatë vitit 2025.

Forcimi i sistemit të menaxhimit të aseteve vendore

Gjate viteve që pasuan reformën territoriale dhe transferimet e aseteve qendrorë në pronësi ose përdorim të njësive vendore e deri me sot NJQV-të vazhdojnë të përballen me sfidën e menaxhimit të duhur të aseteve të tyre. Kjo sfidë është shumëdimensionale ku mund të veçojmë:

(i) - Dimensioi Organizativ – Sistemi i menaxhimit të aseteve është i fragmentizuar në drejtori/struktura të ndryshme të bashkisë. Shumica e NJVV-ve nuk kanë staf të dedikuar dhe të përgatitur për udhëheqjen, koordinimin dhe monitorimin e të gjithë proceseve/nënprocese të nevojshme për menaxhimin e aseteve, ose mjaftohen me caktimin e vetëm një specialisti për mbajtjen e kontabilitetit (kryesisht për efekt inventari) të aktiveve afatgjatë. Mungesa e personelit të dedikuar si më lart ka sjelle mungesën e vizionit afatgjatë të bashkive për qëllimin e krijimit, vlerësimit dhe shfrytëzimit të aseteve vendore në plotësimin e objektivave afatgjatë dhe misionit të NJVV-ve.

(ii) - **Dimensioni Ligjor** – Kuadri ligjor dhe veçanërisht nënligjor ekzistues është jo gjithmonë i qarte, ku përveç akteve kuadër të menaxhimit të aktiveve, ka akte që rregullojnë faza të caktuara të procesit të menaxhimit (në disa raste në mospërputhje me njëra tjetrën), si dhe secila Ministri ka të drejtën të përcaktojë standarde që lidhen me krijimin dhe menaxhimin e kategorisë së aseteve që rregullohen nën autoritetin e tyre, për të cilat në shumicën e rasteve stafi I NJVV nuk është në dijeni apo i trajnuar sa duhet sa i përket njohjes së procesit të menaxhimit të aseteve, apo cili akt zbatohet dhe si zbatohet në faza të ndryshme të procesit. Përgjithësisht NJVV-te nuk kanë ekspertizë ligjore për të identifikuar “çfarë nuk është e ndaluar” në legjislacion dhe më tej, për të prodhuar procese që nuk shkelin kërkesat ligjore duke mbrojtur interesin më të mirë si të NJQV-së dhe të komunitetit.

Konsolidimi i sistemit të kontabilitetit, klasifikimit buxhetor dhe raportimit financiar në funksion të përmirësimit të mbikëqyrjes të financave publike të NJVVV-ve nga këshilli vendor

Për fazën tjetër të decentralizimit, do të jetë e rëndësishme të vazhdoje fokusimi tek përmirësimet e planifikimit buxhetor afatmesëm, raportimit dhe transparencës financiare dhe të performancës, si dhe llogaridhënies së njësive të vetëqeverisjes vendore. Konsolidimi i njësive të qeverisjes vendore në 61 bashki me 12 qarqet përkatëse ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e menaxhimit të financave publike në nivelin e qeverisjes vendore. Qasja më strategjike për planifikimin afatmesëm dhe zbatimin e buxhetit vendor duhet të plotësohet me tej me masa të tjera që mund përcaktohen si drejtime strategjike në strategjinë e re të decentralizimit. Këto do të kërkojnë përmirësime dhe rregullim të klasifikimeve buxhetore, planin e llogarive kontabël, përgjegjësive të kontabilitetit për të ofruar raportim të harmonizuar tek drejtuesit dhe këshilli vendor (këshilli i bashkisë ose i qarkut) për të mbikëqyruar realizimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi të ofrimit të shërbimeve publike me cilësi të mirë për banorët që i zgjedhin këto organe.

Qeveria qendrore do të vazhdojë të luajë një funksion mbikëqyrës për financat publike të qeverisjes vendore, por gjithnjë e më shumë kjo duhet të bëhet përgjegjësi e këshillave të zgjedhura, të mbështetura edhe nga aktivitetet e auditimit të jashtëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e financave të çdo bashkie dhe qarku. Funksioni mbikëqyrës i qeverisë qendrore përfshin monitorimin e rregullt brenda vitit dhe monitorimin në fund të vitit të performancës financiare të bashkive dhe qarqeve dhe vlerësimin e tij për shkallën në të cilën bashkitë përballen ose ka të ngjarë të përballen me vështirësi financiare tani dhe në të ardhmen. Për të siguruar qartësi në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit do të duhet të bëhet punë e mëtejshme për të siguruar që klasifikimi buxhetor, plani kontabël dhe formatet e raportimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore t'u ofrojnë kryetarëve të bashkive dhe stafit të tyre informacionin e nevojshëm menaxherial dhe në të njëjtën kohë t'u sigurojë këshilltarëve informacionin që u nevojitet për të siguruar që NJQVV-ja po arrin vlerën më të mirë për paranë në ofrimin e shërbimeve publike për banorët e saj.

Krijimi i nënlllogarive individuale të NJQVV-ve në llogarinë e vetme të thesarit.

Në funksion të transferimit të përgjegjësisë mbikëqyrëse, bashkitë dhe qarqet do të duhet të kenë një pamje dhe kontroll më të qartë mbi çështjet e tyre financiare. Për këtë qëllim, qeveria qendrore duhet të lejojë njësitë e vetëqeverisjes vendore të kenë llogaritë e tyre të veçanta brenda llogarisë së vetme të thesarit në Bankën e Shqipërisë. Kjo do t'u mundësojë njësive të vetëqeverisjes vendore të kenë në çdo moment pamje të qartë të likuiditeteve në dispozicion, si dhe mund të shmangë efektin e kufizimeve të vendosura nga qeveria qendrore mbi transaksionet financiare në faza të caktuara të

ciklit buxhetor; çka mund të krijojë pamundësi shpenzimi dhe mbartjen e fondeve në vitet pasardhëse buxhetore. Krijimi i llogarive të tilla nuk është vetëm praktikë e mirë, por është edhe një element kritik i autonomisë kuptimplote fiskale për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Po ashtu, në momentin që për NJQVV-të bëhet i mundur akses më i gjerë në financimet e huaja dhe huamarrjen e jashtme e të brendshme për investime, nënlllogaritë e veçanta të NJQVV-ve në Llogarinë e Vetme të Thesarit do të jenë një kërkesë e domosdoshme për kontabilitet të qartë dhe transparencë të plotë fizike dhe jo thjesht një opsion.

Përmirësimi i kontabilitetit vendor ka përfitime jo vetëm për vendimet menaxheriale dhe mbikëqyrjen brenda NJQVV-së, por vlen edhe për qartësuar ndarjen e qartë të aktiviteteve të nënsektorit të qeverisjes qendrore nga ato të nënsektorit të qeverisjes vendore kur konsiderojnë menaxhimin e qeverisjes së përgjithshme si një e tërë. Kjo do të kërkojë disa ndryshime të vogla në përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit buxhetor dhe statistikave financiare të fund vitit për nënsektorin e qeverisjes vendore, nënsektorin e qeverisjes qendrore dhe sektorin e qeverisjes së përgjithshme në tërësi. Këto do të jenë në përputhje me praktikën ekzistuese për raportimin ndërkombëtar mbi financat publike duke përdorur sistemin e Statistikave Financiare Qeveritare (FMN), i cili është baza mbi të cilën punon Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

5

Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor

Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor është një ndër objektivat e një rëndësie të veçantë në këtë strategji, me synimin për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor dhe forcim të demokracisë vendore, nxitje të politikave kundër korrupsionit dhe konsolidim i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin, si edhe avancim i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor.

Objektivi specifik 5.1 Forcimi i demokracisë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor.

Edhe pse ligjet e mësipërme janë në fuqi prej më shumë se 5 vitesh, është e vështirë të gesh këshilla bashkiakë që veprojnë në përputhje të plote me këto ligje. Ligji organik i qeverisjes vendore pavarësisht që i jep një rol domethënës këshillit bashkiak, sërish mbetet i vakët përse i përket kuptueshmërisë, ekzekutimit të rolit të këshillit bashkiak në të tre dimensionet e punës së tij, atë si Vendimmarrës, Përfaqësues dhe Mbikëqyrës.

Implementimi i parimeve të Mirëqeverisjes mbetet një sfidë për SNDQV e re. Në këtë kontekst, strategjia e re ndodhet në një moment të rëndësishëm për të përvijuar pozicionimin e NJVV-ve për të përmbushur rolin e tyre si aktorë seriozë, profesionalë, eficientë dhe llogaridhënës, ofruar shërbimesh me standarde për qytetarët e vetë kudo në territorin e vendit. Pavarësisht progresit të bërë si në kuadrin ligjor dhe atë rregullator, ndjehet dhe evidentohet nevoja për ndërhyrje për të konsoliduar, harmonizuar kuadrin ligjor si dhe për të mbështetur këshillat Bashkiakë në rritje kapacitetesh, në ndërtim të strukturave respektive administrative e menaxhuese që çojnë në rritje të

Autonomisë në përgjithësi dhe në forcimin e ndërveprimit me Institucionet në nivel qendror, rajonal e vendor, qytetarët, strukturat komunitare dhe shoqërinë civile.

Në këtë frymë, demokracia vendore do të përfitonte nga një përshkrim shterues të ligjit për Vetëqeverisjen Vendore për pasojë institucione të ndryshme e interpretojnë ligjin ndryshe, e cila sjell keqkuptim dhe vonesa në terren. Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje nga ana e këshillit në përgjithësi apo dhe vetë administratës vendore është sporadike, jo e vazhdueshme, jo e programuar dhe aq me pak e buxhetuar për aktivitetet specifike që kanë lidhje me vendimmarrjen në këshill.

Këshillat Vendorë kanë nevojë të njohin më mirë jo vetëm punën e administratës, por dhe atë të institucioneve të tjera të dekoncentruara mbi punën dhe performancën e të cilave duhet të japin gjykim, vlerësim dhe të ndërveprojnë. Ndryshimi i vazhdueshme i lidershit vendor (afërsisht 70% e këshilltareve ndryshojnë nga zgjedhja në zgjedhje) sjell probleme të mprehta në cilësinë e punës së këshillave vendorë dhe përpjekjeve për rritjen e kapaciteteve të tyre.

Këshillat dhe këshilltarët më të mirë janë ata që punojnë ngushtë me qytetarët dhe komunitetet, dhe ky është një mësim shumë i vlefshëm nga strategjia paraardhëse. Ne duam që kjo Strategji ta sjellë këtë bashkëpunim kudo dhe kurdo – që njerëzve t'u jepet më shumë kontroll mbi jetën e tyre në nivel vendor, të konsultohen dhe të përfshihen në vendimmarrje dhe aktivitetet e këshillit, të informohen dhe të vazhdojnë të ndikojnë për rritjen e cilësinë e shërbimeve në zonën e tyre. Strategjia për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Lokale 2023-2030 përcakton një agjendë për ndryshim.

Parimet kryesore mbi të cilat janë propozuar objektivat dhe aktivitetet në këtë strategji janë si më poshtë vijon:

- Mbrojtja dhe forcimi i autonomisë vendore përbën një ndihmesë të rëndësishme në ndërtimin e një Qeverisje Vendore të bazuar në parimet e demokracisë e të decentralizimit të pushtetit. Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Strategjia 2023-2030 është një dokument unik, sepse nuk ka të bëjë me një politikë sektoriale, por me një sferë të tërë qeverisjeje dhe në qendër është konsolidimi i autonomisë vendore, që është një parim kushtetues për ushtrimin e qeverisjes vendore. Qeverisja vendore është sfera e qeverisjes që ndërvepron më së afërmi me komunitetet, është përgjegjëse për shërbimet dhe infrastrukturën lokale, ka për detyrë të sigurojë zhvillimin e komuniteteve në një mënyrë që rrit pjesëmarrjen dhe llogaridhënien para komunitetit, duke patur në qendër të vëmendjes mirë-qenien e njerëzve dhe të shoqërisë në tërësi.
- Këshilla Vendorë përfaqësues, demokratikë, të afte të ushtrojnë kompetencat në mënyrë të ligjshme me mjetet e nevojshme për përmbushjen e misionit të tyre. Këshillat dhe këshilltarët e fortë bashkiakë, që përfaqësojnë komunitetet e tyre, janë në zemër të demokracisë në Shqipëri. Strategjia mundëson që përmes analizës së tre funksioneve themelore të organeve përfaqësuese të vetëqeverisjes lokale, të jepen stimuj dhe të eliminohen pengesat për ushtrimin e duhur të rolit kushtetues dhe ligjor të këshillave. Propozohen masa dhe rekomandime konkrete për forcimin e rolit përfaqësues të këshillit bashkiak, përmirësimin e procesit të miratimit të akteve ligjore dhe rritjen e kontrollit dhe llogaridhënies në veprimtarinë e këshillit.
- Komunitetet vendore janë në themel të çdo rendi demokratik; Strategjia është një mundësi për të parë përtej strukturave dhe roleve fikse, për të hartuar një sistem të vetëqeverisjes

lokale që bazohet tek marrëdhëniet; një sistem që është mjaft modern, fleksibël dhe i qëndrueshëm për t'u përballur me sfidat e ardhshme, duke përfshirë ato që janë të mëdha dhe të paparashikueshme; ka masën e duhur të shkallës dhe zërit të komunitetit; shfrytëzon forcën kolektive të qeverisë, biznesit, komuniteteve dhe të tjerëve; maksimizon përfitimin e përbashkët dhe siguron mirëqenien dhe krijon kushtet në të cilat komunitetet mund të lulëzojnë për brezat që vijnë.

- E drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike është pjesë e parimeve demokratike të Qeverisjes së Mirë. Reformat do të fuqizojnë qytetarët dhe komunitetet, do të krijojnë udhëheqje më të fortë dhe më të dukshme dhe do të ndërtojnë një kornizë të re brenda së cilës autoritetet lokale, komunitetet dhe partnerët e tyre mund të punojnë ngushtësisht së bashku. Strategjia për Decentralizim dhe Vetëqeverisje Lokale 2023-2030 do të duhet të vazhdojë me vëmendjen e duhur drejt një vendimmarrjeje të bazuar në interesat e komunitetit, si parakusht për një qeverisje të mirë vendore.

Kësisoj, në kuadër të Objektivit Specifik 1, synohet që NJVV-të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë autonome duke respektuar kuadrin ligjor, mbështetur në parimin e subsidiaritetit duke ofruar shërbime efikase dhe efçente në komunikim të vazhdueshëm dhe transparente me qytetarët.

Konsolidim i rolit të NJVV-ve në ushtrimin e funksioneve të tyre duke qartësuar mbivendojset ligjore dhe administrative në marrëdhëniet ndërqeveritare³⁹.

- Qartësimi i kompetencave, Këshill, Administrate. Ndarja e qartë e detyrave të organeve të NJVQV, duke saktësuar kompetencat e Këshillit Bashkiak si organ përfaqësues, mbikëqyrës dhe vendimmarrës dhe Kryetarit të Bashkisë si organ ekzekutiv, veçanërisht në çështjet e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve, duhet të synojë forcimin e demokracisë vendore dhe garantimin e llogaridhënies dhe balancimit të pushteteve.
- Ndërtimi i një mekanizmi nxitës për një Këshill Vendor Efikas
 1. Kryetar Këshilli
 2. Performancë në punë në këshill
 3. Buxhet këshilli (qeverisja e këshillit)
- Nxitja e krijimi i modeleve pozitive të NJVV.
- Këshillat Bashkiak, Planifikojnë, Ekzekutojnë dhe raportojnë për punën e tyre.
- Zhvillimi i një platforme të rrjetëzimit/shkëmbimit të përvojave ndërmjet këshilltarëve në Shqipëri dhe me organizatat rajonale që përfaqësojnë dhe mbështesin këshilltarët.

Sigurimi i përfaqësimit, udhëheqjes, planifikimit dhe vendimmarrjes demokratike dhe efektive;

- Përmirësime të përshtatshme në kodin zgjedhor dhe në ligjin organik për përfaqësim më të "gjerë" gjeografik.
- Miratimi, përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor për konsultimin publik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen vendore.
- Rritje dhe forcim i rolit dhe veprimtarisë së komisioneve të këshillit bashkiak si organe të një rëndësi të madhe në veprimtarinë ligjëbërëse dhe monitoruese të tij.

³⁹ Kodi 4.1.1 – është për Fushën e 4, pjesa e parë që është demokracia vendore (4.1) ndërsa 4.2 është EU standard...) dhe objektivi i parë (1)

- Këshillat Vendor të jenë transparent dhe të përgjegjshëm për vendimet dhe/ose aktet që miratojnë (faqja e internetit të bashkive)
- Të sigurojë që të gjitha informacionet dhe dokumentet përkatëse të Këshillit të publikohen dhe të kuptohen lehtësisht.
- Digjitalizimi dhe e-qeverisja në nivel vendor do të duhet të jetë prioritet i qeverisë, duke u realizuar paralelisht me e-qeverisjen dhe shërbimet online të ofruara nga institucionet qendrore.
- Ndërtim i procedurave për përqafimin dhe konsolidimin e e-Qeverisjes nëpërmjet standardeve të vendosura dhe të sigurta.
- Të përmirësojë vazhdimisht ofrimin e shërbimeve për komunitetin në përgjigje të monitorimit të performancës të kryer nga Këshilli Bashkiak.
- Forcimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore do të nevojitet të mbështetet nëpërmjet fuqizimit të rolit të ASPA dhe institucioneve të tjera mbështetëse, ngritjes së institucioneve të reja në mbështetje të fuqizimit të burimeve njerëzore të administratës dhe këshillave vendore si dhe inkurajimit të projekteve dhe programeve me financim vendas dhe të huaj.

Krijimi i strukturave komunitare të zgjedhura demokratikisht, të informuara dhe efektive, të afta për të përmbushur rolin e tyre në bashkëpunim me organet e zgjedhura dhe ekzekutive.

- Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Referendumin për çështjet vendore si një domosdoshmëri.
- Të sigurohet dhënia e kontributit dhe përfshirja sistematike e komunitetit në veprimtarinë dhe në vendimmarrjen e këshillit bashkiak, si dhe në monitorimin e zbatimit të politikave vendore.
- Monitorimi i veprimtarisë së këshillave dhe administratës publike vendore.
- Përmirësimi i mekanizmave dhe instrumenteve që nxisin pjesëmarrjen e komunitetit në vendimmarrje, me fokus ofrimin e mbështetjes së nevojshme për shtrirjen e e-qeverisjes në nivel vendor (vendimmarrës dhe ekzekutiv).

Përmirësimi i kuadrit institucional në mbështetje të një qeverisjeje vendore transparente dhe gjithëpërfshirëse, në linjën me strategjinë e kundër korrupsionit (SNKK 2023-2030)

- Të sigurohet dhënia e kontributit dhe përfshirja sistematike e komunitetit në veprimtarinë dhe në vendimmarrjen e këshillit bashkiak, si dhe në monitorimin e zbatimit të politikave vendore.
- Rritje në aksesin e qytetarëve nëpërmjet digjitalizimit të sistemit në NJVV përmes krijimit dhe vendosjes së E-Platformave.
- Rishikimi, miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit. Raportimi para Këshillave dhe Qytetarëve. Përfshirja e Qarqeve dhe Prefekturave në këtë proces.
- Menaxhimi i riskut të korrupsionit brenda qeverisjes.
- Përmirësimi i strukturës IT të këshillave Bashkiak në shërbim të transparencës dhe komunikimit me qytetarët.
- Edukimi ligjor i publikut nëpërmjet përmirësimit të platformave informuese dhe të e-qeverisjes.

Objektivi specifik 5.2: Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin.

“Transparency International” i kualifikon integritetin, transparencën dhe llogaridhënien si tre nga elementet kyçe gjithëpërfshirëse të nevojshme për parandalimin efikas të korrupsionit në institucionet publike⁴⁰: Kur aktorët kryesorë publikë në nivel vendor sillen me ndershmëri dhe i përmbushin mandatet e tyre në përputhje me normat strikte etike dhe morale, nuk mbetet hapësirë për korrupsion. Konsolidimi dhe përdorimi në rritje i këtij instrumenti nga më shumë se gjysma e bashkive në Shqipëri si dhe kthimi i planeve të integritetit në standard dhe pjesë përbërëse të menaxhimit të përgjithshëm të administratave vendore është pjesë e objektivave të projektit aktual STAR3.

Miratimi i instrumenteve të integritetit nga një numër i konsiderueshëm i njësive të qeverisjes vendore do të krijojë një mjedis favorizues dhe do të përbëjë kushtet minimale të nevojshme për një kulturë të re pune dhe për një sistem të monitorimit të integritetit, në dobi si të qeverisë qendrore ashtu dhe asaj vendore. Krahas përpjekjeve të tjera dhe asistencës në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel bashkie, investimi në ngritjen e kapaciteteve do të kontribuojë në frenimin e korrupsionit dhe, për rrjedhojë, në harmonizimin me kërkesat e strategjive kombëtare të reformës kundër korrupsionit dhe asaj në administratën publike, midis të tjerave. Kjo ndërhyrje i përgjigjet gjithashtu mangësive të identifikuar nga Hartëzimi i Qeverisjes Vendore për vitin 2020 i projektit STAR2, ku perceptimet e qytetarëve në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien duket se kanë qëndruar në po të njëjtat nivele të ulëta të vitit 2016, sidomos në bashkitë më të mëdha.

Objektivat specifik lidhur me nxitjen e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor janë si më poshtë vijon:

Finalizimi i procesit të hartimit të Planeve Vendore të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes

dhe dërgimi i tyre për miratim pranë këshillave bashkiake në të gjitha bashkitë sipas fazave (faza I - 16 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes, faza II – 24 bashki, duke përfunduar kështu edhe hartimin e miratimin e të gjithë planeve të integritetit në nivel vendor). Të dyja fazat janë pjesë e planit afatshkurtër të veprimit të kësaj strategjie, konkretisht 2023-2025.

Krijimi i mekanizmit të brendshëm institucional të strukturave qendrore për monitorimin e elementëve të demokracisë vendore dhe luftës kundër korrupsionit në nivel vendor.

Ky objektivi është i një rëndësie të madhe, duke qenë se veçanërisht demokracia vendore dhe mirëqeverisja duhen monitoruar, dhe eventualisht kalibruar sipas kontekstit. Në këtë rast, Ministria e Brendshme dhe AMVV kanë rol kyç për të monitoruar produkte të lidhura me këtë fushë, për shembull planet e integritetit, programi i transparencës, etj. Ndaj, lipset krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm, jo ad-hoc, për monitorimin e elementëve të demokracisë vendore dhe luftës kundër korrupsionit. Kjo

⁴⁰ Integriteti i qeverisjes vendore: Principles and Standards - Nuno Ferreira da Cruz, Michel Gary - Transparency International © 2015 - ISBN: 978-3-943497-75-5

kërkon së pari, evidentimin e këtyre elementëve, në koordinim edhe me institucione qendrore, vendore apo edhe partnerë zhvillimi (p.sh. Komisioni për të Drejtën e Informimit).

Objektivi specifik 5.3 Avancim i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor

Integrimi në BE është një proces sfidues që kërkon shumë përpjekje të administratës qendrore dhe lokale. Krijimi i një administrate publike jo-burokratike, profesionale dhe transparente, e aftë për të përballuar sfidat që sjell integrimi në BE dhe përthithja e fondeve të BE-së është një nga synimet kryesore në avancimin e reformës së administratës publike në nivel vendor. Për të arritur këtë synim ndër të tjera del e nevojshme:

Fuqizimi i kapaciteteve të administratës vendore që të jetë e aftë për të përballuar sfidat që sjell integrimi Evropian i vendit dhe përthithja e fondeve të BE-së, në respekt të plotë të standardeve të administratës publike në nivel vendor.

Forcimi i kapaciteteve për përthithjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga BE. Ekziston një dallim i madh përsa i përket njohurive në për të aplikuar dhe zbatuar projektet e financuara nga BE. Në bashkitë e mëdha, si dhe në disa bashki të nivelit të mesëm ka informacion të mirë dhe aftësi të nevojshme për të aplikuar dhe zbatuar projektet e financuara nga BE. Ndërsa në bashkitë e vogla stafet pothuajse mungojnë dhe kapacitetet janë në nivele të ulëta.⁴¹ Përthithja e specialisteve me njohuri të gjuhës angleze dhe me disa njohuri për projektet është problematike në bashkitë e vogla ku sistemi i pagave është jo atraktiv për të siguruar qëndrueshmëri të stafeve.

Mungon një sistem kombëtar monitorimi dhe informacioni për projektet e financuara nga BE dhe donatorët e zbatuar nga pushteti vendor që të shërbejë si një dritare e unike informacioni mbi projektet e financuara nga BE dhe donatorët. Mungesa e informacionit është shpesh një pengesë për të identifikuar problemet dhe pengesat e përbashkëta me të cilat përballen njësitë e qeverisjes vendore në zbatimin e projekteve me financim të huaj.

Procedurat e qeverisë për fillimin e zbatimit të projekteve: Pavarësisht hapave pozitivë që janë ndërmarrë nga MEF për reduktimin e burokracisë dhe përmirësimin e situatës si: shkurtimi i periudhës së gjatë dhe lehtësimi i hapjes së llogarive bankare si parakusht për fillimin e një projekti⁴², megjithatë, në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor procedura është ende e gjatë dhe ka ende pengesa burokratike që duhen zgjidhur.

Roli i pushtetit vendor në zbatimin e politikave, zbatimin e Acquis të BE-së dhe agjendën e përgjithshme të integrimit evropian është shumë i rëndësishëm. Komisioni Evropian e thekson këtë

⁴¹Paga e stafit dhe mundësitë për karrierë për punonjësit e pushtetit vendor është një pengesë me të cilën po përballen çdo ditë bashkitë e vogla.

⁴²Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 35 dt.21.09.2020 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e projekteve të financuara nga jashtë në kuadër të marrëveshjes ndërkombëtare". Ajo thjeshtoi të gjithë procedurën përmes:

- Përcaktimi në mënyrë të detajuar të të gjitha hapave që duhet të ndërmerren në lidhje me hapjen e një llogarie bankare të projektit, së bashku me anekset/formatet përkatëse për t'u plotësuar.
- Përcaktimi i afateve kohore për përfundimin e procedurave për të shmangur vonesat, por edhe për të monitoruar zbatimin e Udhëzimit
- Përcaktimi i modaliteteve se si përfituesit mund të marrin dokumentacionin që do të dorëzohet.

rol në Komunikatën e 2019-ës mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së "Roli i autoriteteve rajonale dhe lokale në procesin e harmonizimit të BE-së dhe zbatimin eventual i rregullave të BE-së duhet të merret parasysh. Duhet të gjendet një ekuilibër i përshtatshëm ndërmjet qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore që të mbështesë më së miri zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët."⁴³

Roli i qeverisjes vendore në zbatimin e politikave, Acquis të BE-së dhe agjendës së përgjithshme të integritimit evropian është shumë i rëndësishëm. Strategjia Evropa 2020 thekson rolin e rëndësishëm të qeverive vendore, duke theksuar shprehimisht se: "Të gjitha autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale duhet të zbatojnë partneritetin, duke i lidhur ngushtë parlamentet, partnerët socialë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, duke kontribuar në përpunimin e programeve kombëtare të reformave dhe për zbatimin e tij. Dialogu midis qeverisë qendrore, rajonale dhe vendore do t'i sjellë prioritetet e BE-së më afër njerëzve, duke forcuar ndjenjën e pronësisë së nevojshme për të përfshirë të gjithë në lëvizjen e Evropës drejt objektivave të 2020-ës."⁴⁴

Procesi i anëtarësimit mund të përfitojë shumë nga përfshirja e qeverisjes vendore. Nëse angazhohen drejtpërdrejt, administratat vendore dhe qytetarët shqiptarë mund të mësojnë më së miri, të përfitojnë nga mundësitë dhe të përballojnë sfidat që nënkupton integrimi në BE. Zbatimin e standardeve të integritimit në BE është një proces shumë i rëndësishëm dhe sfidues. Ndërsa procesi i anëtarësimit përparon, më shumë kërkesa do të shtrohen përpara drejtuesve dhe administratave të qeverisjes vendore për t'u siguruar që qytetarëve t'u ofrohen të njëjtat shërbime si qytetarët e tjerë të BE dhe që demokracia lokale të zbatohet në mënyrë efektive dhe gjithëpërfshirëse.⁴⁵

5.3.1 Rritja e kapaciteteve të njësive të qeverisjes vendore për të zbatuar me sukses detyrimet e anëtarësimit në BE

Propozohen masat e mëposhtme:

- *Masa 1.1 Sigurimi i angazhimit të plotë të autoriteteve të qeverisjes vendore në procesin e negociatave:* të qartësohen mekanizmat e koordinimit ndërmjet nivelit të qeverisjes qendrore dhe vendore që do të sigurojë pjesëmarrjen dhe kontributin e NjQV përpara marrjes së angazhimeve që rrjedhin nga 23 kapitujt e acquis ku pushteti vendor është i përfshirë në zbatimin e legjislacionit.
- *Masa 1.2 Forcimi i rolit të Këshillit Konsultativ për monitorimin e performancës së pushtetit vendor në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të axhendes së anëtarësimit në BE,* si dhe sigurimin që politikat dhe veprimet e nevojshme ligjore të merren parasysh nga qeveria qendrore për të mbështetur proceset e integritimit në BE në nivel lokal. Progresi i bërë drejt diskutimit të përmbushjes së detyrimeve (monitorimit dhe vlerësimit) duhet të bëhet pjesë sistematike dhe integrale e aktivitetit të KK.
- *Masa 1.3 Përfshirja e procesit të integritimit në BE në procesin e përgjithshëm të politikëbërjes së qeverisjes vendore.* Për të siguruar përfshirjen e duhur dhe rolin udhëheqës të nivelit të lartë menaxherial është e rëndësishme që proceset dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE të

⁴³Komisioni Evropian "Komunikimi i Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve - Komunikatë 2019 mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së "29.5.2019 COM (2019) 260 final, Fq 7.

⁴⁴Komisioni Evropian, Strategjia Evropa 2020

⁴⁵Fjala e ish-kryenegociatorit z.Zef Mazi në Konferencën për mbështetjen e BE-së për LG-në në Shqipëri, 14 tetor 2021

futet në sistemin vendimarrës të Këshillit Bashkiak, si dhe të bëhen pjesë e punës së Grupit për Menaxhimit Strategjik në nivel bashkie. Miratimi i mekanizmave të llogaridhënies që sigurojnë monitorimin sistematik nga Këshillat Rajonalë dhe Bashkiakë të zbatimit të kërkesave të që shtron përpara NjQV procesi i asociimit në BE.

- *Masa 1.4 Forcimi i rolit të Njësive të BE-së për të koordinuar dhe marrë pjesë në proceset e zhvillimit të politikave bashkiake:* Njësitë e Integritit Evropian jo vetëm që duhet të përpunojnë informacionin dhe të koordinojnë proceset e brendshme, por ato duhet të rrisin kontributin e tyre në proceset e zhvillimit të politikave lokale për të siguruar që kërkesat e integritit në BE të merren parasysh nga administrata gjatë gjithë proceseve të tyre administrative.
- *Masa 1.5 Shtrirja e proceseve të integritit në BE përtej Njësive të BE-së, duke siguruar përfshirjen dhe kontributin e duhur të gjithë administratës lokale.* Rritja e vetëdijes dhe të kuptuarit e të gjitha departamenteve teknike në NjQV rreth çështjeve që kanë të bëjnë me BE-në dhe që kanë rëndësi për të gjithë administratën bashkiake. Rishikimi i rregulloreve të brendshme për të përfshirë proceset e integritit si pjesë integrale e punës së NjQV. Zhvillimi i mëtejshëm i kurrikulave të ASPA-s lidhur me Integritin në BE dhe Qeverisjen Vendore dhe ofrimi i trajnimeve si për të zgjedhurit ashtu edhe për administratën vendore dhe rajonale. Organizimi i seminareve të dedikuara me kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiakë duke u fokusuar më shumë në rolin e pushtetit vendor në zbatimin e *acquis*; informacion mbi procesin e negociatave dhe tema të tjera të ngjashme.

5.3.2 5.3.2 Forcimi i kapaciteteve të NJQV-ve për të përfituar nga mundësitë e financimit të BE-së

Propozohen masat e mëposhtme

- *Masa 2.1 Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për NjQV për aplikim dhe zbatim të suksesshëm të projekteve të financuara nga BE-ja.* ASPA me mbështetjen e projektit të asistencës teknike të BE-së të rrisë numrin e trajnimeve për të gjithë administratën lokale për të zgjeruar njohuritë mbi fondet e BE-se dhe përgatitjen e aplikimeve për fonde të BE-se.
- *Masa 2.2 Zhvillimi i udhëzimeve ndihmuese për administratën lokale* që të kuptojë dhe zbatojë kërkesat që lidhen me rregullat e zbatimit të projekteve të financuara nga BE, e shoqëruar me asistencën e vazhdueshme për të siguruar zbatim të suksesshëm të projekteve.
- *Masa 2.3 Krijimi i një sistemi monitorimi dhe raportimi për projektet e zbatuara nga NJVV.* Sistemi i Menaxhimit Financiar të Ndihmës së Huaj (EAFMIS) duhet të përfshijë raportimin nga NJVV mbi projektet e financuara nga BE-në dhe donatorët e tjerë.
- *Masa 2.4 Përmirësimi i procedurave lidhur me zbatimin e projekteve të financuara nga BE-ja dhe donatorët.* Procedurat për hapjen e llogarisë bankare duhet të rishikohen për të shkurtuar më tej kohën dhe për të lehtësuar procesin e kontraktimit ndërmjet entitetit publik dhe autoritetit kontraktues.

6

Forcimi i kapaciteteve institucionale të strukturave qendrore dhe të dekoncentruara në mbështetje të qeverisjes vendore.

Kjo shtyllë e strategjisë përfshin forcimin e kapaciteteve institucionale të një sërë strukturash në mbështetje të qeverisjes vendore si Ministria e Brendshme/Drejtoria për Çështjet Vendore, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Këshilli Konsultativ, Grupi Tematik i Decentralizimit, dhe Institucion i Prefektit.

Grupi Tematik i Decentralizimit (GTD) konsiderohet si një forum/platformë dialogu koordinimi ndërmjet ministrive të linjës, agjencive shtetërore, shoqatave të bashkive, përfaqësuesve të institucionit të prefektit, donatorëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Një forum i tillë është pjesë e Grupit të Menaxhimit të Politikave të Integruara nën menaxhimin e Zëvendëskryeministrit. Ndër të tjera, GTD konsiderohet një mekanizëm i rëndësishëm për koordinimin e donatorëve, ku mbahen takime të veçanta për të diskutuar mbi aspekte specifike të planeve të partnerëve zbatues, duke shmangur çdo mbivendosje të mundshme midis donatorëve dhe duke përdorur më së miri burimet e tyre. AMVV ashtu edhe Drejtoria e Çështjeve Vendore në Ministrinë e Brendshme luajnë rolin e sekretariatit teknik të GTD.

Për sa i përket Këshillit Konsultativ, ky mekanizëm shërben si platformë institucionale për konsultim ndërmjet qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, duke ofruar një forum për dialog dhe advokim. Këshilli Konsultativ, ndryshe nga GTD, ka një fokus të veçantë në konsultimin me Qeverisjen Vendore të projektakteve, politikave dhe strategjive që prekin qeverisjen vendore. AMVV luan rolin e Sekretariatit Teknik për Këshillin. Roli i saj ka ardhur vazhdimisht në rritje si nga pikëpamja sasore ashtu edhe cilësore lidhur me diskutimet dhe aktet ligjore të konsultuara, veçanërisht gjatë viteve të fundit ku intensiteti i takimeve është rritur ndjeshëm (nga 3 akte ligjore në 2017 në 236 në 2022).

Në strategjinë e re, roli i AMVV si sekretariat teknik i Këshillit Konsultativ do të shtohet, duke u rritur roli i tij në koordinimin paraprak (para fazës së kalimit në konsultim) me institucionet qendrore, por edhe duke nxitur NJVV dhe shoqatat për të ardhur me propozime konkrete mbi ndryshime ligjore dhe nënligjore. Në të njëjtën kohë, roli i AMVV do të rritet edhe në kuadër të Kapitullit 22, sërisht në rolin e saj si Sekretariat Teknik. Vëmendje të shtuar do kenë të dy strukturat mbi koordinimin me NJVV dhe ndjekjen/monitorimin e agjendës së decentralizimit, përfshirë institucionet qendrore, vendore, shoqatat e qeverisjes vendore, partnerët e zhvillimit dhe organizatat joqeveritare.

Ky objektivi përfshin objektivat specifike si më poshtë vijon:

Objektivi Specifik 6.1: Hartëzim i marrëdhënieve, roleve dhe detyrave të institucioneve qendrore dhe dekoncentruara në mbështetje të qeverisjes vendore

Objektivi Specifik 6.2: Forcimi i kapaciteteve të strukturave qendrore

Objektivi Specifik 6.3: Forcimi i kapaciteteve të strukturave të dekoncentruara

3.4 Treguesit e nivelit strategjik

Emërtimi i Indikatorit	Numri i bashkive që financojnë shërbimet sociale përmes mekanizmit të Fondit Social		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 2: Ofrimi cilësor i shërbimeve vendore sipas standardeve kombëtare, shoqëruar me rritje të performancës së bashkive dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti i Monitorimit të zbatimit të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale i ministrisë përkatëse		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale /Shërbimi Social Shtetëror		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky indikator mat numrin e bashkive që përfitojnë mbështetje financiare përmes Fondit Social (qendror) dhe kanë ngritur mekanizmat financiare vendore për të garantuar qëndrueshmërinë e këtyre shërbimeve. Përpunimi i të dhënave matet si shuma e numrit të bashkive që janë mbështetur përmes Fondit Social dhe si përqindje (%) ndaj totalit të bashkive. Formula: $Ix = \frac{\text{Numri i bashkive që përfitojnë mbështetje financiare përmes FS}}{61} * 100$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2021	
	Vlera bazë	23% (14 bashki)	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2023	2024
	Vlera e indikatorit	49% (30 bashki)	74% (45 bashki)

Emërtimi i Indikatorit	Numri i bashkive që ofrojnë shërbime sociale me bazë komunitare		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 2: Ofrimi cilësor i shërbimeve vendore sipas standardeve kombëtare, shoqëruar me rritje të performancës së bashkive dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti i Monitorimit të zbatimit të Strategjisë Së Mbrojtjes Sociale i ministrisë përkatëse		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale /Shërbimi Social Shtetëror		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky indikator mat numrin e bashkive që kanë ngritur shërbime me bazë komunitare për të paktën tre nga kategoritë kryesore të përfituesve (gratë dhe vajza, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të moshuarit në nevojë). Përpunimi i të dhënave është shuma e bashkive që kanë ngritur këto shërbime dhe si përqindje (%) ndaj totalit të bashkive.		

	Formula: $Ix = \frac{\text{Numri i bashkive që kanë ngritur shërbime me bazë komunitare}}{61} * 100$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2022	
	Vlera bazë	25% (15 bashki)	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2023	2024
	Vlera e indikatorit	31% (20 bashki)	41% (25 bashki)

Emërtimi i Indikatorit	Numri i përfituesve në skemat e miratuara të strehimit social që i përkasin grupeve në pozita të pafavorizuara.		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 2: Ofrimi cilësor i shërbimeve vendore sipas standardeve kombëtare, shoqëruar me rritje të performancës së bashkive dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti i Monitorimit të zbatimit të Strategjisë së Strehimit Social të ministrisë përkatëse (MFE)		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financës dhe Ekonomisë		
Shpeshësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky indikator mat aksesin kategorive të pafavorizuara në programet e strehimit social. Treguesi matet duke pjesëtuar numrin total të përfituesve nga kategoritë në nevojë kundrejt totalit të aplikantëve nga kjo kategori. Vlerat e treguesve merren në terma nominal për të njëjtën periudhë reference. Treguesi shprehet në vlerë absolute (totali i përfituesve) dhe në % (raporti i përfituesve). Formula: $Ix = \frac{\text{Numri i përfituesve të programeve të strehimit që i përkasin kategorive në nevojë}}{\text{numrit të aplikantëve}} * 100$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	19% (nr i aplikantëve 18,661 dhe nr i përfituesve nga grupet e magjinalizuara 3,603)	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2023	2025
	Vlera e indikatorit	35 %	50%

Emërtimi i Indikatorit	Numri i bashkive që trajtojnë mbetjet sipas standardeve		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi C: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit		

Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues mat numri e bashkive që trajtojnë mbetjet sipas standardeve në vitin t. Treguesi at vlerën totale të bashkive që trajtojnë mbetjet në vitin raportues kundrejt numrit total të bashkive që trajtojnë mbetjet në total Formula: $N_{BMB} = \frac{\text{Numri i bashkive që pritet të trajtojnë mbetjet}}{\text{Vlera totale e bashkive që trajtojnë mbetjet}}$ Ku: V_{BMB} = Vlera totale e bashkive që trajtojnë mbetjet të shtuara gjatë vitit raportues V_{BTMB} = Vlera bashkive në total që trajtojnë mbetje		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2022	
	Vlera bazë	N/A	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2023	2025
	Vlera e indikatorit	10% me shume	10% me shume

Emërtimi i Indikatorit	Punonjësit e policies bashkiake të trajnuar në nivel vendor		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 2: Ofrimi cilësor i shërbimeve vendore sipas standardeve kombëtare, shoqëruar me rritje të performancës së bashkive dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	61 Bashkitë		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	MB/Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues shpreh numrin e punonjësve të policisë bashkiake të trajnuar në nivel vendor duke u matur në përqindje si Formula: Numri i punonjësve të policisë bashkiake të trajnuar / Numrit total të punonjësve të policisë bashkiake (shprehur në përqindje) për vitin t= _____		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2023	
	Vlera bazë	N/A	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2024	2025
	Vlera e indikatorit	35%	100%

Emërtimi i Indikatorit	Të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme në raport me PBB (%)		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 4: Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit (MFE); Raporti i financave të qeverisjes vendore (MFE)		

Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Shpeshësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues mat të ardhurat nga taksat e pasurisë së paluajtshme (taksa e ndërtesës, taksa e tokës, taksa e truallit) në raport me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB). Vlerat e treguesve merren në terma nominalë për të njëjtën periudhë reference. Treguesi shprehet në %.		
	Formula: $I_b = \frac{\text{Të ardhura nga taksa e pasurisë së paluajtshme}}{\text{Produkti i Brendshëm Bruto}} * 100\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2021	
	Vlera bazë	0.3%	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2025	2030
	Vlera e indikatorit	0.7%	1%

Emërtimi i Indikatorit	Buxheti i qeverisjes vendore në raport me PBB (%)		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 4: Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit (MFE); Raporti i financave të qeverisjes vendore (MFE)		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Shpeshësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues mat shpenzimet e përgjithshme (peshën) e qeverisjes vendore në raport me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) (pa përfshirë shpenzimet e mbrojtjes shoqërore). Vlerat e treguesve merren në terma nominalë për të njëjtën periudhë reference. Treguesi shprehet në %.		
	Formula: $I_b = \frac{\text{Shpenzimet e qeverisjes vendore}}{\text{Produkti i Brendshëm Bruto}} * 100\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2021	
	Vlera bazë	5.8%	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2025	2022
	Vlera e indikatorit	6.5%	7.5%

Emërtimi i Indikatorit	Raporti i të ardhurave të veta vendore në raport me PBB (%)		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 4: Forcimi i Financave Vendore dhe Autonomisë Fiskale		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit (MFE); Raporti i financave të qeverisjes vendore (MFE)		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		

Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues mat performancën e qeverisjes vendore në mbledhjen e të ardhurave të veta. Më specifikisht merret vlera e të ardhurave të qeverisjes vendore nga burimet e veta (taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat jotatimore vendore) pa përfshirë taksat e ndara apo transfertat duke i pjesëtuar me vlerën e Produktin e Brendshëm Bruto (PBB). Vlerat e treguesve merren në terma nominalë për të njëjtën periudhë reference. Treguesi shprehet në %.		
	Formula:		
	$I_{TRV} = \frac{\text{Të ardhurat e veta}}{\text{Produkti i Brendshëm Bruto}} * 100\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2021	
	Vlera bazë	1.67%	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2025	2030
	Vlera e indikatorit	1.8%	2%

Emërtimi i Indikatorit	Raporti i financimit nga transfertat e pakushtëzuar dhe taksat e ndara në raport me PBB-në (%)		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 4: Forcimi i Financave Vendore dhe Autonomisë Fiskale		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit (MFE); Raporti i financave të qeverisjes vendore (MFE)		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues mat ekualizimin vertikal mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke matur burimet që buxheti i shtetit ndan me qeverisjen vendore në formën e transfertës së pakushtëzuar (pa përfshirë grante sektoriale) dhe taksave të ndara kombëtare; duke i pjesëtuar me vlerën e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Vlerat e treguesve merren në terma nominalë për të njëjtën periudhë reference. Treguesi shprehet në %.		
	Formula:		
	$I_{TRV} = \frac{\text{Totali i të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar dhe taksat e ndara}}{\text{Produkti i Brendshëm Bruto}} * 100\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2019	
	Vlera bazë	3.1%	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2020	2022
	Vlera e indikatorit	3.2%	3.5%

Emërtimi i Indikatorit	Numri i bashkive që marrin vleresim të lartë për sistemet e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 4: Forcimi i Financave Vendore dhe Autonomisë Fiskale		

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Ky tregues mat numrin e bashkive që kanë vlerësim të lartë sipas Raportit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (MFE). Vlerësim I lartë për një bashki quhet kur sipas indikatorëve të performancës së Kontrollit Brendshëm Publik Financiar Publik bashki merr 64 pikë që është totali në vitin t.</p> <p>Vlerësimi bëhet si përqindje duke marrë numrin e bashkive që marrin vlerësimi të lartë sipas indikatorëve të performancës së Kontrollit Brendshëm Publik Financiar Publik për vitin t dhe pjestohet me numrin total të bashkive.</p> <p>Formula:</p> $I_{TRV} = \frac{\text{Numri i bashkive që marrin 64 pikë sipas KBPF}}{61} * 100\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2021	
	Vlera bazë	15% (9 bashki)	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2025	2030
	Vlera e indikatorit	23% (14 bashki)	39% (24 bashki)

Emërtimi treguesit	Zhvillimi i sistemit të informacionit financiar në nivel vendor (SIMFV)		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 4: Forcimi i Financave Vendore dhe Autonomisë Fiskale		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raport i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky është tregues procesi që monitoron progresin për ndërtimin dhe zhvillimin e SIMFQV-së.		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2022	
	Vlera bazë	Nuk ka SIMFQV	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2025	2030
	Vlera e indikatorit	Kontraktohet zhvillimi i sistemit	SIMFQV funksional në të gjitha NJQV-të
Emërtimi i Indikatorit	Numri i planeve të integritetit të hartuara në nivel vendor		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 5: Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Ministria e Brendshme/Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		

Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues mat numrin e bashkive që kanë hartuar një plan integriteti në vitin t. Formula: Numri i bashkive që hartojnë plan integriteti në vitin t		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2021	
	Vlera bazë	21	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2023	2025
	Vlera e indikatorit	5 më shumë	20 më shumë

Emërtimi i Indikatorit	Numri i akteve ligjore që adoptojnë direktivat e BE-se të shqyrtuara nga KK		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi 6: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Ministria e Brendshme		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	MB/AMVV		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Treguesi mat përfshirjen e bashkive në diskutimin e ndryshimeve të legjislacionit shqiptar për përafrimin e tij me legjislacionin evropian. Formula: $N_{ALP} = \frac{\text{Totali i akteve ligjore që përafrohen me LE të shqyrtuara në KK}}{\text{Totali i akteve ligjore të shqyrtuara në Këshillin Konsultativ}}$ Ku: ALP = raporti që zënë aktet ligjore që përafrojnë legjislacionin evropian dhe që kanë ndikim në nivelin vendor kundrejt totalit të akteve që shqyrtohen në Këshillin Konsultativ KK = Këshilli Konsultativ LE = Legjislacioni Evropian që përfaqëson një ose më shumë direktiva të Bashkimit		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2022	
	Vlera bazë	NA	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2023	2025
	Vlera e indikatorit	Tendencë në rritje	Tendencë në rritje

Emërtimi i Indikatorit	Numri i projekteve të financuara nga BE në nivelin vendor		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi specifik 2: Forcimi i kapaciteteve të NJQV-ve për të përfituar nga mundësitë e financimit të BE-së		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	MB/AMVV		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	AMVV		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		

Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi mat kapacitetet e bashkive për të përthithur financimet e huaja dhe në mënyrë të vecantë fondet e Bashkimit Evropian. Treguesi mat vetem numrin e bashkive që përfitojnë fonde nëpërmjet aplikimit si përfitues direkt të projekteve në vitin t (psh IPA CBC, interreg, cross-border, etj) dhe jo si përfitues indirekt të financimeve që vijnë nga projektë që zbatohen nga institucione qendrore apo agjensi zbatuese (p.sh. asistenca teknike, projekte investimesh ku zbatuesi direkt i projektit/financimit nuk është bashkia).</p> <p>Këtu llogariten dy tregues respektivisht:</p> <p>$N_{PBE} = \%$ që zënë projektet që financohen nga programe të Bashkimit Evropian</p> <p>$N_{PLP} =$ Numri i projekteve ku bashkita janë drejtues projekti (lead partner)</p> <p>Formula:</p> $N_{PBE} = \frac{\text{Numri total i projekteve të financuara nga BE}}{\text{Numri total i projekteve të financuara nga donatorët e huaj}}$ $N_{PLP} = \frac{\text{Numri total i projekteve ku bashkitë janë Partneri Kryesor (Lead Partner)}}{\text{Numri total i projekteve të financuara nga BE}}$		
	Informacion për vlerat bazë	Viti	2022
	Vlera bazë	(do llogaritet në Prill 2024)	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2025	2030
	Vlera e indikatorit	Rritje me 5%	Rritje me 10%

4. Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese

Monitorimi i zbatimit të SKNQV 2023 - 2030 është një proces thelbësor i Ministrisë së Brendshme, pasi siguron monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të agjendës së decentralizimit dhe politikave vendore, ashtu edhe korrigeime të shpejta në rast mos zbatimi sipas planit të veprimit apo adresimi sipas institucioneve përgjegjëse.

Fuqizimi i dy strukturave teknike të Ministrisë së Brendshme (Drejtoria e Çështjeve Vendore dhe AMVV) garanton një funksionim më të mirë për pjesën e monitorimit të strategjisë por edhe në të njëjtën kohë në implementimin e politikave në kuadër të procesit të decentralizimit. Thënë këtë, Ministria e Brendshme ka mundësinë që jo vetëm të garantojë një proces monitorimi konsistent por edhe të ketë strukturat e përshtatshme për të ndërlidhur këtë strategji me strategjitë e tjera të cilat kanë një ndërveprim reciprok mes tyre.

Duke marrë shkak nga shkalla jo gjithmonë e dëshirueshme e raportimit të Ministrive të Linjës, për strategjinë e re, si raportohet në dy monitorimet e fundit vjetor, Ministria e Brendshme do të luajë një rol të shtuar në monitorim të vazhdueshëm të aktiviteteve të strategjisë. Përveç monitorimit gjashtëmujor dhe atij vjetor, Ministria do të fokusohet edhe në ndjekjen reale të aktiviteteve, duke koordinuar, konsultuar dhe nxitur institucionet përgjegjëse që në fazat e para të zbatimit të aktiviteteve të planeve.

Në këtë kontekst, monitorimi nënkupton:

- Monitorim të Planit të Veprimit
- Monitorim të indikatorëve strategjik, dhe
- Monitorim financiar të Planit të Veprimit

Monitorimi do të bazohet në standardet e Sistemit të Informacionit për Planifikimin e Integruar (SIPI/IPSIS), në koordinim edhe me SASPAC. Në të gjitha rastet, informacioni do të mblidhet nga Ministrinë e Linjës dhe NJVV nëpërmjet formateve të gatshme sipas standardit IPSIS. Gjithashtu, përveç monitorimit vjetor, Ministria e Brendshme do të konsiderojë edhe monitorimin gjashtëmuor për të bërë të mundur ndjekjen më të shpejtë dhe marrjen e masave sipas rastit në kohë reale. Në të njëjtën kohë, Planit i Veprimit do të shoqërohet edhe me analiza të thelluara të sektorit, duke priorizuar problematikat e agjendës së decentralizimit. Informacioni do të kryqëzohet edhe me partnerët e zhvillimit, të cilët monitorojnë aspekte të caktuara të agjendës.

5. Burimet financiare për zbatimin e strategjisë

Kjo strategji financohet nga një sërë burimesh, Qeveria Shqiptare, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Partnerë Zhvillimi. Në terma të kostimit, Strategjia vjen e shoqëruar me një Plan Veprimit 3 vjeçar (2023-2025) të kostuar sipas standardeve IPSIS dhe metodologjisë së OECD/SIGMA.

Duke qenë se, të gjithë objektivat specifike, përkatësisht 1-6, parashikojnë asistencë teknike, mbështetje të njësisë të vetëqeverisjes vendore, studime, vlerësime ligjore dhe teknike të funksioneve të deleguara pushtetit vendor, i gjithë plani i veprimit shoqërohet me kostot indikative sipas zërave përkatëse, të cilat janë të mbështetura edhe në Programin Buxhetor Afatmesëm.